



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## **LIKUIDIMI DHE SHPËRBËRJA E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE (“NSH”)**

***Udhëzues i AKP-së për Likuidim 2011***

**Maj 2012**

Ky udhëzues është pronë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Asnjë pjesë e këtij Udhëzuesi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet, në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo mënyra tjera pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

<b>FJALOR I SHKURTESAVE.....</b>	<b>5</b>
<b>PARATHENIE</b>	<b>6</b>
<b>1 HYRJE</b>	<b>7</b>
1.1	<i>Synimi i këtij udhëzuesi</i> 7
1.2	<i>Roli i Agjencisë si likuidues</i> 7
1.3	<i>Baza ligjore për likuidimin e NSH-ve</i> 8
1.4	<i>Kompetencat e AKP-së mbi ndërmarrjet shoqërore (“NSH”)</i> 9
1.5	<i>Privatizimi dhe likuidimi- pjesë e procesit</i> 10
1.6	<i>Çështje të rëndësishme për vëmendjen e anëtarëve të AL-së</i> 11
<b>2 FILLIMI I PROCESIT TE LIKUIDIMIT .....</b>	<b>13</b>
2.1	<i>Përzgjedhja e NSH-së për likuidim</i> 13
2.2	<i>Dokumentet informuese për bordin</i> 13
2.3	<i>Fillimi i likuidimit</i> 13
<b>3 AUTORITETI I LIKUIDIMIT (“AL”).....</b>	<b>14</b>
3.1	<i>Roli i AL-së</i> 14
3.2	<i>Caktimi i AL-së</i> 14
3.3	<i>Përbërja e AL-së</i> 14
3.4	<i>Anëtarët e AL-së</i> 15
3.5	<i>Detyrat e drejtpërdrejta të Autoritetit të Likuidimit pas emërimit</i> 16
3.6	<i>Llogaridhënia dhe përgjegjësia e AL-së dhe anëtarëve të AL-së</i> 17
3.7	<i>Të drejtat dhe kompetencat e AL-së</i> 17
3.8	<i>Përgjegjësit dhe obligimet e AL-së</i> 21
3.9	<i>Udhëzimet nga DHPGJS</i> 25
3.10	<i>Vlerësimi dhe vendimi i AL-së në kërkesa</i> 25
<b>4 MJETET KRYESORE PËR MENAXHIMIN E LIKUIDIMIT .....</b>	<b>26</b>
4.1	<i>Arkivi i likuidimit</i> 26
4.2	<i>Regjistri i kërkesave</i> 26
4.3	<i>Dokumentet standarde (shabllonet)</i> 26
4.4	<i>Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit</i> 26
4.5	<i>Të dhënat e Autoritetit të Likuidimit</i> 26
<b>5 NJOFTIMET PAS FILLIMIT TË LIKUIDIMIT .....</b>	<b>27</b>
5.1	<i>Kërkesa e njoftimit në përgjithësi</i> 27
5.2	<i>Njoftim për të gjithë kreditorët e njohur</i> 27
5.3	<i>Njoftimet për teprice teknologjike tek menaxhmenti dhe punëtorët e NSH-së</i> 27
5.4	<i>Njoftimet për institucionet publike</i> 28
5.5	<i>Njoftimi për Regjistrin e bizneseve</i> 28
5.6	<i>Njoftimi për bankat</i> 28
5.7	<i>Njoftimi për pezullim të veprimeve</i> 28
<b>6 MBLEDHJET E KREDITORËVE DHE KOMISIONET E KREDITOREVE .....</b>	<b>29</b>
6.1	<i>Kreditorët, mbledhjet e kreditorëve dhe dëshmitë e kërkesave</i> 29

<b>7</b>	<b>ÇESHTJE OPERACIONALE .....</b>	<b>30</b>
	7.1 Sigurimi i librave dhe dosjeve	30
	7.2 Llogaria bankare e likuidimit	30
	7.3 Vijueshmëria e aktiviteteve afariste	30
	7.4 Paradhënie e parave të imëta	31
	7.5 Njoftimi për likuidim të të gjitha palët e treta	31
	7.6 Tatimi mbi vlerën e shtuar	31
	7.7 Vulat dhe çelësat e arkivit	32
	7.8 Shërbimet komunale	32
	7.9 Ofruesit e shërbimeve të likuidimit (“OSHL-të”)	32
	7.10 Sistemi Menaxhues i Likuidimit (SML)	32
	7.11 Vlerësimi i performancës dhe raportimi	32
<b>8</b>	<b>PUNA ME ASETË .....</b>	<b>33</b>
	8.1 Siguria dhe mbrojtja e aseteve	33
	8.2 Anulimi i transaksioneve	35
	8.3 Shitja e aseteve	37
	8.4 Modeli i rregullave të tenderit	38
<b>9</b>	<b>PUNA ME KËRKESAT E KREDITOREVE.....</b>	<b>39</b>
	9.1 Të përgjithshme	39
	9.2 Prioriteti i kërkesave	39
	9.3 Trajtimi i kërkesave	39
	9.4 Lista përfundimtare e kërkesave	45
<b>10</b>	<b>PUNA ME KËRKESAT PRONËSORE .....</b>	<b>46</b>
	10.1 Përcaktimi i kërkesave pronësore	46
<b>11</b>	<b>ANKESAT</b>	
	11.1 Ankesat kundër vendimeve të AL-së	47
	11.2 Padit kundër AKP-së	47
<b>12</b>	<b>SANKSIONET NË DISPOZICION TË AGJENCISË .....</b>	<b>48</b>
	12.1 Obligimi për të bashkëpunuar me AL-në	48
<b>13</b>	<b>SHPËRNDARJET .....</b>	<b>50</b>
	13.1 Fondet rezervë	50
	13.2 Kalkulimi i fondit të mbetur dhe shpërndarja	50
	13.3 Kthimi i fondit	52
	13.4 Shpërndarjet e parakohshme	52
	13.5 Trajtimi i kërkesave dhe interesi	52
	13.6 Shpërndarja përfundimtare	52
<b>14</b>	<b>MBYLLJA E RASTIT .....</b>	<b>54</b>
	14.1 Raporti përfundimtar	54
	14.2 Kërkesat në DHPGJS	54
	14.3 Mbyllja e rastit të ekspedituar	55

*2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së*

---

14.4	<i>Njoftimi për mbylljen e rasteve</i>	55
14.5	<i>Pasojat e mbylljes së rastit</i>	55
<b>Shtojca - Përmbajtja e Arkivit standard të likuidimit .....</b>		<b>57</b>
<b>Shtojca I- Lista e Formave të Likuidimit.....</b>		<b>59</b>
<b>Shtojca II - Udhëzues për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës në Likuidim</b>		<b>60</b>
<b>Shtojca III - Udhëzues për Shqyrtimin e Kërkesave për Banesat në Likuidim .....</b>		<b>61</b>
<b>Shtojca IV- Udhëzues për shqyrtimin e Pretendimeve Pronësore nga Transformimet.....</b>		<b>62</b>
<b>ADRESAT KONTAKTUESE TË AKP-SË .....</b>		<b>63</b>

## FJALOR I SHKURTESAVE

Shkurtesa	Titulli i plotë
Agjencia	Agjencia Kosovare e Privatizimit
UA	Udhëzimet Administrative të UNMIK-ut
Ligji në Fuqi	Ligjet në fuqi në Kosovë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës
Regjistri i Biznesit	Regjistri i Kosovës i Organizatave të Biznesit dhe emrave të Tregtisë sipas ligjit
ZDM	Zëvendës Drejtor Menaxhues i AKP-së
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
DPV	Deklarata Përfundimtare e Vlerës
ZPCN	Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar
SHA	Shoqëri Aksionare
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AL	<b>Autoriteti</b> i Likuidimit
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara
SML	Sistemi për Menaxhimin e Likuidimit
OSHL	Ofrues i Shërbimeve për Likuidim
EML	Ekipi Mbështetës i Likuidimit
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DM	Drejtori Menaxhues
ReT	Rregullat e Tenderit
NR	Ndërmarrje e Re
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
Aktet nënligjore- ligji i AKP-së	Aktet nënligjore të AKP-së
Ligji i AKP-së	Ligji Nr.04 / L-034 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, i datës 31 gusht 2011
Politikat Operacionale të AKP-së	Politikat Operacionale të AKP-së, të Shtator 2011
ZR	Zyra Rajonale e AKP-së
KPS	Kërkesa për Përcaktim të Statusit
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me AKP-në

**PARATHENIE**

Misioni dhe strategjia e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("Agjencia") është që të administrojë pasurinë e ndërmarrjeve shoqërore që mbahen në mirëbesim për të mirën e pronarëve, kreditorëve dhe në fund të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i Agjencisë është shitja, transferimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve dhe asetëve në pronësi shoqërore. Pas përfundimit të këtij procesi, Agjencia fillon shpërndarjen e fondeve në mirëbesim tek kreditorët, punëtorët dhe pronarët, sa më shpejtë që është e mundur. Megjithatë, në mënyrë që të arrihet kjo, Agjencia duhet të veprojë në përputhje me ligjin dhe të sigurojë që kërkesat e pretenduesve janë ligjore para se të bëhet shpërndarja.

Që nga themelimi më 2008, Agjencia ka kaluar disa vite me sfida. Sidoqoftë, me miratimin e ligjeve të reja në gusht të këtij viti - Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 04/L-034) dhe Ligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Nr. 04/L-033) – Agjencia do të fillojë një proces më ekspeditiv të privatizimit dhe në veçanti të likuidimit.

Përqendrimi i aktiviteteve të Agjencisë është zhvendosur nga privatizimi në likuidim dhe kjo është reflektuar në planet e Agjencisë. Agjencia ka vazhduar likuidimin e 120 ndërmarrjeve dhe asetëve të cilat ishin nisur nga ish Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ("AKM"), por likuidimi i të cilave nuk kishte përfunduar. Lidhur me këtë, Agjencia ka një plan që likuidimin ta përfundojë në një afat pesë-vjeçar. Prandaj synimi i Agjencisë është që të përfundojë privatizimin dhe procesin e likuidimit e ndërmarrjeve dhe asetëve në pronësi shoqërore në Kosovë.

Udhëzuesi i Likuidimit ("Udhëzuesi") zëvendëson udhëzuesin e mëhershëm të likuidimit të Agjencisë, dhe është hartuar si rrjedhojë e miratimit të ligjeve të lartë-përmendura dhe duke u bazuar në Ligjin dhe Politikat Operacionale të Agjencisë të vitit 2011. Qëllim primar i Udhëzuesit është që të pajis personelin e Agjencisë dhe palët e interesuara me një sistem që lehtëson mbarëvajtjen e shqyrtimit të kërkesave të kreditorëve dhe pretenduesve, si dhe procedura dhe vendim-marrje efektive dhe efikase.

Pritet një përshpejtim i procesit të likuidimit në muajt dhe vitet në vijim. Mund të paraqiten vështirësi fillestare deri në riorganizimin e punës dhe adaptimin me kërkesat e reja ligjore të ligjeve themelore të privatizimit. Sidoqoftë, vizioni dhe qëllimi i kreut të Agjencisë është një proces transparent dhe ekspeditiv i privatizimit dhe likuidimit, dhe në këtë mënyrë të arrihet qëllimi kryesor – zhvillimi i ekonomisë së Kosovës dhe kthimi i mjeteve financiare atje ku edhe e kanë vendin, tek qytetarët e Kosovës.

Menaxhmenti i Agjencisë është i interesuar në mënyrë jetike për arritjen e qëllimeve të synuara.

Shkelzen Llluka

Drejtor Menaxhues  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Shtator 2011

## 1 HYRJE

### 1.1 Synimi i këtij udhëzuesi

Ky udhëzues është përgatitur me qëllim ose për t'u siguruar që të gjitha likuidimet e kryera nga AKP-ja janë duke u ndërmarrë në pajtim me ligjin dhe në përputhje me praktikën e standardeve ndërkombëtare të **insolencës**.

Ky udhëzues iu referohet gjithashtu "shabllonëve" të **likuidimit**. Këto janë letra standarde, dokumente, formularë, dhe njoftime që janë pjesë e sistemit të AKP-së për menaxhimin e procesit të likuidimit. Këto forma standarde duhet të përdoren aty ku specifikohen dhe mund të ndryshohen apo plotësohen nga Departamenti Ligjor përmes Menaxhmentit të Agjencisë..

**Shënim: Ky udhëzues nuk merret me administrimin e kërkesave të punëtorëve të kualifikuar për 20% nga të ardhurat e privatizimit dhe likuidimit. Administrimi i kërkesave të tilla kryhet në mënyrë të pavarur nga Autoriteti i Likuidimit<sup>1</sup>.**

### 1.2 Roli i Agjencisë si likuidues

Likuidimi i NSH-ve ka filluar në vitin 2005. Atëherë AKM-ja dhe tani AKP-ja, në cilësinë e tyre themelore si administrues i besuar, kryejnë veprimtari që janë projektuar për të ruajtur ose për të shtuar shanset për sukses, vlerën ose qeverisjen e NSH-ve në përputhje me ligjin e AKP-së.

AKP-ja ka autoritetin të shesë, dhe transferojë dhe/ose likuidojë NSH-të dhe asetet në pronësi shoqërore në përputhje me ligjin e AKP-së dhe mund të **iniciojë** likuidimin e një NSH-je apo ndonjë pjese të saj, nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve dhe/apo pronarëve të NSH-së. Këto likuidime janë zhvilluar konform legjislacionit përkatës, ndërsa në të ardhmen do të zhvillohen sipas procedurave të përcaktuara në Shtojcën e Ligjit të AKP-së .

Në këtë kontekst, është e rëndësishme që sapo të fillohet likuidimi të kryhet në mënyrë efikase dhe të shpejt duke respektuar afatet ligjore dhe afatet e caktuara.

Për realizimin e këtij synimi, AKP-ja sipas nenit 2. paragrafi 2.2 të **Ligjit për AKP-në**: Shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme<sup>2</sup>.

AKP-ja është e obliguar që gjatë proceseve të likuidimit të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollat e saj. Ky është një parim bazë që qëndron në themel të ligjit të AKP-së i cili është hartuar me kujdes që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve dhe pronarëve në të gjitha fazat e privatizimit dhe likuidimit. Në të gjitha rastet, të drejtat e kreditorëve janë të mbrojtura plotësisht me drejtën e ankimimit dhe afate të arsyeshme brenda cilëve të parashtrohet ankesa. Të gjitha letrat relevante standarde janë hartuar për të tërhequr vëmendjen e pranuesit për drejtën e tij të ankimimit.

<sup>1</sup> Është shumë e rëndësishme të theksohet mënyra në të cilën të ardhurat nga privatizimi dhe likuidimi për shpërndarje rregullohen. Në radhë të parë, 20% i çdo të ardhure nga privatizimi menjëherë ndahet dhe vendoset në një llogari ruajtje për benefitin e punëtorëve të kualifikuar. Megjithatë, punëtorët e kualifikuar kanë të drejtë gjithashtu edhe ne 20% nga çdo shitje e aseteve në likuidim. Së dyti AKP ka të drejtë në tarifën administrative prej 5% në të gjitha fondet e pranuar që rezultojnë prej shitjeve në të kaluarën apo të ardhmen, transferimi, privatizimi, likuidimi ose ndonjë dispozitë tjetër e ndonjë ndërmarrjeje ose asetit, pavarësisht a është kryer nga Agjencia apo paraardhësja e saj. Kështu 75% i të gjitha fondeve nga shitja e pasurisë së NSH-ve përbëjnë të ardhurat për shpërndarje cilat duhet të menaxhohen nga AL. Këto të drejtat e fundit duhet të llogariten në likuidim dhe lexuesi do ta shohë se si kjo është bërë duke iu referuar deklaratës së rezultatit.

<sup>2</sup> Ligji i AKP-së, neni 2.2

### 1.3 Baza ligjore për likuidimin e NSH-ve

Baza ligjore mbi të cilën bazohet procesi i likuidimit është Ligji i AKP-së dhe Shtojca e këtij Ligji, duke përfshirë **Politikat Operacionale të AKP-së, Udhëzuesin e AKP-se për Likuidim, Statutet, Rregulloret dhe ligjet e aplikueshme:**

1	2009	Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 2009/03-L-154, i datës 25 qershor 2009	Ligji mbi Pronën
2	2011	Statutet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit	Statutet e AKP-së
3	2011	Politikat Operacionale të AKP-së të datës <b>tetor</b> 2011	Politikat Operacionale të AKP-së
4	2011	Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit 31.08.2011	Ligji i AKP-së 2011
5	2004	Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës së Shfrytëzimit të Pronës së Paluajtshme Shoqërore, e ndryshuar, e datës 9 maj 2003	Rreg. 2003/13 me ndryshime

Hartimi i Ligjit të AKP-së të datës 31.08.2011 dhe i Politikave Operacionale të AKP-së ka ofruar mundësi për konsolidimin e tërë legjislacionit ekzistues të likuidimit.

Ndikimi i përgjithshëm i ndryshimeve të shpallura në ligjin e ri të AKP-së do të rezultojë në lirimin e më të hershëm të fondeve të mirëbesimit për kreditorët dhe parashtruesit e ankesave. Ligji për DHPGJS-në është rishqyrtuar duke krijuar kështu dy panele tjera gjyqësore për t'i shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të AL-së si dhe janë shkurtuar ndjeshëm afatet brenda të cilave Gjykata duhet t'i lëshojë vendimet e veta.

Ligji mbi Riorganizimin e Ndërmarrjeve **të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre** e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48 dhe zgjidh çështje të shumta praktike të riorganizimit duke përfshirë konvertimin e ri të harmonizuar të rasteve të tilla në likuidime në rast të mosuksesit të riorganizimit. Ligji i AKP-së dhe Ligji mbi Riorganizimin **Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së Tyre** siguron llogaridhënie më të mirë të AL-së dhe të Administruesit ndaj kreditorëve, mbajtësve të interesit dhe autoriteteve përkatëse qeveritare. Të gjitha këto masa kontribuojnë në rritjen e përgjithshme të efikasitetit të ligjeve të Kosovës që kanë të bëjnë me procedurat e likuidimit.

Në kontekstin e këtyre që u thanë më sipër, e drejta e punëtorëve të NSH-ve gjatë procedurës së likuidimit nga ana e AKP-së meriton elaborim shtesë:

- Së pari, punëtorët e "kualifikuar" kanë të drejtë në një pjesë nga 20% nga të ardhurat e privatizimit dhe likuidimit që është caktuar për punëtorët;
- Së dyti, ata kanë të drejtë të paraqesin kërkesë preferenciale ndaj pronës së likuidimit që ruhet për pjesën e përgjithshme të kreditorëve dhe pronarëve në lidhje me tre muaj të pagave të papaguara si kreditor prioritar;
- Së treti, ata mund të paraqesin kërkesë preferenciale për pagesë për shkurtim nga puna si rezultat i tepricës për shkak të një veprimi ose në lidhje me një veprim të cilin e ndërmerr AKP-ja - për shembull vendimin për privatizim ose likuidim të NSH-së (të cilat në shumicën e rasteve çojnë në humbjen e punës);
- Së katërti, ata mund të paraqesin kërkesë të pasiguruar për çfarëdo kërkesë tjetër të papaguar që ata mund të kenë.



Të drejtat e tilla u paguhen punëtorëve të NSH-ve në përputhje me rendin e prioriteteve të parapara sipas Shtojcës së Ligjit të AKP-së të vitit 2011, neni 40. Në veçanti, në bazë të nenit 3.1.18 të Ligjit të AKP-së dhe të **Shtojcës** neni 40 (1.6 dhe 1.7) punëtorët kanë të drejtë në pagesat e përmendura më lart si vijon:

1. 20% e të ardhurave të privatizimit dhe likuidimit<sup>3</sup> (prioritet absolut);
2. Pagat të cilat kanë mbetur pa u paguar deri në datën e vendimit të AKP-së për fillimin e likuidimit, paga këto të kufizuara në tre (3) muaj të pagës bruto, duke përfshirë edhe pagat për shkurtim nga puna si tepicë për shkak të privatizimit apo likuidimit ose në lidhje me privatizimin apo likuidimit (prioritet i rangut të gjashtë);
3. Kërkesat e pasiguruara të pagave të cilat nuk janë objekt i trajtimit më të lartë prioritar (prioriteti i rangut të shtatë).

#### 1.4 Kompetencat e AKP-së mbi ndërmarrjet shoqërore (“NSH”)

Puna e përditshme e NSH-ve kryhet nga organet menaxhuese dhe organet e tjera kontrolluese të NSH-së, pa shkelje të kompetencave të Agjencisë sipas Ligjit të AKP-së. Megjithatë, nëse Bordi i AKP-së vendos ndryshe, ai mund të ushtrojë mbikëqyrje të menaxhimit të përgjithshëm<sup>4</sup> mbi NSH-të brenda kufijve të resurseve të saja administrative.

Kompetencat administrative të AKP-së janë të gjera dhe përfshijnë, *inter alia*, zëvendësimin e kryesuesit, drejtorëve dhe menaxherëve të NSH-së. Në situata të caktuara, aty ku AKP-ja konsideron se asetet e NSH-së janë në rrezik, ajo mund gjithashtu të vendosë **Administrimin e drejtpërdrejtë** mbi një NSH. Në një rast të tillë, funksionet drejtuese të NSH-së do të kryhen kryesisht nga menaxhmenti i Agjencisë<sup>5</sup>.

Autoriteti i Agjencisë për t’i administruar NSH-të ose asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si një subjekt apo jo, të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më 22 mars 1989 ose pas kësaj date, nuk kufizohet në atë se a i janë nënshtruar ato transformimit apo jo<sup>6</sup>. Për më tepër, pa marrë parasysh nëse ndonjë NSH ka pësuar transformim, AKP-ja gjithashtu ka autoritet mbi interesat shoqërore dhe shtetërore në ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik<sup>7</sup>. Transformimi mund të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë të parapara me nenet 5, 6, 8 dhe 9 të Ligjit AKP-së, duke përfshirë autoritetin për të filluar procedurat e likuidimit, vetëm kur (i) transformimi bazohet dhe kryhet në përputhje të plotë me ligjin në fuqi, dhe (ii) kur transformimi nuk është as diskriminues e as në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Ligji për AKP, neni 5.4). Megjithatë, në përputhje me nenin 5.5 të Ligjit të AKP-së, kur është fjala për NSH-në apo asetin që ka

<sup>3</sup> Ligji i AKP-së në nenin 3.1.18 parasheh prioritet absolute për pagesat e të drejtave të cilat i kanë punëtorët sipas nenit 10 të Rregullores mbi Transformimin e Pronës së patundshme (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13) para shpërndarjes se të ardhurave kreditorëve dhe mbajtësve të interes nga shitja e ndonjë aseti të ndërmarrjes sipas nenit 6,8 dhe 9 të Ligjit të AKP-së.

<sup>4</sup> Sipas Politikave Operacionale të AKP-së, kapitulli 4, neni 4.1 “Mbikëqyrja e menaxhimit të përgjithshëm” nënkupton që menaxherët përkatës të secilës NSH e zhvillojnë afarizmin e NSH-së sipas discrecionit të tyre sipas ligjit në fuqi dhe në pajtim me statutet e NSH-së. Veprimet dëmshme të organeve menaxheriale të NSH-ve, të kritereve të statuteve të NSH-ve apo mënyra e tyre e zhvillimit të afarizimit mund të cojnë tek ajo që Agjencia t’i ushtrojë kompetencat e saja administrative sipas nenit 6 të Ligjit.

<sup>5</sup> Shih Politikat operacionale, neni 4.4.1 pika 6.

<sup>6</sup> Ligji i AKP-së, neni 5.1.1 dhe 5.1.2, “Transformim” lidhur me personin juridik do të thotë cilitdo nga këto që vijojnë: bashkimi, regjistrimi, ri-regjistrimi, inkorporimi si shoqëri aksionare apo si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo si person tjetër juridik, falimentimi, likuidimi, paaftësia paguese, organizimi në formë të veçantë apo në subjekt tjetër, ose çfarëdo ngjarje apo procesi tjetër përmes të cilit ndryshohen cilado nga të poshtëshënuarat lidhur me atë subjekt: identiteti ligjor, forma apo natyra, ose forma apo natyra e pronësisë apo kapitalit, selia, dhe nëse ngjarja apo procesi i tillë apo ndonjë pjesë e tij ka ndodhur në cilëndo kohë ndërmjet 22 marsit 1989 dhe 13 qershorit 2002 (neni 3.1.27, Ligji i AKP-së)

<sup>7</sup> Ligji i AKP-së, neni 5.1.3 “Të gjitha aksionet në korporata dhe korporata subsidiare të themeluara në bazë të këtij ligji; si dhe të gjitha interesat shtetërore në ndonjë ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pa marrë parasysh se a ka pësuar ndërmarrja apo personi juridik transformim.”

pësuar një transformim, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 5.4 të Ligjit të AKP-së, përveç nëse Agjencisë i gjinden në dispozicion dëshmi të qarta në bazë të të cilave ajo përfundimisht konstaton se transformimi i plotëson kërkesat e tilla.

Edhe kur një transformim është konstatuar të jetë në përputhje të plotë me ligjin, është shumë e pazakontë që të gjitha aksionet në ndërmarrjen e korporatizuar t'u jenë shitur punëtorëve apo investitorëve. Në shumicën e rasteve, një grup pakicë aksionesh (shpesh pakicë e konsiderueshme në praktikë) do të mbetet në pronësi shoqërore që do të trajtohet përmes realizimit nga Agjencia. Shtojca **IV e Udhëzuesit për Likuidim trajton çështjet e transformimit.**

Në rastet kur prova të qarta gjinden në dispozicion të Agjencisë e cila përfundimisht përcakton ndarjen e të drejtave të aksionarëve (ose pronësisë) mbi një ndërmarrje të tillë në mes të kapitalit (ose pronësisë) shoqërore dhe kapitalit ose (pronësisë) private, Agjencia do të pushojë së ushtruar çdo autoritet mbi atë ndërmarrje përveç qëllimit që t'i ushtrojë të gjitha të drejtat aksionare (ose pronësore) që rrjedhin nga pjesa e pronësisë shoqërore të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes, ku përfshihet e drejta për të shitur çfarëdo pasurie e cila ka mbetur në pronësi shoqërore.

Kur asetet e NSH-së gjinden jashtë Kosovës, AKP-ja mund t'i ndërmarrë të gjitha ato veprime dhe t'i ushtrojë ato të drejta ashtu siç e parasheh ligji i huaj në lidhje me atë pronë. Megjithatë kur të vendosë mbi çështje të tilla, AKP-ja është e detyruar të marrë parasysh të gjitha politikat përkatëse që mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës. Në të njëjtën kohë, AKP-ja natyrisht do të marrë në konsideratë ligjin që zbatohet në vendet në të cilat mund të gjinden asetet e NSH-së, si dhe mekanizmat në dispozicion të AKP-së të cilat e mundësojnë që procedurat kosovare të njihen në vendin e huaj.

Për t'i bërë ofertat e saja të privatizimit më tërheqëse për investitorët e ardhshëm, AKP-ja ka kompetenca të themelore ndërmarrje të reja ("**Ndër Re**"), tek të cilat mund të transferohen asetet e NSH-së. Aksionet në këto ndërmarrje të reja - të cilat kanë avantazhin se janë në një masë të madhe të liruara nga borxhi dhe kanë të drejtën e përdorimit të qartë të aseteve - pastaj mund të shiten, pra duke e lehtësuar privatizimin me të ardhurat që mbahen në mirëbesim për të mirën e NSH-së<sup>8</sup>, të punëtorëve të saj me të drejtë legjitime, të kreditorëve dhe pronarëve të saj<sup>9</sup>.

Në rast se Agjencia ka ushtruar kompetencat e saja për ta shitur biznesin apo asetet e NSH-së, dhe më pas me sukses është vërtetuar pronësia e saj, AKP-ja është e obliguar t'i kompensojë pronarët e tillë nga të ardhurat që rrjedhin nga likuidimi, me kusht që së pari të rregullohet kompensimi i **kërkesave dhe interesave** të kreditorëve **sipas prioritetit**<sup>10</sup>. Është e rëndësishme të kuptojmë se Ligji i AKP-së **Nr. 04/L-034** në mënyrë të qartë parasheh kompensimin e **pronës** e jo kthimin (restituimin).

### **1.5 Privatizimi dhe likuidimi- pjesë e procesit**

Shumica e NSH-ve kalojnë nëpër procedurën e privatizimit para se të përzgjidhen për likuidim. Procedura e privatizimit përfshin planifikim të detajuar paraprak që përfshin rishikimin e shitblerjes, zotimet dhe asetet prezente për të prezantuar një biznes të qëndrueshëm që do të jetë tërheqës për investitorët potencialë. Si pasojë e privatizimit, AKP-ja është në dijeni të aseteve që do të mbeten pas privatizimit dhe informacionet e tilla siç janë listat e kreditorëve dhe të të punësuarve mund të nxirren paraprakisht.

<sup>8</sup> Ligji i AKP-së, neni 8.3

<sup>9</sup> Ligji i AKP-së, neni 8.4

<sup>10</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, nenet 40 dhe 41

Pasi që propozimi për futjen të një NSH -je në likuidim të jetë marrë nga menaxhmenti i Agjencisë, përgatiten Dokumentet e Likuidimit për Bord [shih formularin L01] i cili duhet të përmbaj një përmbledhje për asetet dhe detyrimet. Likuidimi fillon në datën kur Bordi i AKP-së aprovon dokumentin “Aprovimi i Bordit për Likuidim” me datë e vendimit të Likuidimit.

Likuidimi është faza e fundit dhe është i projektuar për t'i dhënë fund me shpërndarjen e mjeteve tek kreditorët dhe pronarët; në fund me heqjen e emrit të NSH-së nga Regjistri Kosovar i Shoqërive Tregtare dhe i Emrave Tregtar ("Regjistri i Biznesit")<sup>11</sup>. **Korniza e likuidimit është e projektuar për të lehtësuar realizimin e rregullt të aseteve, identifikimin e kreditorëve dhe shpërndarjen e aseteve në përputhje me parimin e prioritetit të paraparë me nenin 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.**

Në rastin e NSH-ve, AKP-ja administron procedurën e likuidimit duke emëruar **Autoritetet e Likuidimit (AL)**<sup>12</sup>. Bordi i AKP-së cakton një ose më shumë OShP<sup>13</sup> të cilët do të shërbejnë në AL nga fillimi deri në fund të procedurës së likuidimit. Po ashtu, kompetenca të konsiderueshme u janë dhënë edhe DHPGJS-së, p.sh. **shqyrtimi i ankesave ndaj** vendimeve të AL-së, heqja dorë nga aset, <sup>14</sup> gjykimit të ankesave kundër vendimeve të AL-së<sup>15</sup> ose përmbyllja përfundimtare e likuidimit<sup>16</sup>.

## 1.6 Çështje të rëndësishme për vëmendjen e anëtareve të AL-së

### 1.6.1 Kompetencat e Agjencisë për të likuiduar

Agjencia mund t'i likuidojë NSH-të apo ndonjë pjesë të tyre nëse mendon se një procedurë e tillë është në interes të kreditorëve dhe/ose pronarëve të tyre. Agjencia duhet ta kryejë likuidimin sipas procedurës së paraparë me Shtojcën e Ligjit për AKP-në . 2011.

### 1.6.2 Kompetencat e AL-së

Të gjitha kompetencat e organeve të menaxhimit dhe kontrollit të NSH-së do t'i kalohen AL-së. Kompetencat e AL-së shpjegohen në hollësi në Nenin 3 më poshtë.

### 1.6.3 Përgjegjësia e anëtarëve të AL-së

Çështja e përgjegjësisë personale të AL-së përcaktohet qartë në Ligjin e AKP-së. AL-të dhe punonjësit e tyre nuk do të kenë përgjegjësi personale kur veprojnë në emër të Agjencisë.

*Anëtarët e AL-së veprojnë në emër të AKP-së dhe të gjitha veprimet apo lëshimet e AL-së konsiderohen veprime ose lëshime të Agjencisë<sup>17</sup>.*

*Asnjë person i angazhuar ose i punësuar nga Agjencia dhe asnjë person i cili mban një pozitë menaxheriale ose të drejtorit në Agjenci ose në lidhje me Agjencinë, nuk mban përgjegjësi personale të çfarëdo lloji ndaj cilësdo palë të tretë për dëmet të cilat i janë shkaktuar ose pretendojnë të jenë shkaktuar nga pala e tretë si rezultat i një veprimi ose lëshimi të Agjencisë ose një veprimi ose lëshimi të personelit, menaxhmentit ose Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, nëse ky veprim ose lëshim është bërë gjatë zbatimit ose ekzekutimit të autoritetit dhe përgjegjësisë të Agjencisë të përcaktuara në këtë ligj ose cilitdo element tjetër të ligjit në fuqi në Kosovë ose si pasojë e zbatimit të një interpretimi të arsyeshëm dhe jo qëllimkeq të këtyre*

<sup>11</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 45

<sup>12</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 12

<sup>13</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 13.1

<sup>14</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 18.4 në lidhje me nenin 18.3, 18.3 dhe 19.7 në lidhje me nenin 19.4

<sup>15</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 37.8 në lidhje me nenin 37.6 dhe 37.7

<sup>16</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, neni 44

<sup>17</sup> Ligji i AKP-së, neni 18.5

*autoriteteve dhe përgjegjëseve. Të gjitha përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara në këtë mënyrë janë përgjegjësi ekskluzive e Agjencisë. Agjencia është e detyruar që të sigurojë dhe mbrojë fuqishëm personelin, menaxherët ose drejtorët kundër të cilëve është ngritur një akuzë për këto dëme.*

Megjithatë, niveli konkret i përgjegjësisë personale i nënshtrohet detyrimeve kontraktuale ndërmjet Agjencisë dhe AL-së.

#### **1.6.4 E drejta e apelit / juridiksionit përfundimtar**

E drejta e seancave përfundimtare, ose e aplikacioneve apo kërkesave për urdhra në lidhje me riorganizimin ose likuidimin e NSH-ve apo çfarëdo çështje tjetër që u përket këtyre do të trajtohen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës **(DHPGJS)**.

## 2 FILLIMI I PROCESIT TE LIKUIDIMIT

### 2.1 Përzgjedhja e NSH-së për likuidim

***Pika 6.7 e Politikave Operacionale të AKP-së thotë: Menjëherë pas përfundimit të shitjes me privatizim spin-off, Agjencia fillon me procesin e likuidimit sipas Politikave Operacionale të AKP-së kapitulli 7 më poshtë në mënyrë që kreditorët të mund të identifikohen si dhe të vlerësohen kërkesat e tyre për të përcaktuar kështu shumën e të ardhurave që kanë mbetur për t'u paguar pronarëve. Në mënyrë që tu shmanget vonesave të fillimit të likuidimit, Agjencia, përveç nëse ka arsye të shëndosha komerciale, në përgjithësi do të përpiqet t'u shmanget spin-offeve të ndara të të njëjtës ndërmarrje me vonesa të kohës midis fazave kur ato janë planifikuar për t'u tenderuar për privatizim.***

### 2.2 Dokumentet informuese për bordin

Zyra rajonale ku gjendet NSH-ja duhet të përgatisë një dokumentacion për informim për Bordin e AKP-së për të mbështetur propozimin që një NSH do të përzgjidhet për likuidim. Dokumenti përfshinë<sup>18</sup>:

- i) Raportin mbi përcaktimin e statusit ligjor të NSH-së.
- ii) Një përmbledhje të asetëve dhe detyrimeve (të njohura dhe të vlerësuar).
- iii) Mënyrën e propozuar (s) të shitjes së asetëve.
- iv) Një përmbledhje të kërkesave (të njohura dhe të vlerësuara) të kreditorëve, ku përfshihen edhe të të punësuarve (të tanishëm, në pushim pa pagesë, në skemën sociale) dhe të ish-punonjësve (duke përfshirë ata që kanë mbetur pa punë si tepricë teknologjike pas shitjes së Ndër.së Re).
- v) Përzgjedhja e personelit të Agjencisë i cili do të caktohet për të shërbyer në Autoritetin e Likuidimit.
- vi) Kandidati (ët) për Ofrues të Shërbimit Profesional i cili do të shërbejë si Autoritet për likuidimin, të cilët janë kualifikuar përmes tenderit konkurrues të cilin e ka zhvilluar menaxhmenti.
- vii) Një vlerësim të shumës së parave të gatshme që kërkohen për mbulimin e shpenzimeve të vlerësuara.

### 2.3 Fillimi i likuidimit

*Procesi i likuidimit konsiderohet si i filluar që nga data e vendimit mbi likuidim<sup>19</sup>.*

<sup>18</sup> Raporti për Fillimin e Likuidimit, Neni 7.2 i Politikave Operacionale të AKP-së.

<sup>19</sup> Shih Ligjin e AKP-së, neni 9.1

### 3 AUTORITETI I LIKUIDIMIT ("AL")

#### 3.1 Roli i AL-së

Kompetenca për të emëruar AL-në i takon Bordit të Agjencisë. Megjithatë, në praktikë Bordi i AKP-së ia delegon këtë kompetencë Drejtorit Menaxhues (DM) ose në mungesë të DM-së dy zëvendës drejtorëve menaxhues (ZDM) së bashku nëpërmjet Dokumentit Informues për Likuidim për Bordin. AL-ja i ushtron kompetencat ashtu siç e parasheh Ligji i AKP-së për kompetencat e AL-së<sup>20</sup> dhe të gjitha veprimet dhe lëshimet e AL-ve do të shihen si veprime dhe lëshime të AKP-së.

Për të arritur këtë qëllim, AL-ja është e pajisur me kompetenca të gjera dhe mbështetje teknike nga stafi i AKP-së. Sipas Ligjit të AKP-së, neni 9.2, të gjitha kompetencat e organeve të menaxhimit dhe kontrollit të NSH-së të tilla do t'i barten AL-së.

Sipas ligjit të AKP-së, Autoritet e Likuidimit duhet të vlerësojnë validitetin e çdo kërkesë para se ajo të përfshihet në listën e borxheve<sup>21</sup>.

#### 3.2 Caktimi i AL-së

**Politikat Operacionale të AKP-së parashohin:** Në përputhje me vendimin e Agjencisë për të likuiduar një NSH, Agjencia e cakton Autoritetin e Likuidimit për ta ekzekutuar likuidimin e NSH-së<sup>22</sup>.

Në Dokumentacionin për Likuidim, Menaxhmenti i propozon **Bordit Ofrues të Shërbimeve Profesionale (OSHP)** për t'u emëruar në Autoritetin e likuidimit si dhe stafin nga radhët e Agjencisë që do të caktohet për të shërbyer në Autoritetin e Likuidimit.

#### 3.3 Përbërja e AL-së

Çdo Autoritet i Likuidimit mund të përbëhet nga të paktën një (1) OSHP, ndërsa një apo më shumë anëtar të stafit të Agjencisë mund të caktohen për t'i ndihmuar Autoritetit për Likuidim në secilin rast veç e veç, dhe aty ku pritet që një numër i madh i kërkesave të kenë të bëjnë me transaksione komplekse, numri i njerëzve që punojnë si pjesë e një Autoriteti të Likuidimit mund të ndryshohet në mënyrë që puna të shpërndahet në mënyrë më efektive.

##### 3.3.1 Kontrata Kornizë, Kontraktorët Kornizë dhe Ofruesit e Shërbimeve Profesionale (OSHP)

Agjencia do të përpilojë një Kontratë Kornizë me qëllim të angazhimit të shërbimeve të Kontraktorëve Kornizë. "Kushtet e Përgjithshme" për Kontraktorët Kornizë duhet të miratohen paraprakisht nga Bordi dhe të emëruarit do të angazhohen nëpërmjet procesit të prokurimit publik. Për t'u kualifikuar për emërim në përputhje me Kontratën Kornizë, firmat dhe individët me kualifikime të duhura ftohen nëpërmjet një tenderi të **konkurrojnë** për t'u caktuar Kontraktorë Kornizë.

Këta Kontraktorë Kornizë pastaj i ofrojnë shërbimet e individëve të kualifikuar për të ofruar shërbime si **Ofrues të Shërbimeve Profesionale (OSHP)**. Kontraktorët Kornizë janë të detyruar t'i dorëzojnë CV-të e plota për të gjitha OSHP-të kurse AKP-ja e rezervon të drejtën të kërkojë referenca të pavarura dhe/ose të bëjë verifikimin e përvojës së punës sipas zgjedhjes së vet. OSHP-të përzgjidhen më pas nga AKP-ja për t'i marrë detyrat tek Autoritetet e caktuara të Likuidimit në bazë të njohurive dhe përvojës<sup>23</sup> kjo është veçanërisht kështu në rastin e proceseve të ndërlikuara të likuidimit.

<sup>20</sup> Ligji i AKP-së Shtojca e veçanërisht nenet 18 dhe 19

<sup>21</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, neni 37.4

<sup>22</sup> Politikat operative të AKP-së, neni 7.3.1

<sup>23</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, neni 15

### 3.3.2 Anëtarët e stafit të Agjencisë pranë AL-së

Menaxhmenti i AKP-së i propozon anëtarët e stafit të Agjencisë për tu caktuar me detyrë tek AL-të.

### 3.3.3 AL-të i NSH-ve të cilat nuk kanë asete

Menaxhmenti i AKP-së i propozon anëtarët e stafit të Agjencisë për tu caktuar me detyrë tek AL-të.

Autoritetet e Likuidimit të NSH-ve që nuk kanë pasuri **dhe kundër të cilave nuk janë paraqitur kërkesa në afat** nuk do të përfshijnë Ofrues të Shërbimeve Profesionale. Autoriteti për likuidim në raste të tilla do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të emëruar nga stafi i AKP, dhe të paktën një anëtar do të jetë një përfaqësues i një komuniteti pakicë. Bordi e zgjedh njërin nga anëtarët të ushtrojë detyrën e Kryesuesit.

## 3.4 Anëtarët e AL-së

### 3.4.1 Kryesuesi ose personi përgjegjës në AL

Kryesuesi ose personi i ngarkuar për të vepruar në Autoritetin e Likuidimit emërohet nga Bordi. Roli i kryesuesit ose personit përgjegjës është:

- i) Të menaxhojë me procesin e likuidimit të NSH-ve;
- ii) T'i ndajë detyrat midis anëtarëve të tjerë të AL-së, nëse ka;
- iii) Të mbikëqyrë anëtarët e tjerë dhe stafin mbështetës të AKP-së të caktuar me detyrë pranë AL-së;
- iv) T'i nënshkruajë të gjitha vendimet që i lëshon AL-ja;
- v) Të sigurojë që puna e AL-së është në përputhje me ligjin e AKP-së dhe ligjet tjera në fuqi dhe të sigurojë përmbushjen e të gjitha afateve kohore dhe afateve të raportimit.

Në rast të mungesës së kryesuesit për një periudhë kohore, Menaxhmenti i Agjencisë me procedure urgjente do të emërojë Ushtrues Detyre të Kryesuesit të AL-së (zëvendësues), vendim ky që do të konfirmohet në mbledhjen e ardhshme të Bordit.

### 3.4.2 Anëtarët tjerë të AL-së

Roli i anëtarëve të AL-së është:

- i) T'i ekzekutojë detyrat të cilat i cakton kryesuesi i AL-së;
- ii) Të marrin pjesë në mbledhje e thirrura nga AL-ja;
- iii) T'i sigurojë mbështetje teknike AL-së;
- iv) Të ndihmojnë në shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave duke përfshirë hartimin e letrave të përgjigjeve dhe korrespondenca të tjera të nevojshme;
- v) T'i verifikojnë të gjitha faktet materiale dhe dëshmitë e përdorura si bazë për vendimet të cilat i lëshon AL-ja.

Kërkesa standarde për plotësimin e stafit mund të gjendet në *[shih Shabllonin L03]* si dhe për ndryshimet aty *[shih Shabllon L03A]*.

#### 3.4.2.1 Zyrtari i rastit/ lëndës

Zyrtari i rastit duhet të jetë punonjës i AKP-së dhe anëtar i AL-së i emëruar nga Bordi në datën e vendimit të tij për likuidim në bazë të dokumentacionit informues për Bordin të cilin e paraqet DM për inicimin e procesit të likuidimit të NSH-së.

Roli primar i Zyrtarit të Rastit është menaxhimi i dosjeve të rastit në baza ditore të cilat i kryen ekipi përgjegjës për likuidimin. Zyrtari i Rastit është përgjegjës:

- i) Për përcjelljen e ditarit të procesit të likuidimit të cilin e harton AL-ja në fillim të rastit, të sigurojë përmbushjen e të gjitha afateve kohore (duke e njoftuar menjëherë AL-në për afatet e ardhshme dhe afatet e raportimit);
- ii) Të ndihmojë në dërgimin e letrave tek kreditorët dhe të të gjitha letrave tjera standarde dhe shabllonëve të përgatitura nga AL-ja dhe të sigurojë që ata të lëshohen me kohë;
- iii) T'i regjistrojë kërkesat në bazën e të dhënave dhe të vendosë të gjitha informatat relevante në lidhje me kërkesat;
- iv) T'i rishikojë kërkesat dhe të bëjë verifikimin nëse nevojiten informata tjera (e cila nuk i kërkon informatat e AL-së), për shembull për qëllime të regjistrimit;
- v) Të ndihmojë në përgatitjen e raporteve për AL-të duke përfshirë Deklaratën e Punës dhe Deklaratën e Rezultatit;
- vi) T'i mirëmbajë dosjet e likuidimit si në letër ashtu edhe në mënyrë digjitale (arkiv);
- vii) Të kryejë çdo detyrë tjetër të cilën ia cakton AL-ja.

#### 3.4.2.2 Anëtari i AL-së nga komuniteti pakicë

Neni 13.2 i Ligjit të AKP-së **Shtojca** parasheh që nëse Autoriteti për Likuidim nuk është i përbërë nga Ofruesit e Shërbimeve Profesionale, Bordi i AKP-së duhet të sigurojë që së paku një anëtar të atij Autoriteti për Likuidim të jetë një përfaqësues i një komuniteti pakicë. Prandaj, në raste të tilla kryesuesi ZR-së duhet t'ia propozojë menaxhmentit së paku një anëtar nga komuniteti pakicë për t'u caktuar në AL.

### 3.5 Detyrat e drejtpërdrejta të Autoritetit të Likuidimit pas emërimit

#### 3.5.1 Krijimi i Arkivit të Likuidimit

Krijimi i Arkivit të Likuidimit është përgjegjësi e Autoritetit për Likuidim, por dosjen e lëndës vetvetiu e mirëmban Zyrtari i Rastit i AKP-së.

Zyrtari i Rastit duhet të mbledhë të gjithë dokumentacionin që duhet të përfshihet në Dosjen e Likuidimit. Përmbytja e rekomanduar standarde e Dosjes së Likuidimit është e cekur në Politikat Operacionale pika 7.4.

#### 3.5.2 Krijimi i Arkivit të rastit/lëndës në Sistemin e Menaxhimit të Likuidimit

Agjencia do të krijojë arkivin e rastit për të gjitha likuidimet.

#### 3.5.3 Shqyrtimi i KPS-së

Në rast se AL-ja ka dyshime të arsyeshme apo shqetësime për statusin e pronësisë të një NSH-je apo asetit në bazë të provave origjinale apo dëshmime tjera ose parashtrësive të cilat i dorëzon një parashtrues i ankesës i cili në përputhje me nenin 5.6.1 të Ligjit AKP do e parandalonte Agjencinë t'i ushtrojë kompetencat e veta në pajtim me nenin 9 të Ligjit të AKP-së, AL-ja menjëherë e informon Bordin e AKP-së për një çështje të tillë dhe të pezullon çdo veprim në lidhje me NSH-në e tillë ose asetin e tillë derisa të mos sqarohet statusi i pronësisë.

#### 3.5.4 Buxheti i likuidimit

Në fillim të likuidimit, buxheti i likuidimit është burimi i vetëm i financimit të procedurave të Likuidimit. AL-ja duhet të përpiqet t'i mbajë shpenzimet e likuidimit (përfshirë edhe shpenzimet e parave të imta) në nivele të arsyeshëm.

AL-ja duhet të shqyrtojë dhe azhurnoj rregullisht (mundësisht në çdo tre muaj) **Raportin e Shpenzimeve të Likuidimit** e cila pasqyron statusin e shpenzimeve të Likuidimit. Çdo ndryshim në ndarjet buxhetore të likuidimit duhet të miratohet nga Bordi AKP-së. AL-ja mund të vendosë për rivendosjen e mundshme të linjave buxhetore, sipas nevojës dhe kur të jetë e nevojshme, në qoftë se buxheti i përgjithshëm i rishikuar nuk e kalon shumën e përgjithshme të aprovuar nga Bordi.



## 2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së

Në çdo rast, kur pozicioni i para-përcaktuar i buxhetit mund të ndodh të tejkalohet, AL-të e njoftojnë menjëherë menaxhmentin e AKP-së dhe përgatisin një buxhet të ri i cili duhet të miratohet nga Bordi.

### 3.5.5 Konfliktet e interesave

Çdo anëtar i AL-së është i detyruar t'i deklarojë interesat ekzistuese të tij/saj dhe ka për detyrë të informojë kryesuesin e AL-së dhe AKP-në për çfarëdo konflikti i cili mund të paraqitet gjatë ushtrimit të detyrës të anëtarit të AL-së. Mos raportimi i konfliktit të interesit mund të shkaktojë masa disiplinore, me mundësi të shkëputjes së marrëdhënies së punës si dhe detyrimet ndaj AKP-së.

AL-ja duhet të sigurohet që i tërë personeli i cili është caktuar me detyrë pranë saj ka nënshkruar **Deklaratën për Konflikt Interesi** [Shih Shabllon L05 dhe L15].

### 3.5.6 Datat e rëndësishme në procedurën e rasteve të likuidimit

AL-ja duhet t'i verifikojë kurse Zyrtari i Rastit duhet t'i regjistrojë datat e mëposhtme të rëndësishme për procedimin e çështjes së likuidimit, të cilat duhet të përfshihen kur të lëshohen njoftimet për kreditorët, ose raportet për Bordin:

- Data e ratifikimit tregon datën në të cilën Kryesuesi i Bordit të AKP-së e ka nënshkruar marrëveshjen e shitjes së **Ndërmarrjes/asetit** (Ndër.e Re).
- Data e Vendimit të Likuidimit e cila është edhe datë e caktimit të AL-së dhe caktimin e punonjësve të AKP-së për te. Kjo është edhe data në të cilën nga mesnata të gjitha kontratat e punës që janë në fuqi, nëse ka të tilla, në mes të NSH-ve dhe punëtorëve të saj anulohen në bazë të ligjit<sup>24</sup>.
- Data e Publikimit të Parë të Vendimit të Likuidimit, me të cilën janë të lidhura të gjitha afatet kohore të procedurave të likuidimit.
- Data e fundit për parashtrimin e **kërkesave** nga kreditorët të supozuar dhe mbajtës të interesave.
- Data e Pezullimit; Data e pezullimit e të gjitha veprimeve gjyqësore kundër NSH-së.
- Data e njoftimit të gjitha organeve ligjore për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së.
- Data e njoftimit të të gjithë kreditorëve të njohur për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së

### 3.6 Llogaridhënia dhe përgjegjësia e AL-së dhe anëtarëve të AL-së

AL-të i përgjigjen vetëm Bordit të Agjencisë dhe nuk i përgjigjen asnjë pale tjetër. Çdo AL është pjesë përbërëse e Agjencisë. Anëtarët e AL-së veprojnë në emër të AKP-së dhe të gjitha veprimet dhe lëshimet e një AL-jë do të shihen si veprime dhe lëshime të Agjencisë<sup>25</sup>. Çdo person që shërben, ose angazhohet apo caktohet për të ndihmuar AL-në është "personi i punësuar apo i angazhuar nga Agjencia" brenda kuptimit të nenit 18.5 të Ligjit të AKP-së.

### 3.7 Të drejtat dhe kompetencat e AL-së

Pas emërimit të AL-së, të gjitha kompetencat e menaxhmentit dhe organeve kontrolluese të NSH-ve përkatëse do t'iu barten AL-ve. Në praktikë, kjo i fuqizon AL-të siç shpjegohet në nën-nenet në vijim:

<sup>24</sup> Ligji i AKP-së Neni 9.1 dhe neni 8 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së

<sup>25</sup> Ligji i AKP-së , Neni 9.3.

**3.7.1 Drejton ish-menaxhmentin e NSH-së**

AL-ja është e autorizuar të ndërmer të gjitha veprimet menaxheriale për dhe në emër të ish NSH-ve të nevojshëm ose i përshtatshëm për menaxhimin e punëve, afarizmin, dhe pronën e NSH-ve, duke përfshirë, por pa u kufizuar si në vijim:

- i) Hyrjen dhe inspektimin e lokaleve të NSH-së<sup>26</sup>;
- ii) Përfaqësimin dhe kryerjen e afarizmit të NSH-së<sup>27</sup>;
- iii) Krijimin dhe përfundimin e një regjistri të inventarit të të gjitha aseteve dhe detyrimeve të NSH-së dhe subjekteve të saj;
- iv) Ruajtjen dhe mirëmbajtjen e librave dhe korrespondencën afariste të NSH-së<sup>28</sup>;
- v) Kontraktimin e një pjese të aktiviteteve të NSH-së;
- vi) Vazhdimin ose Qiradhënien e cilësdo pronë të NSH-së dhe heqjen e qirasë nga cilado pronë e nevojshme apo e përshtatshme për vazhdimin e biznesit të NSH-së;
- vii) Ngritjen ose marrjen hua të parave dhe dhënien e letrave me vlerë mbi pasuritë e NSH-së.
- viii) Ekzekutimin në emër të NSH-së të çfarëdo titulli pronësor, pranim-dorëzimi apo dokumenti tjetër<sup>29</sup>;
- ix) Tërheqjen, pranimin, hartimin dhe mbështetjen e çfarëdo urdhër pagese me shkrim apo ndonjë njoftimi zotues me emër dhe në emër të NSH-së<sup>30</sup>;
- x) Operimin, hapjen, mbylljen dhe konsolidimin e llogarive bankare të NSH-ve dhe bërjen apo shkaktimin e ndonjë pagese të nevojshme apo të rastësishme për kryerjen e funksioneve të AL-së;
- xi) Punësimin dhe largimin e punëtorëve nga puna<sup>31</sup>;
- xii) I bënë kërkesë cilitdo punëtor apo kontraktues apo ndonjë kontakt tjetër afarist të NSH-së që të sigurojë informata të cilat i ka në dispozicion në lidhje me NSH-në;
- xiii) I bënë kërkesë cilitdo person i cili ka kontroll mbi dokumentet e ndonjë NSH-je që t'i sigurojë qasje në ato dokumente për shqyrtimin e tyre, riprodhim dhe ruajtje.

**3.7.2 Klasifikimi dhe kërkimi i borxheve, në falimentim të borxheve ndaj NSH-së**

AL-ja ka kompetencë të klasifikoj dhe të **parashtrij** kërkesë **ndaj palëve të treta të cilët kanë borxhe ndaj NSH-së** në likuidimin. Realizimin dhe shitjen e aseteve dhe pronave

<sup>26</sup> Ligji i AKP-së, Neni 6.1.9.

<sup>27</sup> Në praktikë, vazhdimi afat shkurtër i afarizmit mund të jetë i nevojshëm për të realizuar udhëheqje me rregull të inventarit si dhe mbledhjen e borxheve. Megjithatë, AL-ja duhet gjithmonë ta shohë arsyeshmërinë dhe përfitimi nga afarizmi para se të marrë një vendim të tillë.

<sup>28</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, neni 18.1.2.

<sup>29</sup> Ligji i AKP-së Shtojca neni 18.1.5

<sup>30</sup> Të gjitha transaksionet financiare (përveç transaksioneve rutine të tilla si pagesat për OSH-të dhe shërbimet e para-aprovuara) duhet të raportohen dhe të miratohen nga Drejtori i Financave dhe Buxhetit në Agjenci, Ligji i AKP-së Shtojca, neni 18.1.6.

<sup>31</sup> Ligji i AKP-së Shtojca neni 8 parasheh se: "Në mesnatën e Datës së Vendimit për Likuidim prishen të gjitha kontratat e punës që kanë qenë në fuqi deri atëherë ndërmjet ndërmarrjes dhe punonjësve të saj, nëse të tilla ekzistojnë ", d.m.th të gjithë të punësuarve të NSH-së u ndërpritet marrëdhënia e punës sipas Ligjit. AL-ja mund të punësojë OSHL për t'iu asistuar gjatë zhvillimit të procedurave të likuidimit, siç parashihet në, Ligjin e AKP-së neni 6.1.18 dhe Shtojcën 1, neni 18.1.12. Megjithatë, në përputhje me praktikën e Agjencisë, AL-ja është e kufizuar për punësimin e menaxhimentit të zgjedhur ekzistues dhe / ose të punësuarit për të vepruar si OSHL.

### 3.7.3 Realizimi dhe shitja e asetëve dhe pronës

AL-ja ka kompetencën për të marrë në posedim, **grumbullimin, rikthimin** dhe t'i marrin të gjithë hapat e nevojshëm për realizimin e pasurisë së NSH-ve dhe, për këtë qëllim, të hyjnë **apo inicij** procedura të tilla ashtu siç AL-ja e mendon të përshtatshme.

Brenda 60 ditëve nga shpallja e parë e datës së vendimit të likuidimit, AL-ja duhet të përgatisë listën e inventarit të NSH-së dhe t'i hedh asetet e NSH-së në propozim për shitje në likuidim. AL-ja duhet të japë arsyetim përse asetet e NSH-së duhet të shiten në **grupe** ose si prona individuale. Bordi duhet të vendosë për secilin aset veç e veç se si do të shitet. Gjatë vendimit të tillë, Agjencia duhet ta balançojë marrjen e çmimit më të lartë të mundshëm të shitjes **duke tentuar** për të minimizuar kostot administrative dhe barrën lidhur me formën zgjedhur e shitjes.

Në rrethana të caktuara, AL-ja mund të kërkojë aprovimin **paraprak nga** Bordi shitjen me anë të **negociatave** të drejtpërdrejta, si mënyrë kjo më realiste e **shitjes së pasurisë**, ose nëse është e qartë nga faktet se shitja me metodën e tenderit nuk do të jetë e suksesshme për shkak për rrethanave të rastit.<sup>32</sup>

### 3.7.4 Heqja dorë nga pronat e vështira

Duke iu nënshtruar aprovimit të DHPGJS-së të kërkesës të cilën AL-ja ia parashtron asaj, AL-ja mund të heq dorë prej një asemi ose asetëve të NSH-së në rrethana të caktuara sipas nenit 18.3.1 dhe 18.3.2 **të Shtojcës së Ligjit për AKP-në**

AL-ja mund të parashtrojë kërkesë në Gjykatë për ekzekutimin e një urdhri ndaj palëve të treta që janë në posedim të asetëve të NSH-ve që ato palë t'i kthejnë ato asete. Kur ekzekutimi është jopraktik<sup>33</sup>, AL-ja mund të dorëzojë kërkesë me shkrim në gjykatë me qëllim që të heqë dorë ose ta largoj interesin e NSH-ve mbi ato asete.

Kur prona e NSH-ve gjendet në vende të tjera dhe nuk mund të realizohet, AL-ja i kërkon gjykatës leje që të heqë dorë nga ajo pronë. Agjencia e krijon një regjistër të pasurisë prej të cilës është hequr dorë dhe ia dorëzon këtë pronë shtetit të Kosovës që të mbahet në mirëbesim.

DHPGJS-ja merr vendim lidhur me kërkesën e tillë jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë nga data e kërkesës nga AL-ja apo AKP-ja.<sup>34</sup>

### 3.7.5 Të inicijojë dhe mbrojë në procedurë ligjore në emër të NSH-së

AL-ja mund të inicijojë, mbrojë dhe të hyjnë në çfarëdo **aranzhime** ose kompromis për të shmangur ose përfunduar çdo veprim ose procedurë tjetër ligjore me emrin dhe në emër të NSH-së, nëse kjo është e nevojshme për **të mbrojtur apo avancuar vlerën e ndërmarrjes apo asetëve të saj**<sup>35</sup>.

Në praktikë, ndërsa AL-ja do të vlerësojë dhe rekomandojë kursin e veprimit, të gjitha kompromiset apo aranzhimet do të duhet të miratohen nga menaxhmenti i AKP-së.

### 3.7.6 Të pezullojë procedurat ligjore kundër NSH-ve

Çdo veprim gjyqësor, administrative ose i arbitrazhit, procedurë ku përfshihen NSH-të apo ndonjë aset i tyre që është i përfshirë në vendimin për likuidimin pezullohet pasi që Autoriteti i Likuidimit ta njoftojë gjykatën përkatëse, autoritetet publike apo gjykatën e arbitrazhit lidhur

<sup>32</sup> **Ligji i AKP-se Shtojca neni 18.1.4**, Politikat Operacionale të AKP-së, neni 7.10.6

<sup>33</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, neni 19.3

<sup>34</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, neni 19.7.

<sup>35</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-se neni 18.1.11. Asnjë veprim ligjor, kompromis apo aranzhman me një debitor ose kreditor nuk duhet të bëhet pa marrëveshjen paraprake me shkrim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

me vendimit për iniciimin e likuidimit. Ky njoftim [Shih formularin shabllon L31] duhet të shoqërohet me:

- i) Dëshminë për dorëzimin e njoftimit
- ii) Dëshmi për publikimin e informatave të përfshira në atë njoftim në një gazetë kryesore në gjuhën shqipe me tirazh më të madh në Kosovë, një herë në javë për dy javë rresht dhe në një gazetë kryesor në gjuhën serbe në pajtim me kriteret që duhet të përcaktuara nga Bordi;
- iii) Dëshmi për paraqitjen në faqen e internetit të AKP-së në gjuhën shqipe, serbe (dhe në anglisht nëse konsiderohet e nevojshme), nëse ekziston faqja e internetit në kohën e likuidimit; dhe
- iv) Dëshmi për njoftimin e subjekteve, të cilave AKP-ja u beson ose ka arsye për t'iu besuar, ose të cilat kanë kërkesë pronësore juridike ndaj NSH-në fjalë.

### 3.7.7 Anulimi i transaksioneve dhe shfuqizimi i transfereve të pronës dhe asetëve

AL mund të kërkojë pranë DHPGJS-së urdhrin për anulimin e çdo transferi të pronës apo asetëve të NSH-së të fituar gjatë periudhës prej 22 mars 1989 deri më datën e vendimit për Likuidim nga Bordi në përputhje me Ligjin e AKP-së, me kusht që të përcaktohet se transferet e tilla<sup>36</sup>:

- i) Janë bërë në vlerë më të vogël se vlera e drejtë e tyre;
- ii) Kanë **ulur vlerën totale të** asetëve të Ndërmarrjes;
- iii) Kishin për qëllim apo **për pasoj** e dëmtimit të interesit të kreditorëve;
- iv) Kishin për qëllim apo **rezultuan në humbjen**, vonimit apo pengimit të aftësisë të kreditorëve për të **mbledhur kërkesat** duke transferuar asetet tek pala e tretë kur pala e tretë ka qenë në dijeni apo është dashur të jetë në dijeni për qëllimin apo **ndikim**;
- v) Kanë qenë rezultat i transaksioneve me kreditorin ku kreditori ka fituar më shumë se pjesën proporcionale të asetëve të Ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodh në momentin kur kreditori është dashur të dijë që Ndërmarrja nuk ishte apo nuk do të mund të përmbushë obligimet e saja;
- vi) Ishin në **kundërshtim me** rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara **lidhur me imponimin e** sanksioneve ndërkombëtare, pavarësisht nëse më pas është **pranuar** nga vendimi i gjyqit apo vendim me arbitrazh; apo
- vii) Mund të anulohen apo përcaktohen si të pazbatueshme në bazë të cekur në nenin 36 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së apo ndonjë bazë tjetër ligjore.

Për qëllimin e këtij neni, transferi do të përfshijë çdo mënyrë (të drejtpërdrejtë apo jo, absolute apo të kushtëzuar, vullnetare apo jo) të bartjes apo transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, **shpërndarjes, zgjidhjes, lënies pengë**, hipotekë apo ndonjë drejtë tjetër.

### 3.7.8 Udhëzimet nga DHPGJS

Në çdo moment gjatë procedurës së Likuidimit, AL-ja mund të kërkojë udhëzime nga DHPGJS-ja lidhur me ndonjë dispozitë të Ligjit në fuqi duke përfshirë por jo kufizuar në çështjet lidhur me pajtueshmërinë me apo interpretimin e Ligjit të AKP-së dhe Shtojcës<sup>37</sup>.

### 3.7.9 Emërimi i eksperteve për të ndihmuar në likuidim

Nëse është e nevojshme AL-ja mund të angazhoj persona për të vepruar si agjentë apo për të ofruar ekspertizë, si p.sh juristë, kontabilistë, ekspert kadastral, drejtues vendor apo

<sup>36</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 21

<sup>37</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.

ndërkombëtarë ankandi apo agentë të shitjes apo persona tjerë të kualifikuar për të ndihmuar AL-në në kryerjen e detyrave të saja<sup>38</sup>. Për të dalluar emërimet e tilla nga ato të Ofruesve Profesional të Shërbimeve, personat e caktuar për të vepruar si ekspertë për të ndihmuar në likuidim janë të përshkruar si Ofrues Lokal të Shërbimeve (OLSh).

### 3.7.10 Sigurimi i NSH-së apo asetëve të saj

Me qëllim të mbrojtjes dhe sigurisë të pasurive të NSH-së, AKP-ja dhe AL-ja kanë kompetenca për të angazhuar shërbime të sigurimit në lidhje me biznesin dhe pronën e NSH-së.

## 3.8 Përgjegjësit dhe obligimet e AL-së

AL do të ketë përgjegjësitë në vijim:

### 3.8.1 Asetet e NSH-së

Duke marr parasysh resurset administrative dhe financiare në dispozicion, AL do të ndërmerr të gjithë hapat e duhur për të mbrojtur dhe siguruar asetet e NSH-së,<sup>39</sup> duke iu nënshtruar pritjeve që të gjitha shpenzimet ndërlidhëse do të kompensohen nga të ardhurat që pritet të realizohen nga shitja e këtyre asetëve.

### 3.8.2 Inventari i asetëve dhe kërkesave

Pas 60 ditësh nga publikimi i parë i Njoftimit për datën e Likuidimit, AL-ja do të ekzaminojë librat dhe regjistrat e NSH-së dhe do të përpilojë inventarin e asetëve dhe diagramin fillestarë të borxheve të saj. AL mund të shfrytëzojë regjistrat të përpiluara për qëllime të privatizimit për ta ndihmuar në këtë përpjekje.

AL është e obliguar të vlerësojë **vlefshmërinë, shtrirjen** dhe prioritetin e të gjitha kërkesave që janë bërë në lidhje me ndonjë NSH gjatë shqyrtimi të kërkesave AL ka të drejtë të:

- i) Konvertojë **tërësisht apo pjesërisht**, kërkesat **bazuara në kontratë**, në kërkesa për **kompensim** monetar;
- ii) **Kundërshtoj** ndonjë kërkesë, **tërësisht apo pjesërisht**, deri në atë masë deri ku kërkesa është e **përbushur në mënyra të tjera**; dhe
- iii) **Kundërshtoj kërkesën, tërësisht apo pjesërisht, sipas nevojës për të mbuluar shumën kërkesë për të cilën kërkuesi që detyrohet ndaj ndërmarrjes.**

### 3.8.3 Njoftimi për Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve

**Brenda** dhjetë (10) ditëve të punës pas datës së publikimit të parë të Njoftimit për Likuidim, AL-ja do të parashtrorë Njoftimin **formal** pranë Agjencisë për Regjistrim të Bizneseve. Njoftimit do të **iu bashkëngjitet** një kopje të vendimit për Likuidim dhe Njoftimin për Likuidim për të gjithë kreditorët dhe pronarët e NSH-së; dhe që shitja e asetëve të NSH-së mund të ndodh jo më herët se 60 ditë pas datës së njoftimit [*Shih Shabllonin L11*].

### 3.8.4 Obligimi për të informuar kreditorët

**Brenda** 20 ditëve nga emërimi, AL-ja është e obliguar të njoftojë me shkrim të gjithë kreditorët e njohur të NSH-së për vendimin për likuidimin e NSH-së dhe të kërkojë nga kreditorët të parashtrorë kërkesat pranë AL [*Shih Shabllonin L21 & L22*].

Pas njoftimit publik për Likuidimin (shih nenin 5.1 më poshtë), mund të pranohen kërkesa tjera dhe AL duhet të përgjigjet duke informuar pranimin e kërkesës [*Shih Shabllonin L23*] dhe i vë në dispozicion të kërkuesit formularin e kërkesës për Likuidim [*Shih Shabllonin L25A dhe L25B*].

<sup>38</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 18.1.12

<sup>39</sup> Ligji i AKP-së, Neni 19. 2.

### 3.8.5 Përgatitja e Raportit për Rezultatin e Parashikuar

AL është i obliguar të përcjell Likuidimin, **kurse** Zyrtari i Rastit është përgjegjës për përgatitjen e **Raportit** për Rezultatin e Parashikuar në përputhje me Shabllonin standard të AKP-së. Zyrtari i Rastit duhet të sigurohet që **Raporti i** Rezultatit të Parashikuar (RRP) azhurnohet me secilin ndryshim në: vlerësimin e likuidimit; koston e likuidimit; dhe gjendjen e ankesave sipas përcaktimit të AL-së dhe do të mbajë kopjen e verifikuar nga AL në regjistrin e rasteve. AL duhet të sigurohet që në mënyrë të drejtë pasqyron të gjitha realizimet e aseteve, nga aspekti aktual dhe sipas parashikimit. Detyrimet dhe ankesat, të pranuar dhe të refuzuara (që nuk janë proceduar) duhet të përfshihen për t'i dhënë AL-së një vlerësim real të rezultatit të Likuidimit. Në praktikë, duhet të pranohet që **Raporti i** Rezultatit të Parashikuar e përbën pjesën integrale të Sistemit të Menaxhimit të Likuidimit (SML) dhe shumica e informatave të cilat i përmban gjenerohen nga nën-sistemet tjera të SML-së. Pavarësisht nga kjo, AL ka përgjegjësi për të mbikëqyrë RRP për arsyeshmëri dhe për të hulumtuar dhe korrigjuar gabimet e zbuluara.

RRP do të tregojë potencialin për të paguar kreditorët. Një vlerësim i rezultatit të rastit duhet t'i sigurohet Kryesuesit të AL duke theksuar tepricat e mungesat e parashikuara dhe, aty ku është ekonomike dhe e mundshme, rekomandimin se ku mund të bëhen shpërndarjet duke iu nënshtruar provizionimit të nevojshëm. Të gjitha rekomandimet për shpërndarje duhet të diskutohen dhe të aprovohen me Departamentin e AKP-së për Financa dhe Buxhet.

### 3.8.6 Njoftimi publik për likuidim

Brenda 10 ditëve të punës<sup>40</sup> nga data e vendimit për Likuidim për emërimin e tij, AL do të publikojë Njoftimin për Likuidim<sup>41</sup> në përputhje me dispozitat për shpallje<sup>42</sup>:

- i) në gjuhën serbe dhe shqipe në **gazetat me tirazh më të madh në Kosovën**,
- ii) në gjuhën serbe në një **apo më shumë gazeta në gjuhën serbe që ka shitje të gjerë në Serbi dhe Mal të Zi, nëse** Autoriteti i Likuidit e konsideron të nevojshme për të njoftuar kreditorët, dhe
- iii) në ndonjë publikim në gjuhën angleze që ka **tirazh të madh** në Evropë, aty ku Autoriteti i Likuidimit e konsideron të nevojshme për të njoftuar kreditorët.

Brenda 15 ditëve pas publikimit fillestarë të Njoftimit për Likuidim, AL përsëri do të publikojë njoftimin me përmbajtje të njëjtë, siç është cekur më poshtë<sup>43</sup>, për të gjithë kreditorët dhe pronarët e NSH-së [*Shih Shabllonin L24*]:

- i) Data dhe përshkrimi i përgjithshëm i vendimit për Likuidim;
- ii) Referimi i Ligjit të AKP-së dhe Shtojcës dhe përshkrimi i përgjithshëm i të drejtave të Personave me Kërkesa apo Interesa;
- iii) Deklarata që Autoriteti i Likuidimit do të administrojë likuidimin sipas ligjit në fuqi dhe kësaj Shtojce;
- iv) Detaje për marrjen e formularit për Dëshmi të kërkesës dhe Dëshmi për Interes dhe si të aplikohet, së bashku me indikacion të qartë të afatit të fundit për parashtrimin e Dëshmive të Kërkesës dhe Interesit ("Afati i Parashtrimit të Kërkesës");
- v) Deklaratën që vetëm Kreditorët dhe Bartësit e Interesit me kërkesa të pranuar nga AL do të kenë të drejtën e pjesëmarrjes në shpërndarje dhe deri në masë të caktuar nga Ligji i AKP-së dhe Shtojca
- vi) Deklaratën e qartë se:

<sup>40</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 7.1

<sup>41</sup> Forma dhe përmbajtja e Shpalljes është specifikuar në Shtojcën 1 e Ligjit të AKP-së, Neni 7.2 .

<sup>42</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 49

<sup>43</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 7..5

- a) Ku të dorëzohet kërkesa dhe si të komunikohet me AL;
- b) Që të gjithë personat e interesuar për të parashtruar kërkesë në apo kundër NSH-së apo ndonjë nga asetet e saja duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesë dhe/ose Dëshmi të Interesit duke shfrytëzuar formularin standard të kërkesës (*Shih Shabllonin L25*) së bashku me tërë dokumentacionin e kërkuar brenda Afatit për Parashtrimin e Kërkesë, që do të jetë 16:00 në ditë pune që është dyzet e pesë (45) ditë pas datës së publikimit të Njoftimit për Likuidim;
- c) Që të gjithë Personat që pretendojnë që kanë Kërkesa apo Interese në apo kundër NSH-së apo ndonjë Aset të NSH-së duhet të parashtrojnë Kërkesën, pavarësisht nëse më herët kanë informuar Gjykatën, Agjencinë apo paraardhësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit);
- d) Që të gjitha Kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të duhur sipas afatit për paraqitjen e Kërkesës do të refuzohen dhe të **jenë përgjithmonë të parashtruara dhe të pa ekzekutueshme** ; dhe
- e) Ku dhe si një person mund të marr formularin standard dhe udhëzimet për parashtrimin e Dëshmisë për Kërkesë dhe Dëshmi të Interesit.

Më shumë detaje mbi vlerësimin dhe trajtimin e kërkesave mund të gjendet në këtë Udhëzues të Likuidimit, neni 9 më poshtë.

### 3.8.7 Pezullimi i të gjitha veprimeve ligjore

AL do të aplikojë për pezullimin e veprimeve ligjore kundër NSH-se përderisa këto veprime janë iniciuar nga ndonjë Gjykatë në Kosovë. Kur të kërkohet një gjë e tillë në Gjykatë, AL do të sigurojë informatat e kërkuara sipas Shtojcës të Ligjit të AKP-së, [*Shih Shabllonin L31*].

### 3.8.8 Inspektimi publik i inventarit të aseteve dhe diagrami i borxheve

AL do të sigurohet që inventari i aseteve dhe diagrami fillestar i borxheve të NSH-së të jetë në dispozicion për inspektim publik<sup>44</sup> për së paku tetë (8) orë në ditë për pesë (5) ditë pune para shitjes së aseteve. AL do të vë informatat e tilla në dispozicion në faqen elektronike të Agjencisë, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

AL rregullisht do të azhurnojë diagramin e borxheve sipas regjistrimit të kërkesave të reja të kreditorëve. Kjo informatë shpallet në dy mënyra: një përmes njoftimit të shpallur për të gjithë kreditorët [*Shih Shabllonin L 24*] dhe nëpërmjet shpalljes në faqen elektronike të AKP-së [*Shih Shabllonin L14*]<sup>45</sup>

### 3.8.9 Kreditorët e siguruar

AL do të shes apo ushtroj autoritetin e vet ndaj ndonjë prone apo aseti të NSH-së e cila është e siguruar përmes **garancisë, siç është zotimi, pagesa, hipotekë etj. Garancitë e tilla nuk e parandalojnë AL-në të tjetërsoj apo që në mënyra tjera të ushtroj kompetencat e tij ndaj personave të tretë, me kusht që shitja e tillë t'i njoftohet kreditorit nga ana e AL-së**<sup>46</sup>.

Nëse AL shet pronën e siguruar gjatë ushtrimit të autoritetit të vet, Kreditori i Siguruar do të ketë përparësi në shpërndarje për përmbushjen e kërkesës së siguruar siç është paraparë me Shtojcën 1 të Ligjit të AKP-së, neni 40.1.4.

AL mund t'i dorëzoj mbajtësit të se drejtës se siguruar të asetin i cili është ngarkuar me atë të drejt, apo nëse besohet se vlera e asetit të tillë në formë materiale tejkalon shumë e borxhit të shes asetin dhe të shfrytëzoj të ardhurat në përmbushjen e kërkesave tjera të kreditorëve.

<sup>44</sup> Politikat Operacionale të AKP-së, Neni 7.7.4.

<sup>45</sup> Politikat Operacionale të AKP-së, Neni 7.8

<sup>46</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 38.1

Nëse fondet e likuidimit të krijuara nga shitja e pronës së siguruar nuk mjaftojnë për përmbushjen e kërkesave të siguruara, pjesa e mbetur e kërkesave e pa përmbushur e kërkesës se siguruara do të trajtohet si e pasiguruara.

### 3.8.10 Shitja e asetëve me likuidim

Ekziston ndarja e qartë e përgjegjësive ndërmjet AL dhe Agjencisë në procesin e shitjes së asetëve me likuidim. Autoriteti i Likuidimit do të ketë përgjegjësi për propozimin e realizimit (shitjes) së Asetëve të NSH-së dhe Agjencia, nëpërmjet Departamentit të Shitjes do të organizojë dhe menaxhojë shitjen e asetëve të NSH-së në Likuidim.

AL ka për obligim që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga publikimi i parë i Njoftimit për Likuidim të përgatis inventarin e të gjitha asetëve të NSH-së dhe të propozojë menaxhmentit shitjen qoftë individuale apo të grupuar të asetëve të NSH-së. Autoriteti i Likuidimit do të ofroj arsyetimin pse asetet e NSH-së duhet të shiten në **grupe** apo asetë individuale.

Agjencia do të vendos si të klasifikojë ("Caktimi i Prioritetit") shitjet me likuidim të asetëve të NSH-së, individualisht ose grupe. Gjatë kësaj, Agjencia mund të shqyrtojë asetet individuale dhe/apo grupor, të cilët kanë asetë, për të cilat janë lajmëruar investitorët dhe kanë shprehur interesim për blerje, për tu klasifikuar me prioritet të lart për shitje.

Sipas rastit, AL mund t'i propozoj Menaxhmentit shitjen e asetëve të caktuara të NSH-së me negociata të drejtpërdrejta si mënyra më reale e shitjes të asetëve apo nëse është e qartë nga faktet që shitja me tender nuk do të ketë sukses për shkak të rrethanave të rastit.

### 3.8.11 Deponimi i të ardhurave nga likuidimi

Nëse kërkohet, AL-ja do të hap xhironlogarinë bankare në emër të NSH-së që është duke u likuiduar ku do të deponohen të gjitha fondet e NSH-së (nga shitja e NSH-së apo asetëve, duke përfshirë 75%<sup>47</sup> të bruto të ardhurat e privatizimit plus kamata, apo nga xhiro-llogaritë bankare dhe paraja e mbajtur nga NSH-ja në fillim të Likuidimit) dhe nga këtu do të paguhet të gjitha shpenzimet e Likuidimit dhe pagesat e shpërndarjes.

Transaksionet në xhiro-llogari bankare do të bëhen në përputhje me politikat e Agjencisë dhe do të mbikëqyren nga Departamenti i AKP-së për Financa dhe Buxhet. AL do të bëjë përpjekje për të shfrytëzuar xhiro-llogaritë bankare me përfitim nga kamata ku do të qëndrojnë për përfitim të **kërkuesve** duke iu nënshtruar nevojës së të gjitha fondeve për t'u mbrojtur nga ndonjë humbje.

Në praktikë, të gjitha transaksionet bankare janë rreptësisht të kontrolluara nga Departamenti i AKP-së për Financa dhe Buxhet. Nëse AL vendos të hapë xhiro-llogari bankare, është e nevojshme të kërkohet leja e Departamentit të AKP-së për Financa dhe Buxhet.

Të gjitha transaksionet në xhiro-llogari bankare mund të iniciohen nga AL mirëpo duhet të ketë autorizimin e Departamentit të AKP-së për Financa dhe Buxhet. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është zbatimi i rreptë i ndarjes së detyrave dhe kontrolli i fort i brendshëm për të siguruar që paratë në mirëbesim kontrollohen në mënyrë të sigurt dhe janë plotësisht transparente dhe të dokumentuara.

### 3.8.12 Caktimi i prioritetit të kërkesave

Prioriteti i kërkesave **dhe interesave** të cekura në **listën** e borxheve të NSH-së duhet të përlllogaritet në përputhje me Shtojcën 1 të Ligjit të AKP-së neni 40.

### 3.8.13 Lista përfundimtare e kërkesave

Sipas Shtojcës së Ligjit të AKP-së, neni 39, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas vlerësimit të të gjitha kërkesave duke përfshirë përcaktimin e kundërshtimeve ndaj vendimit të AL nga

<sup>47</sup> Politikat Operacionale, Pika 7.5



kreditorët e prekur lidhur me kundërshtimin apo zvogëlimin e kërkesave, AL do të përpiloj listën përfundimtare të kërkesave duke cekur shumën e tyre dhe statusin në përputhje me kategoritë e prioritetit të cekura në Shtojcën 1 të Ligjit të AKP-së, nenin 40.

Lista përfundimtare e kërkesave duhet të vendoset në faqen elektronike të Agjencisë brenda 30 ditëve nga përfundimi i vlerësimit të kërkesave (**Shtojca** e Ligjit të AKP-së, nenet 39.1 dhe 39.2).

Më shumë informata lidhur me **Lisën përfundimtare të kërkesave janë të përfshira në nenin 9.4** më poshtë.

### 3.8.14 Shpërndarja e të ardhurave nga shitja e aseteve

AL ka përgjegjësi për t'i rekomanduar Bordit të AKP-së shpërndarjen e parakohshme dhe përfundimtare. Ky Udhëzues i Likuidimit përfshin hollësi mbi Shpërndarjet në nenin 13.

### 3.8.15 Përfundimi i likuidimit

Brenda tridhjetë (30) ditëve nga Shpërndarja përfundimtare apo pasi të shpërndahen të gjitha fondet, AL do të kërkojë aprovimin e Bordit për Raportin Final<sup>48</sup>. Raporti i aprovuar final do t'i dorëzohet Gjykatës (DHPGJS)<sup>49</sup>.

Përmbyllja finale e rastit mund të bëhet vetëm pas kërkesës dhe marrjes së urdhrin nga DHPGJS për aprovimin e përmbylljes<sup>50</sup>.

## 3.9 Udhëzimet nga DHPGJS

Në çdo moment gjatë procedurës së Likuidimit, AL mund të dorëzojë kërkesën me shkrim tek DHPGJS për të kërkuar udhëzim lidhur me çështjen apo duke përfshirë, mirëpo jo kufizuar në ndonjë çështje lidhur me pajtueshmërinë me apo interpretimin e Shtojcës të Ligjit të AKP-së<sup>51</sup>.

AL mund t'i drejtohet DHPGJS-së me kërkesë me shkrim për gjykim të ndonjë çështje në ligj dhe DHPGJS-ja duhet të vendos për këtë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune<sup>52</sup>.

DHPGJS mund të jap urdher, proces, apo **aktgjykim** që është i arsyeshëm dhe i **domosdoshëm** apo i përshtatshëm për **t'i zbatuar** dispozitat e ligjit në fuqi apo për të ndihmuar likuidimin e ndonjë Ndërmarrje.<sup>53</sup>

### 3.10 Vlerësimi dhe vendimi i AL-së në kërkesa

Menjëherë pas afatit për parashtrimin e kërkesave, AL do të vlerësojë validitetin, dhe baza e kërkesave dhe do të njoftojë pretenduesit për rezultatet e vlerësimit<sup>54</sup>. Nëse kërkesat nuk janë të plota apo dëshmitë kanë mungesa, AL mund të kërkojë informatat dhe dëshmitë shtesë në afat prej 15 ditëve sipas pikës 7.7.7 të Politikave Operacionale të AKP-së. Më pas, nëse AL, refuzon, tërësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e kërkesës së parashtruar, do të njoftoj kreditorët me shkrim, duke dhënë shpjegimin për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës.

Sipas nenit 7.7.5 të Politikave Operuese të AKP-së, vlerësimi i validitetit të secilës kërkesë do të ndodh brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi dhe kërkuarit do të njoftohen brenda pesë (5) ditësh nga vlerësimi nëse kërkesa është përfshirë në diagramin e borxheve të NSH-së<sup>55</sup>.

<sup>48</sup> Politikat Operacionale të AKP-së, Nenin 7.14

<sup>49</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 43.1

<sup>50</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 44.1

<sup>51</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.1

<sup>52</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.2

<sup>53</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 48.3

<sup>54</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 37.4

<sup>55</sup> Shtojca e Ligjit të AKP-së, Neni 37.6

Vendimi i AL-së do të ketë formën e aprovuar nga Bordi i AKP-së [Shih shabllonët 50-58].

#### **4 MJETET KRYESORE PËR MENAXHIMIN E LIKUIDIMIT**

Agjencia për menaxhimin e likuidimit përdorë mjetet si në vijim

##### **4.1 Arkivi i likuidimit**

Arkivi i Likuidimit përmban të gjitha shënimet e likuidimit dhe fizikisht ndodhet në Zyrën Rajonale të AKP-së (ZR) që është përgjegjëse për likuidim. Ka mundësi që disa shënime të ruhen në ZQ të AKP-së siç është korrespondenca me gjykatë dhe korrespondenca me pretenduesit apo përfaqësuesit e tyre ligjor.

##### **4.2 Regjistri i kërkesave**

Regjistri i kërkesave mirëmbahet në ZQ të AKP-së dhe të gjitha kërkesat e pranuar evidencohen dhe iu vendoset data. Me fillimin e likuidimit, ato shpërndahen tek AL-ja përgjegjëse për likuidimin në ZR për procedim.

##### **4.3 Dokumentet standarde (shabllonet)**

Në tërë korrespondencën, duhet të shfrytëzohet Shablloni Standard dhe përmbajtja nuk mund të ndryshoj pa aprovimin paraprak të Departamentit Ligjor sipas rastit.

##### **4.4 Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit**

Sistemi i Menaxhimit të Likuidimit (SML) është mjeti kryesor për menaxhimin e të gjitha informatave për asetet, listën e kërkesave, kopjet e korrespondencës, vendimet e Autoritetit të Likuidimit, kopjet e vendimeve të Bordit dhe **Raportin** e Rezultatit të Parashikuar.

Është më se e rëndësishme që shitjet e aseteve dhe të gjitha vendimet për kërkesa të regjistrohen në SML pasi që ky përbën sistemin që përfshin **Raportin** e Rezultatit të Parashikuar.

SML përfshin nën-sistemet në vijim:

- Regjistrin e Dëshmimeve të Kërkesave
- Regjistrin e Dëshmimeve të Interesit
- **Raportin** e Rezultatit të Parashikuar
- Ditarin e sistemit të menaxhimit

Për qëllime të sigurisë, vetëm punëtorët e AKP-së mund të kenë qasje në SML për azhurnim. Ofruesit Profesional të Shërbimeve për AL mund të kenë qasjen vetëm për të lexuar shënimet.

##### **4.5 Të dhënat e Autoritetit të Likuidimit**

AL duhet të mbaj shënimet e aktiviteteve të saja dhe të gjitha shënimet lidhur me likuidimin duhet të ruhen në SML siç janë: kërkesat, vlerësimet, shënimet e aseteve të mbetura për shitje, vlerësimet e shpenzimeve të likuidimit, informata mbi provizionimin.

AL do të krijoj shënime shtesë siç janë oraret e Ofruesve Profesional të Shërbimeve (OPSh) dhe shënime të aktiviteteve të tyre.

## 5 NJOFTIMET PAS FILLIMIT TË LIKUIDIMIT

### 5.1 Kërkesa e njoftimit në përgjithësi

Çdo njoftim formal do të publikohet<sup>56</sup> në Kosovë në gjuhën serbe dhe shqipe në gazetën që ka shitje të madhe; nëse Autoriteti i Likuidimit e konsideron si të nevojshme, Njoftimet gjithashtu do të publikohen në:

- i) Gjuhën serbe në një apo më shumë gazeta në gjuhën serbe që ka shitje të madhe në Serbi dhe Mal të Zi; dhe
- ii) Në ndonjë publikim në gjuhën angleze që ka shitje të madhe në Evropë.

Komunikimet e standardizuara dhe formale, ftesat dhe formularët që do të shfrytëzohen nga Autoriteti i Likuidimit riprodhohen nga Agjencia në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, dhe nëse një person flet rrjedhshëm apo ka shprehur dëshirë për një gjuhë, atëherë nuk është e nevojshme që komunikata e tillë të dërgohet në tri gjuhët.

Në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, ligji i AKP-së parasheh që Dëshmitë e Kërkesave dhe Dëshmitë e Interesit duhet të parashtrihen në gjuhën shqipe ose gjuhën serbe<sup>57</sup>. Kjo megjithatë nuk e pengon Agjencinë që të pranojë një kërkesë në gjuhën angleze pasi që dokumentet e standardizuara dhe formale të komunikimit, ftesat dhe formularët e përgatitur nga AL duhet të krijohen dhe të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.<sup>58</sup>

### 5.2 Njoftim për të gjithë kreditorët e njohur

Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas publikimit të parë të Njoftimit të Likuidimit, AL do të dërgojë letër të gjithë kreditorëve të njohur duke përfshirë çdo person apo entitet *p.sh.* Ndërmarrjet Publike të evidencuara në libra dhe shënimet e NSH-së<sup>59</sup> [*Shih Shabllonin L22*], apo që paraqiten në listën e kërkesave (që duhet të merret nga Njësia e AKP-së për kërkesa [*Shih Shabllonin L21*], duke kërkuar parashtrimin e të gjitha kërkesave dhe informatave për kreditorit.

Kjo letër, që do të përfshijë kopjen e njoftimit të likuidimit, do të informoj kreditorët që ata duhet të paraqesin Dëshmitë e Kërkesës apo Dëshmitë e Interesit në përputhje me udhëzimet e cekura në letër.

Autoriteti i Likuidimit nuk ka obligim t'i dërgojë letër të tillë kreditorit apo bartësit të interesit, adresa e kujt nuk është shkruar lexueshëm në regjistrat e Agjencisë<sup>60</sup> apo regjistrat e Gjykatës që është në lidhje me ndërmarrjen.

### 5.3 Njoftimet për teprice teknologjike tek menaxhmenti dhe punëtorët e NSH-së

**Shtojca** e Ligjit të AKP-së, neni 8 parasheh që prej mesnatës së datës së Vendimit të Likuidimit, të gjitha kontratat e punësimit që janë në fuqi, nëse ka, ndërmjet Ndërmarrjes dhe punëtorëve të saj, të anulohen.

Agjencia (në praktikë AL) do të lëshojë letrën standarde duke këshilluar punëtorët për datën e Vendimit të Likuidimit dhe efektet e saj dhe kjo letër do t'i lëshohet secilit punëtorë në shërbim në datën e Vendimit të Likuidimit. Kjo letër do të përfshijë ftesën për të parashtruar kërkesat për pagat e papaguara apo kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës apo ndonjë drejtë tjetër apo kërkesë për punëtorët.

Përgjigjet në pyetjet tjera lidhur me të drejtat e punëtorëve janë përfshirë në Dokumentin e Politikave të AKP-së për Pagat e Papaguara që është e përfshirë në Shtojcën II, **Pika 3**.

<sup>56</sup> Ligji i AKP-së, **Shtojca**, Neni 49

<sup>57</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 50.1

<sup>58</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 50.2

<sup>59</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 7.4

<sup>60</sup> Në praktikë kjo duhet bërë për të përfshirë shënimet e Agjencisë dhe NSH-së.

#### 5.4 Njoftimet për institucionet publike

AL është e detyruar të lëshojë një Njoftim për Likuidim<sup>61</sup> te autoritetet publike:

- i) Gjykatat **përkatëse**
- ii) Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Pengut dhe Hipotekës
- iii) Agjencia për regjistrimin e Bizneseve
- iv) Agjencisë Kadastrale e Kosovës
- v) Administratës tatimore e Kosovës

Njoftimi do të dërgohet brenda 10 (dhjetë) ditëve **të punës pas datës së parë të publikimit të Njoftimit për Likuidim në gazeta**. Të gjitha Autoritetet Publike që pranojnë një njoftim të tillë do të jenë përgjegjëse për të siguruar që në kopje janë paraqitur si duhet të dhënat e tyre.

#### 5.5 Njoftimi për Regjistrin e bizneseve

AL-ja duhet të siguroj që njoftimi zyrtar për likuidim është dorëzuar në Regjistrin e Bizneseve brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas publikimit të parë të njoftimit për likuidimit [Shih shabllonin L11]<sup>62</sup> AL do të përfshijë një kopje të njoftimit në Dosjen për Likuidimit.

#### 5.6 Njoftimi për bankat

Menjëherë, pas emërimit të AL-se, ajo duhet ti njoftoj bankën<sup>63</sup> për Likuidim [ Shih shabllonin L19 B]. Ky njoftim ka për qëllim anulimin e autoritetit ekzistues të nënshkruesve në bankë(at) duke ndaluar në këtë mënyrë ndonjë transaksion të mëtejme të udhëzuar nga Drejtorët e NSH-së.

#### 5.7 Njoftimi për pezullim të veprimeve

Ligji i AKP-së parashohin kërkesë për pezullimin e veprimeve kundër një NSH-je në likuidim, në rast së veprime të tilla janë filluar në ndonjë gjykatë, me autoritet publik ose tribunalin e arbitrazhit<sup>64</sup>.

Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas publikimit të parë të Njoftimit për Likuidimit , AL-ja lëshon një njoftim për gjykatat në fjalë, autoritetet publike ( shih listën e **autoriteteve në 5.4 deri 5.6 me lart**) ose tribunalin e arbitrazhit ku janë parashtruar veprime për të pezulluar çdo veprim ligjor të pazgjydhur kundër NSH-së [shih shabllonin L31]. Kërkesa e tillë do të përcillet nga:

- i) Kopja e **Vendimit** për Likuidimit<sup>65</sup>;
- ii) Kopja e publikuar e Njoftimit për Likuidimit

AL-ja duhet të kontrolloj nëse gjykatat dhe autoritetet e tjera janë të njoftuara dhe posedojnë një kopje të njoftimit të publikuar në Dosjen e Likuidimit. Nëse skadon afati kohorë prej 30 ditësh, AL-ja do të aranzhoj një lëshim urgjent të njoftimit dhe ky veprim duhet të regjistrohet duke krijuar një shënim.

AL-ja do të bëjë kërkesa shtesë pas kësaj periudhe fillestare dhjetë ditëshe pasi që të jetë njoftuar lidhur me veprimet ligjore të panjohura më parë.

Njoftimi i përshkruar më lart do ketë efekte pezullimi të veprimeve kundër NSH- ve në likuidim siç përcaktohet në ligjin e AKP-së, Shoja, neni 10 në fjalë, për duke mos u kufizuar si në vijim .

<sup>61</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 19.6

<sup>62</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 19.6

<sup>63</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 19.6

<sup>64</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 10.

<sup>65</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 10.1

- a) Grumbullimi, **kthimin** ose zbatimimi i kërkesave për borxhet, taksat, gjobat ose obligimet e çdo lloji.
- b) Krijimi, **pranimin**, modifikimi, rritja, **përmbushjen**, **regjistrimin** ose zbatimimi **çdo** kërkesë ose interesi kundër ose ndërmarrjes ose ndonjë aseti të ndërmarrjes.
- c) Çdo veprim për të realizuar, **marrjen nën kontroll**, ose për të shitur ndonjë aset **të lëna** peng ose hipotekë ose ndonjë aset të ngarkuar ose për të ushtruar procesin ose kontrollin mbi asetet të ndërmarrjes; ose
- d) Procedurat ose veprimet **rregullative** më qellim të parandalimit **apo korrigjimin** të ndonjë shkelje të dispozitave rregullative, rregullave ose vendimeve, në një masë që përfshijnë kërkesat monetare kundër ndërmarrjes.

Duhet të theksohet se veprimet e pezulluara ose procedurat mund të vazhdojnë dhe të jenë efektive me lejen e AL-së ose gjykatës.

Gjithashtu duhet të theksohet se pezullimi i vendimeve dhe procedurave të cekura me lart nuk do të zbatohen në rastet e parapara në nenin 10.3 Shtojcës të ligjit të AKP-së.

## **6 MBLEDHJET E KREDITORËVE DHE KOMISIONET E KREDITOREVE**

### **6.1 Kreditorët, mbledhjet e kreditorëve dhe dëshmitë e kërkesave**

Kreditorët, takimet e kreditorëve, dëshmitë e kërkesës apo interesit, mbrojtja e interesit të kreditorëve dhe takimet si dhe komisionet e kreditorëve janë të rregulluara me dispozitat e Ligjit të AKP-së, **Shtojca**, neni 23, 24, 25 dhe 26.

## 7 ÇESHTJE OPERACIONALE

### 7.1 Sigurimi i librave dhe dosjeve

Ruajtja e sigurt e librave dhe dosjeve është çështje thelbësore për Likuidimin. Kjo është për arsye se “memoria e korporatës” humbet shpejt për shkak se menaxhmenti dhe punëtorët largohen apo pushohen nga puna.

Është vendosur një praktikë e zakonshme që arkivi të mbahet në objektet e NSH-së. Kjo duhet të konsiderohet në fazën planifikuese të Likuidimit dhe vendimi të merret në fillim sipas rekomandimit. Problemet mund të shfaqen posaçërisht pas privatizimit kur menaxhmenti i Ndër. së Re mund të mos bashkëpunoj. Kontratat mbi ruajtjen dhe disponueshmërinë e dosjeve vlejnjë vetëm për dy vite pas së cilës periudhë Ndër. e Re nuk do të jetë nën obligim. Personat të cilët kanë qasje në dosje për AKP-në është me siguri stafi i mëparshëm i NSH-së dhe mund të ketë konflikt interesash në lidhje me informacionet me të cilat ata do të merren.

Në Zyrën Qendrore të AKP-së ekziston njëسيا e ankesave në të cilën mbahen dosjet, ku janë të regjistruara pjesa dërmuese e kërkesave të paraqitura. Kuptohet që, pas emërimit, AL-ja kërkon që këto kërkesa të regjistruar të shikohen për tu krahasuar me kërkesat e pranuar pas publikimit të njoftimit të Likuidimit. Megjithatë, duhet pasur parasysh komentet e lartpërmendura në nenin 5.2 “Njoftim për të gjithë kreditorët”. Në këtë nen shihet se kërkesat e pranuar para Datës së vendimit për likuidim nuk janë të pranueshme në likuidim përveç nëse ato janë parashtruar përsëri pas Datës së vendimit për likuidim.

Përfundimisht, nëse nevojitet këshilla ligjore për ndonjë çështje të caktuar gjatë procesit të likuidimit, AL-ja mund të kërkojë këshillë dhe mbështetje nga Departamenti Ligjor i AKP-së.

### 7.2 Llogaria bankare e likuidimit

Menjëherë, pas emërimit të AL-së, Kryesuesi duhet të kërkojë nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit të AKP-së hapjen e llogarisë bankare të Likuidimit. Kjo kërkesë duhet të përmbajë emrin e saktë të NSH-së, numrin e regjistrimit të gjykatës, regjionin dhe qëllimin e llogarisë.

**Në këtë llogari bankare do të depozitohen të gjitha fondet e NSh-së (pa marr parasysh a janë fituar nga shitja e pasurive të NSh-së apo nga llogarite bankare dhe paratë e gatshme të mbajtura në NSh në fillim të likuidimit) dhe nga e cila do të paguhet të gjitha shpenzimet e likuidimit dhe pagesat që do të shpërndahen.**

#### 7.2.1 Llogaria bankare ekzistuese

Nëse NSH-ja ka një llogari bankare ekzistuese, duhet të njoftohet banka [Shih shabllonin L19B] dhe të ndërrohen nënshkruesit e autorizuar, apo të ngrihet llogaria; bilanci në atë moment duhet të konfirmohet dhe regjistrohet (preferohet një letër nga Banka). AL-ja do të ketë llogari të re bankare të Likuidimit ku do të transferohen fondet nga llogaria bankare e NSH-së.

### 7.3 Vijueshmëria e aktiviteteve afariste

Do të ishte një situatë e pazakonshme nëse AL-ja përfshihet në një afarizëm tregtarë në vazhdim e sipër. Mirëpo kjo mund të ndodh nëse NSH-ja ka një biznes që është dhënë me qira, qiramarrësi largohet duke lënë Agjencinë për të vendosur për likuidim, të vazhdojë me afarizëm apo të mbyllë.

Situata duhet të mbikëqyret për së afërmi nga AL-ja dhe çdo indikacion se veprimtaria mund të pësojë humbje për NSH-në në Likuidim duhet të detyrojë AL-në të konsultohet menjëherë me menaxhmentin e AKP-së për të kërkuar udhëzime mbi veprimet që duhen ndërmarrë.

#### 7.3.1 Pranimi ose refuzimi për vazhdimin e kontratave

Ligji i AKP-së, **Shtojca**, neni 20 i siguron AL-së kompetencën gjithëpërfshirëse për të refuzuar ose pranuar kontratat e papërfunduara. Nëse vendoset për të pranuar një kontratë **dhe më**

**vonë AL-ja e refuzon atë**, çdo ankesë që parashtrohet do të trajtohet si kërkesë për shpenzime administrative si në piken 1.3.5 të nënparagrafit 1.3 për paragrafin 1 të Ligjit të AKP-së Shtojca, neni 40.

Refuzimi i vazhdimit të kontratës rezulton në kërkesën për dëmet nga pala tjetër të cilat do të rezultojnë me kërkesë të pasiguruar në likuidim<sup>66</sup>.

#### **7.4 Paradhënie e parave të imëta**

Posa të fillojë Likuidimi, do të ketë nevojë të mbulohen disa shpenzime përfshirë këtu edhe shpenzimet e dërgimit të njoftimeve dhe shpalljeve. Prandaj, AL-ja parashtron kërkesë pranë Departamentit të Financave dhe Buxhetit për financimin e nevojshme. Departamenti i AKP-së për Financa dhe Buxhet duhet të përgatis buxhetin për financimin e nevojshëm.

Në përputhje me këtë, pas emërimit të AL-së duhet të përgatitet dhe miratohet një buxhet shpenzimesh të rastit<sup>67</sup>; dhe AL-ja duhet t'i kërkojë Departamentit të Financave parapagim në para të imtë.

#### **7.5 Njoftimi për likuidim të të gjitha palët e treta**

Të gjitha dokumentacionet që dalin nga AL-ja në lidhje me Likuidimin duhet të përmbajnë referencën që "NSH-ja është në Likuidim, që hynë në fuqi **prej dd/mm/vvvv**" së bashku me adresën dhe numrat kontaktues të ZR-së.

#### **7.6 Tatimi mbi vlerën e shtuar**

AL-të duhet të çregjistrojë NSH-në nga regjistri i ATK-së për TVSH (në rastet kur nuk ka të ardhura nga qiraja) duke filluar nga Data e Vendimit për Likuidim. Në praktikë, pasi që shumica e NSH-ve kanë borxhe të TVSH-së, autoriteti i ATK-së ngurron në çregjistrimin e entitetit përderisa të mos paguhet borxhi krejtësisht.

Në rastet kur ka të ardhura nga qiraja, AL-ja duhet të sigurojë që çdo muaj të paraqes me kohë një deklaratë të TVSH-së tek autoritetet e ATK-së.

Duhet të bëhet një analizë të detyrimeve të TVSH-së e cila tregon historinë e detyrimeve të analizuara sipas periudhave raportuese dhe duke theksuar pagesat apo pagesat e pjeshme të kryera nga NSH-ja. ATK-ja është mjaft e gatshme të ofrojë forma të shtypura të përlllogaritjeve të detyrimeve të TVSH-së të cilat tregojnë se ku janë aplikuar fondet e paguara sa i përket TVSH-së; Gjithashtu, këto forma të shtypura në përgjithësi ofrojnë detaje më të besueshme të çdo ndëshkimi dhe interesi të mbledhur nga ATK-ja se informatat në dispozicion nga librat dhe regjistrat e NSH-së.

Borxhi i NSH-së për TVSH duhet të krahasohet me përmbledhjen e ATK-së dhe duhet pasur kujdes që të sigurohet se përmbledhja e detyrimeve të pranuar në Likuidim (përfshirë TVSH-në) përjashton çdo detyrim të transferuar në privatizim tek një palë e tretë<sup>68</sup>.

Aty ku mund të zbatohet, TVSH-ja duhet të llogaritet dhe paguhet në datën e duhur. Nëse NSH-ja është e regjistruar për TVSH atëherë përdor numrin e regjistrimit të NSH-së.

<sup>66</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 20.1

<sup>67</sup> Buxheti për shpenzime të rastësishme është përfshirë në Dokumentet për Informimin e Bordit lidhur me Likuidim (Shablloni L01).

<sup>68</sup> Si rregull në privatizimin e një NSH-je detyrimi neto i papaguar i TVSH-së së NSH-së, duke mos përfshirë interesin dhe ndëshkimet të dala gjatë periudhës dymbëdhjetë (12) muajsh që mbaron në datën e përfundimit të privatizimit janë transferuar nga NSH-ja në një Ndër të Re. Shih politikat Operacionale, neni 5.7.6

Sipas Ligjit aktual në fuqi nuk duhet paguar TVSH për **transferin e aseteve dhe shitjen e aksioneve** në privatizim apo Likuidim<sup>69</sup>.

### **7.7 Vulat dhe çelësat e arkivit**

Nëse nuk janë mbledhur vulat dhe çelësat e arkivit të NSH-së gjatë “periudhës së tranzicionit” kjo duhet të kryhet me rastin e fillimit të Likuidimit.

### **7.8 Shërbimet komunale**

Ofruesi i Shërbimeve Komunale nuk mund të ndryshoj, refuzoj ose ndërpret shërbimet për shkak të procedurave të falimentimit, mirëpo AL-ja duhet të paguaj për periudhën nga data e Likuidimit. Një depozitë garantuese mund të kërkohet t’i paguhet kompanisë.

### **7.9 Ofruesit e shërbimeve të likuidimit (“OSHL-të”)**

AL-ja është përgjegjëse për përzgjedhjen dhe shfrytëzimin e OSHL-ve të bëjnë ndonjë afarizëm të nevojshëm për Ndërmarrjen, të cilën Autoriteti i Likuidimit nuk është në gjendje ta bëjë vet ose të cilin OSHL-ja mund të bëjë më shpejtë.

Numri i OSHL-ve varet nga natyra, madhësia dhe kompleksiteti i NSH-së në likuidim. AL-ja ka të drejt të përzgjedhë OSHL-të sipas kërkesës së saj. Veçanërisht, AL-ja mund të përzgjedh OSHL-të nga ish stafi i NSH-së në përputhje me Ligjin e AKP-së, neni 18, nënparagrafët 1.10 dhe 1.12 të Shtojcës.

Gjatë ndërmarrjes së këtyre detyrave, OSHL-ja apo agjenti janë të obliguar që të llogaritin kohën duke shfrytëzuar orarin e përgatitur për këtë qëllim.

### **7.10 Sistemi Menaxhues i Likuidimit (SML)**

Aktualisht çdo ZR e AKP-së mirëmban bazën e vetë të të dhënave të kreditorëve dhe aseteve të NSH-së brenda portfolios së tyre. Vetëm stafi i AKP-së, siç është miratuar nga Bordi në fillim të likuidimit, do të ketë autoritet të mirëmbajë dhe futë informata në SML. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale do të jetë i lejuar të ketë qasje në SML por vetëm me mundësi të leximit.

### **7.11 Vlerësimi i performancës dhe raportimi**

Nga fillimi i likuidimit, të gjitha informatat lidhur me rastin do të futen në SML. Mjeti kryesor i menaxhimit është “Raporti i Rezultatit të Parashikuar” (RRP) i cili do të ndihmojë AL-në të identifikojë “gjendjen” e rastit në likuidim, duke ofruar listat e aseteve të shitura ose që do të shiten (duke përfshirë vlerat e parashikuara të aseteve të pa shitura), ankesat dhe detajet mbi statusin e secilës ankesë, mundësitë për pagesën e dividendëve tek paditësit dhe, kur ka mungesë, prioriteti i ankesave dhe parashikimi i përqindjes së pagesave për secilin grup paditës. RRP mund të përdoret për të demonstruar para Menaxhmentit dhe Bordit të AKP-së se si Likuidimet individuale janë duke ecur drejt përmbylljes. RRP gjithashtu do të formoj një pjesë themelore të raportit të përmbylljes së rastit.

<sup>69</sup> Ligji i AKP-së, Neni 22.2. Dhe për shmangien e ndonjë dyshimi, kjo çështje ka qenë lëndë e MM me ATK-në.



## 8 PUNA ME ASETE

### 8.1 Siguria dhe mbrojtja e asetëve

Përgjegjësitë e përgjithshme të AL-së përfshijnë marrjen në posedim, **grumullimin**, rikthimin dhe marrjen e të gjithë hapave të nevojshëm për realizimin e asetëve të ndërmarrjes siç është rregulluar me Ligjin e AKP-së, Shtojca neni 18.

Gjithashtu mjetet e deponuara në bankë si dhe në thesar janë asete të ndërmarrjes që përfshihen në pronën e likuidimit.

#### 8.1.1 Disa pika të rëndësishme praktike lidhur me asetet e NSH-së në likuidim

##### Asetet në duar të palëve të treta

Ligji i ri i AKP-së ka dispozita specifike për AL-në për të kërkuar dorëzimin e asetëve në kujdes të palëve të treta si në vijim:

Autoriteti i Likuidimit lëshon njoftimin palëve të treta që **mbajnë** ose ka në posedim një aset të ndërmarrjes dhe i kërkon palës së tretë të **ndërpresin** posedimin dhe ti kthejë asetet e tilla tek Autoriteti i Likuidimit. Nëse është e nevojshme, Autoriteti i Likuidimit në emër të Agjencisë duhet të parashtroj në gjykatë kërkesën për urdhër për të zbatuar kërkesën e tillë. Nëse aset gjendet jashtë Kosovës, Autoriteti i Likuidimit mund të aplikojë pranë Gjykatës që ka autoritet mbi asetin dhe autoritet për zbatimin e kërkesës së tillë, apo Autoriteti i Likuidimit mund të aplikojë në Gjykatë për të lëshuar kërkesë për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar sipas paragrafit 2 të nenit 19 të Rregullave të Përgjithshme të Procedurave të Gjykatës të përcaktuara në Shtojcën e Ligjit për Dhomën e Posaçme. Nëse zbatimi i kërkesës së tillë dëshmon të jetë i pasigurt, jopraktik ose i ngadalshëm, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtroj kërkesë me shkrim në Gjykatë sipas paragrafit 4 të nenit 19, për autoritetin për mospranim ose shitje të interesit të ndërmarrjes në asete.

Nga të lartpërmendurat shihet që AL-ja është e autorizuar të ushtroj kontrollin dhe shitjen e asetëve në kujdes të palëve të treta në Kosovë mirëpo gjithashtu edhe asetet që gjenden jashtë Kosovës. AL-ja me kujdes do të vlerësoj meritat e gjurmimit të asetëve të tilla duke pasur parasysh shpenzimin/përfitimin në likuidim, praktikueshmërinë dhe realizueshmërinë e veprimeve të propozuara. Në rast se AL-ja vendos për heqje dorë, veprimi i tillë nuk duhet të ndërmerret pa miratim paraprak të DHPGJS.

##### Mallrat në transit

Nuk është e pazakontë për një NSH tregtare të ketë mallra në transit në të cilën ndërmarrja akoma nuk i ka marr të drejtat e pronësisë.

Nëse mallrat që iu janë shitur ndërmarrjes janë në transit në momentin e Vendimit të Likuidimit dhe Ndërmarrja nuk i ka marr të drejtat e pronësisë për ato mallra, shitësi mund të kërkojë t'i kthehen mallrat, ndërsa shitësi do të bart të gjitha shpenzimet e lidhura me kthimin dhe duhet ti kthejë AL-së çdo paradhënie të bërë nga Ndërmarrja<sup>70</sup>.

Ky veprim si dhe veprimet tjera lidhur me mallrat në transit janë të përcaktuara me nenin 29 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

<sup>70</sup> Shtojca i Ligjit për AKP-në, Neni 29.1

### **Prona e mbajtur në emër të personave të tretë**

Duhet të jetë tërësisht e qartë që prona e mbajtur në emër të personit të tretë nuk është prone e ndërmarrjes në likuidim dhe pronarët ligjor kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e pronës së tyre.

Kur ndërmarrja është agjent apo **ndërmjetësues** i palës së tretë i autorizuar për të pranuar ose shitur pronën që i takon palës së tretë, ajo palë mund të shfuqizoj statusin si agjent apo kujdestar dhe të kërkojë kthimin e pronës të mbajtur në kujdesin e ndërmarrjes duke parashtruar kërkesë me shkrim Autoritetit të Likuidimit

Kur në kohën e kërkesës për kthim të pronës është e pamundur të kthehet e tëra ose një pjesë e pronës së mbajtur në kujdesin e Ndërmarrjes në emër të palës së tretë, pala e tretë ka të drejtë të parashtrroj ankesë në çmimin e kontratës. Kur është e pamundur të përcaktoj çmimin kontraktues, çmimi i shitjes sipas datës për Vendim për Likuidim do të mbizotërojë.

Kur në kohën e kërkesës për kthim të pronës, Ndërmarrja posedon pronën që duhet shitur, mirëpo specifikacionet e saj i nënshtrohen një rënie të shpejtë dhe të rëndë në vlerë, si në rastin e mallrave që prishen, atëherë pronari ka të drejtë të parashtrroj kërkesë për çmimin kontraktues të pronës.

### **Asetet që i nënshtrohen sigurimit valid**

Ligji i AKP-së përcakton rrethanat në të cilat AL-ja mund ti dorëzoj asetet që i nënshtrohen sigurimit valid tek paditësi me drejtë pronësie apo mund të mos e dorëzoj atë nëse beson me arsye që vlera e asetit të tillë, materialisht tejkalon shumën e borxhit në fjalë.

### **Mallrat e harxhueshme**

AL-ja është autorizuar për të shitur mallrat **që prishen** që kërkojnë shpenzime të mëdha të mirëmbajtjes siç e sheh të përshtatshme Autoriteti i Likuidimit<sup>71</sup>.

#### **8.1.2 Paraja e imët**

AL-ja mund të deponojë çfarëdo paraje të gatshme të mbajtur nga NSH-ja në fillim të likuidimit në llogarinë e hapur në emër të NSH-së në likuidim.

Kujdes duhet pasur gjatë vizitës së parë në lokalet e NSH-së për të kërkuar konfirmimin e kërkesës lidhur me shumën dhe vendndodhjen e parasë së gatshme në (ose jashtë) lokalit. Kur të jenë identifikuar shumat të konsiderueshme të parasë së gatshme, është e rëndësishme të shprehet dyshimi për burimin si dhe arsyetimi pse fondet janë ruajtur në lokale ose në kujdes të menaxherëve ose punonjësve.

#### **8.1.3 Çështje kadastrale**

AL-ja duhet të hetojë të gjitha aspektet e çështjeve kadastrale, që ndërlidhen me asetet e mbetura të NSH-së. Të dhënat e ZR-së për tërë ngastrat e tokës që mbesin në posedim duhet të identifikohen në mënyrë të duhur dhe të harmonizohen me të dhënat kadastrale. Duhet siguruar që, të gjitha ngastrat e tokës në posedim të NSH-së janë identifikuar siç duhet dhe regjistruar në librat kadastrale.

Nëse AL-ja zbulon që asete të caktuara në posedim të një NSH-je në likuidim nuk janë regjistruar në kadastër në emër të NSH-së së tillë, AL-ja duhet të kërkojë dëshmi ligjore në bazë të së cilës AL-ja mund të regjistrojë asetet e tilla në emër të NSH-së në fjalë. Atëherë kur dëshmitë e tilla ligjore nuk janë në dispozicion, AL-ja edhe më tej mund të likuidojë asetet në fjalë.

<sup>71</sup> Shtojca Ligji për AKP-në, Neni 18.1.17

## 8.2 Anulimi i transaksioneve

AL-ja ka autoritetin të paraqesë kërkesë përmes Departamentit Ligjor të AKP-së në Dhomën e Posaçme për të shfuqizuar çfarëdo transaksioni<sup>72</sup> nëse transaksioni që mund të anulohet ka ndodhur gjatë periudhës prej 22 marsit 1989 deri në datën e vendimit për likuidim<sup>73</sup>. AL-ja duhet të paraqesë kërkesë në DHPGJS për shfuqizimin e transaksioneve të tilla nëse ka dëshmi të mjaftueshme që transaksioni ose kontrata ose çfarëdo pagese ose furnizimi lidhur me të:

- i) Është bërë për vlerë më të vogël se vlera reale;
- ii) **Kanë ulur vlerën totale të aseteve** të Ndërmarrjes;
- iii) Ka për qëllim ose efekt dëmtimin e interesave të kreditorëve;
- iv) Ka për qëllim ose efekt dëmtimin, vonimin ose pengimin e mundësisë së kreditorëve për të grumbulluar ankesat duke transferuar asetet tek palët e treta ku pala e tretë ishte në dijeni ose duhej të ishte në dijeni për qëllim të tillë ose efekt;
- v) Ishte si rezultat i transaksionit me kreditor, përmes së cilës kreditori ka marrë më shumë se sa aksione proporcionale të aseteve të Ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodhur në kohën kur kreditori në mënyrë të arsyeshme duhej të dinte që Ndërmarrja nuk kishte ose nuk do të kishte mundësi të përmbush obligimet e saja;
- vi) Ishte në shkelje të çfarëdo rezolute të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose Rregullore të Këshillit të Bashkimit Evropian e cila përcakton sanksione ndërkombëtare, pavarësisht që më pas mund të kenë njohur me ndonjë vendim gjykate ose vendim arbitrar; ose
- vii) Është i anulueshëm ose i përcaktuar të jetë i pazbatueshëm në ndonjë nga bazat e specifikuara në Ligjin e AKP-së Shtojca, Neni 36 ose çfarëdo baze tjetër ligjore

Transaksioni i anulueshëm duhet të përfshijë çfarëdo mënyre (të drejtpërdrejt ose të tërthortë, absolut ose të kushtëzuar, vullnetar ose jo të bartjes ose transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, shpagimit, pengut, hipotekës ose drejtat tjera<sup>74</sup>.

Në praktikë, ky anulim i transaksionit do të ketë vlerë të kufizuar pasi që NSH-ja për disa vite do të jetë nën kontrollin e AKP-së dhe Agjencisë paraardhëse.

DHPGJS-ja në shqyrtimin e urdhrin për anulim të transaksionit duhet të merr vendim deri në tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se katërdhjetë e pesë (45) ditë pas datës në cilën është parashtruar kërkesa në Gjykatë dhe kopja e saj është iu ofruar Komisionit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palët tjera sipas udhëzimit të Gjykatës<sup>75</sup>.

### Transaksionet në kërkesat jo-valide dhe të pavlefshme

Ligji i AKP-së, Shtojca, neni 36.2.4 i siguron AL-së kompetencat për të mohuar, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë e çfarëdo kërkesë ose interes të pretenduar ose interesin e pronësisë atëherë kur ekziston arsyeja për të besuar se transaksioni në të cilin është bazuar kërkesa është i anulueshëm në një nga disa baza siç është arsyeja për të besuar që transaksioni:

<sup>72</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 21

<sup>73</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 21.1.

<sup>74</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 21.2

<sup>75</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 21.3.

- i) Nuk është miratuar përmes procedurës të duhur të brendshme të ndërmarrjes;
- ii) Ishte ekzekutuar në emër të Ndërmarrjes nga dikush pa autoritet aktual ligjor për të detyruar Ndërmarrjen;
- iii) Nuk do të miratohej nëse do të parashtrohej për miratim të duhur të brendshëm, përfshirë mirëpo duke mos u kufizuar në kontrata që është dashur të miratohen nga Menaxhmenti ose Zyrtari i Ndërmarrjes në kohën përkatëse mirëpo nuk janë miratuar;
- iv) Ka ndodh në momentin përkatës në shkelje të detyrës zyrtare ose detyrës tjetër ndaj Ndërmarrjes ose personit të tretë nga Menaxhmenti ose Zyrtari sipas ligjit të zbatuar atëherë; ose
- v) Ka qenë në shkelje të rregullores së lëshuar nga KB ose rregullore ose akt i ngjashëm lëshuar nga organi autorizues i Bashkimit Evropian; dhe, në secilin rast të specifikuar në artikujt i deri iv të lartpërmendur mbi kreditorët ose ankuesi i interesit e dinte ose, gjatë hulumtimit të arsyeshëm paraprak, është dashur të jetë në dijeni për shkeljen e tillë, shkeljen ose mungesën e autoritetit.
- vi) Në momentin e transaksionit, kreditori ishte në dijeni, apo gjatë hulumtimit të arsyeshëm paraprak, është dashur të dijë ndërmarrja ishte insolvente dhe transaksioni vendosi kreditorin në pozitë më të favorshme se sa kreditorët tjerë;
- vii) Transaksioni ishte bërë në vlerën që materialisht ishte më e vogël se vlera e tregut që mbizotëronte në atë kohë;
- viii) Pagesa ose furnizimi lidhur me transaksionin ishte në shkelje të një ose më shumë rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose Rregulloreve të Bashkimit Evropian që përcaktojnë sanksione ndërkombëtare; ose
- ix) Ankesa ndërlidhet me transaksionin që ka ndodhur jashtë Kosovës dhe:
  - a. Ka të bëjë me entitetin ose entitetin e supozuar ose njësinë e biznesit që në kohën e vendimit efektiv të Likuidimit është menaxhuar ndaras nga operacionet e Ndërmarrjes në Kosovë dhe
  - b. AL-ja ka përcaktuar se nuk është praktike marrja në kontroll në emër të NSH-së të pronës apo asetëve të atij subjekti. Të gjitha transaksionet e tilla të realizuara në emër të NSH-së do të përfshij transaksionet, për të cilat qëllimi afarist është kufizuar në subjektin e pavarur apo njësinë e biznesit.

Kujdes duhet kushtuar vlerësimit të transaksionit kundër kriterëve të gjera të specifikuara më lart. Nëse transaksioni është i anulueshëm, atëherë kërkesa e bazuar në transaksion duhet të refuzohet. Veç kësaj, çfarëdo transaksioni që nuk plotëson dispozitat e mësipërme duhet të konsiderohet në kontekst të Ligjit për AKP-në, neni 27 pasi që AKP-ja mund të jetë e mundur që do të ketë kompetencën t'i vendos ndëshkime paditësit.

### 8.3 Shitja e asetëve

#### 8.3.1 Realizimi i asetëve

*Kompetenca për të shitur asetet parashikohet me Ligjin e AKP-së, Shtojca, Neni 18. mirëpo **për raste të veçanta kërkohet miratimi paraprak i Bordit në pajtim me Neni 18.1.4 ndërsa konform nenit 18.1.3 Autoriteti i Likuidimit ka kompetencë të marrë në posedim, mbledh, rifitoj dhe të marr të gjitha hapat e nevojshëm për realizimin e pronës së NSH-së dhe, për këtë qëllim të hyjë apo të nisë procedura të tilla ashtu siç AL i konsideron të volitshme.***

Për të krijuar ndarjen efektive të detyrave dhe kontrollit të brendshëm brenda Agjencisë, shitja e asetëve do të menaxhohet dhe kontrollohet nga Departamenti i Shitjes i AKP-së në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultim me Autoritetin e Likuidimit. Gjithashtu, të gjitha marrëveshjet kontraktuale do të menaxhohen dhe kontrollohen nga Departamenti Ligjor i AKP-së.

Roli i Autoritetit të Likuidimit do të përbëhet në propozimet për Menaxhmentin për grupim dhe/ose bashkim të asetëve të NSH-së për shitje me likuidim. Autoriteti i Likuidimit duhet të arsyetoj pse asetet e një NSH-ja duhet të shiten në grupe ekonomiksht racionale përpos nëse beson dhe sqaron që një mori e shitjeve individuale (jo të grupuara) të asetëve do të arrinin çmimin e shitjes më të lartë se ai që do të arrihet nga shitjet e asetëve në grupe, të mjaftueshëm për të arsyetuar shpenzimet e larta administrative lidhur me shitjen e shitjeve individuale.

##### 8.3.1.1 Asetet jashtë Kosovës

Ligji i AKP-së parasheh që nëse aset i gjendet jashtë Kosovës, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkoj nga cilado gjykatë që ka juridiksion mbi asetin dhe autoritet, duke kërkuar nga pala e tretë që kujdeset apo është në posedim të Asetit, të ndërpret kujdesin apo posedimin e tillë dhe të kthej këtë Aset tek Autoriteti i Likuidimit. Aq më tepër, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtrijë kërkesë pranë Dhomës së Posaçme të lëshoj kërkesën për bashkëpunim ligjor ndërkombëtarë **në përputhje me Shtojcën e Ligjit Nr. 04/L-033 për DHPGJS, Neni 19.3 – Rregullat e Përgjithshme të Procedurës.** Atëherë kur zbatimi i kërkesës së tillë dëshmon të jetë i pasigurt, jopraktik ose i papërshtatshëm, Autoriteti i Likuidimit zbaton Nenin 19.4 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

AKP-ja mund të ndërmerr veprime të tilla me institucionet përkatëse në Kosovë dhe gjetiu për të kërkuar ndaljen e shitjes ose veprimet tjera nga palët e treta që janë në shkelle ose konflikt me autoritetin e Agjencisë dhe të vendos shpalljet e dhura jashtë Kosovës në shtetet fqinje përkatëse për t'i paralajmëruar për autoritetin e Agjencisë, dhe veprime të tilla të tjera.

#### 8.3.2 Metodat e shitjes së asetëve

Të gjitha shitjet e asetëve duhet të menaxhohen dhe kontrollohen nga Departamenti i Shitjes i AKP-së në bashkëpunim të ngushtë dhe konsultime me Autoritetin e Likuidimit. Kjo qasje do të shfrytëzohet për të krijuar ndarje efektive të detyrave dhe kontroleve të brendshme brenda Agjencisë. AL-ja i propozon Menaxhmentit të AKP-së grupimin dhe/ose bashkimin e asetëve të NSH-së për shitje përmes likuidimit (**neni 18.1.3 i shtojcës së Ligjit për Agjencinë**). Agjencia organizon shitjen e asetëve me likuidim dhe vendos nëse asetet e NSH-së shiten përmes ankandit publik ose tenderit të hapur.

Agjencia përcakton për çdo rast se si duhen të shiten asetet. Në përcaktimet e tilla, Agjencia kërkohet të balancoj synimin për marrjen e çmimit më të lartë mundshëm të shitjes me nevojën për të minimizuar shpenzimet administrative dhe detyrimet e ndërlidhura me mënyrat e zgjedhura të shitjes.

**Në raste të jashtëzakonshme Autoriteti i Likuidimit mund të kërkoj miratimin paraprak nga Bordi për të shitur asetin e Ndërmarrjes Shoqërore përmes negociatave të drejtpërdrejta. (Neni 18.1.4 i Shtojcës së Ligjit).**

### **8.3.3 Shpalljet**

Njoftimi publik duhet të paraprijë të gjitha shitjet e asetëve Qëllimi është i dyfishtë: së pari të tërhiqet sa më shumë që të jetë e mundur interesi i ofertuesve dhe së dyti të mbrohet interesi i pronarëve të mundshëm të cilët mund të kenë të drejtë në të ardhura nga shitja e tyre.

### **8.4 Modeli i rregullave të tenderit**

Rregullat e tenderit janë të parapara me nenin 6.5 dhe 7.9 të Politikave Operacionale të aprovuara nga Bordi i AKP-së

9

**PUNA ME KERKESAT E KREDITOREVE****9.1 Të përgjithshme**

AKP-ja posedon me formular standard të kërkesave, atë të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit (neni 2 paragrafët 1.14 dhe 1.15 të Shtojcës së Ligjit) dhe ka autoritet të duhur për të insistuar që të gjitha kërkesat të parashtrihen në këtë formular standard. Për të ndihmuar ankuesit, AKP-ja publikon shënime udhëzuese se si të regjistrohet një kërkesë

**9.2 Prioriteti i kërkesave**

Caktimi i prioritetit të kërkesave duhet të bëhet në pajtueshmëri me Shtojcën e Ligjit për AKP-në<sup>76</sup>. Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të trajtohen sipas klasifikimit të klasave 1.1 – 1.8 të Nenit 40 të Shtojcës të Ligjit për AKP-në.

Caktimi i prioritetit të kërkesave është i rëndësishëm. Së pari, kërkesat brenda kategorisë së njëjtë klasifikohen në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh kohën kur kërkesat paraqiten<sup>77</sup>. Së dyti, arsyeja për klasifikim është dhënë në Shtojcën e Ligjit për AKP-në, Neni 41, që parashihet përmbushjen e ankesave si në vijim:

Kërkesat përmbushen sipas klasës dhe rendit.

Trajtimi i Ankesave dhe interesit që i takojnë rangut pasues me prioritet më të ulët mund të iniciohen vetëm pas trajtimit të plotë të **kërkesave** nga klasa paraprake me prioritet më të lart<sup>78</sup>.

Pasi që ankesat duhet të trajtohen sipas prioritetit me klasë dhe rend, ndonjë mungesë në likuidim do të rezultojë në nivelin e kreditorëve që pranojnë shpërndarje të më pak se 100% të kërkesave të tyre me kërkesat e prioritetit më të ulët dhe pasues që nuk pranojnë asgjë. AL-ja duhet të jetë e vetëdijshme për këtë informatë të rëndësishme në të gjitha nivelet e likuidimit dhe për të siguruar këtë, AKP-ja ka dizajnuar "**Raportin e Rezultatit të Parashikuar**" që është integruar në sistemin e menaxhimit të likuidimit.

Në rast se për një nivel të kreditorëve nuk do të **mbesin** të ardhura, vlerësimi i këtyre kërkesave **do të jetë i panevojshëm** kështu që puna duhet të përfundohet pasi që faktet të bëhen të njohura.

**9.3 Trajtimi i kërkesave****9.3.1 Regjistri i kërkesave**

Siç është përmendur edhe më herët, brenda dhjetë (10) ditësh pas publikimit të parë të Njoftimit për Likuidim, AL-ja duhet ti njoftojë të gjithë kreditorët e njohur të NSH-së me shkrim për fillimin e likuidimit se ata duhet të paraqesin Dëshmitë e Kërkesës apo Dëshmitë e Interesit në përputhje me Njoftimin për Likuidim.

Është parim i përgjithshëm i të gjitha sistemeve ligjore që personi që parashtron një ankesë në likuidim, atëherë bartë barrën e dëshmisë për të. Në mungesë të kërkesave specifike ligjore për

<sup>76</sup> Shtojca Ligji i AKP-së, Neni 40

<sup>77</sup> Shtojca e Ligjit të AKP –së, Neni 40.2.

<sup>78</sup> Shtojca e Ligjit të AKP –së, Neni 41.2

forma të veçanta të dëshmisë, **kreditori** mund të dëshmojë kërkesën me çdo mënyrë që është e besueshme apo relevante.

### Dëshmia e kërkesës

Formulari për Dëshminë e Kërkesës duhet t'i përbëjë informatat e përcaktuara me Nenin 23.1 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

### Dëshmia e interesit

Formulari për Dëshmi të Interesit duhet të përmbajë informatat e përcaktuara me nenin 23.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së.

Kur të parashtrohet kërkesa, AL-ja duhet të merr parasysh se çfarë dokumente apo të dhënash duhet të ekzistojnë në mënyrë që të vërtetohet kërkesa. Nëse **pretenduesi** nuk i ka siguruar këto dokumente atëherë AL-ja duhet të kërkojë me shkrim nga ai që ta bëjë këtë brenda 15 ditësh në pajtim me nenin 37.5 të Shtojcës të Ligjit të AKP- së dhe Politikave Operacionale pika 7.7.7.

AL-ja duhet të shqyrtojë nëse kërkesave iu ka kaluar afati i përcaktuar me ligj, dhe nëse kërkesat e tilla nuk janë sjellë në mënyrën dhe në afatin e duhur në Gjykatën që ka juridiksion ato do të refuzohen dhe nuk do të jenë të kualifikueshme që të marrin pjesë në ndonjë shpërndarje përmes likuidimit<sup>79</sup>. Duhet të merret parasysh se të gjitha **kërkesat** dhe interesat në procesin e likuidimit të NSH-së që nuk janë parashtruar në mënyrë të duhur brenda afatit për parashtrimin e **kërkesave** do të refuzohen dhe do të mbyllen përgjithmonë si të pazbatueshme<sup>80</sup>.

### 9.3.2 Kërkesat e siguruara

Në radhë të parë, duhet të theksohet se ngarkesat mbi asetet e NSH-se do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë të krijuar dhe të regjistruara bazuar në Ligjin për Pronat dhe të Drejtat Sendore. AL-ja tek asetet e **me ngarkesë** me masë siguroese mundet të veprojë në dy mënyra.

Së pari është kur e drejta e siguruar është e vlefshme dhe AL vendos të ja dorëzojë asetin ose pronën e siguruar me atë të drejtë kreditorit të siguruar. Së dyti është kur AL-ja vendos të shesë pasuritë e ngarkuara me të drejtë siguroese për të zbatuar në mënyrë efektive likuidimin .

Situatat kur aseti i dorëzohet kreditorit të siguruar duhet të kufizohen në situata ku:

- i) Marrëveshja themelore e sigurimit lejon në mënyrë të veçantë peng mbajtësin që të merr në posedim asetin e mbajtur peng nëse kreditori nuk është paguar plotësisht;
- ii) Sigurimi është në formë të marrëveshjes së vlefshme të "Mbajtjes së titullit". Marrëveshja e tillë siguron që e drejta ligjore nuk i kalon blerësit deri sa furnitori të jetë paguar në tersi. Nëse marrëveshja e vlefshme e "Mbajtjes së titullit" ekziston, atëherë NSH-ja asnjëherë nuk e ka pasur në posedim asetin dhe se furnitorit i takon posedimi por AL-ja duhet të sigurojë se të gjitha kostot që janë të lidhura me heqjen e aseteve janë përgjegjësi e vetme e furnitorit apo.
- iii) Vlera e kërkesës realisht tejkalon vlerën e asetit. Në këtë skenar, nuk ka ndonjë pikë në AL që është e rregulluar për shitjen e aseteve përveç nëse aseti është thelbësor për shitjen e ndonjë aseti tjetër që mund të arrihet më së miri duke u sistemuar si grup asetesh.

<sup>79</sup> Ligji t AKP –së, Shtojca, Neni 37.4.1

<sup>80</sup> Ligji t AKP –së , Shtojca, Neni 7.2.6.4



Në rast se vlerësohet se vlera e Aseteve të Siguruara është më e vogël se sa kërkesa e parashtruar dhe e pranuar nga AL-ja dhe AL-ja vendos që t'ia dorëzoj asetin kreditorit të siguruar<sup>81</sup>, AL-ja duhet të kërkoj nga kreditori i siguruar që t'i heq asetet në fjalë. Megjithatë, nëse shitja e asetit nga ana e kreditorit të siguruar rezulton me suficit kundrejt borxhit të siguruar ai është i detyruar me ligj që ta përcjell suficitin të AL-ja.

#### 9.3.2.1 Shitja e asetëve të siguruara nga AL-ja

Kërkesat e siguruara me ane të garancisë siç është pengu, zotimi, hipoteka, pagesa apo siguri tjera mbi një pronë apo aset të NSH-së nuk parandalojnë AL në ushtrimin e kompetencave të tij. Për më tepër shih shtojcën e ligjit për AKP-në neni 38.1, 38.2 dhe 38.3.

### 9.3.3 Çështje specifike lidhur me kërkesat

#### 9.3.3.1 Kërkesat për kamata

Të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së vendimit të likuidimit me kushte që kjo kamatë të mos kalojë 10% të shumës themelore.

#### 9.3.3.2 Kërkesat në **valuta** tjera nga ajo e euros

Kërkesat e parashtruara në valutë tjetër jo në Euro do të konvertohen në Euro me anë të normës së këmbimit të datës së **Vendimit të Likuidimit. (neni 37.2 i Shtojcës së Ligjit).**

#### 9.3.3.3 Kërkesat për performancë të veçante

AL-ja është e autorizuar për të shndërruar ndonjë kërkesë për performancën e veçantë të kontratës, duke përfshirë por jo të limituar, në një kërkesë për **kompensim** monetare<sup>82</sup>.

#### 9.3.3.4 **Precizimi i kërkesave që nuk e kanë arritur afatin e pagesës**

**Për arsye të parashtrimit të Dëshmisë së Kërkesës, kërkesat që nuk e kanë arritur afatin e pagesës do të konsiderohen të afatshme që nga data e vendimit për likuidim.**

#### 9.3.3.5 **Kundërshtimi në tërësi apo pjesërisht i kërkesave**

**AL ka autoritet të pakufizuar të kundërshtoj kërkesat e parashtruara tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin nëse kërkesa e parashtruar është përmbushur në ndonjë mënyrë tjetër<sup>83</sup>.**

#### 9.3.3.6 *Borxhet e dyanshme*

Çështja e borxhit të dy anshëm është e rregulluar me dispozitën ligjore të Shtojcës të Ligjit për AKP-në Neni 37.9.3.1 deri 37.9.3.4.

#### 9.3.3.7 *Dispozitat kontradiktore në një kontratë*

Dispozitat në Shtojcën e Ligjit të AKP-së do të mbizotërojnë në rast të ndonjë dispozite kontradiktore në kontratë, zgjedhje, marrëveshje, gjykim ose ndonjë marrëveshje tjetër autoritative që është filluar, në emër të ose lidhur me NSH-në. **AL ka autorizim për të kundërshtuar çfarëdo marrëveshje reciproke ndërmjet Ndërmarrjes dhe parashtruesit të kërkesës apo paraardhësve të tyre lidhur me shumat e pagesës, transaksionet brenda periudhës 3 mujore pas datës së vendimit për likuidim si dhe shumave të detyrueshme para vendimit për likuidim.**

81 Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 18.2.

82 Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 37.9.1.

83 Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 37.9.2.

### 9.3.4 Bazat për refuzimin e kërkesave në tërësinë e tyre

#### 9.3.4.1 Kërkesat e parashkruara

Afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit.

Koha e cila nevojitet për parashkrim është përcaktuar në Ligjin mbi Bazat e Marrëdhënieve të Detyrimeve GZ 29/1978.

- Kërkesat parashkruhen për 5 vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër (neni 371).

- Kërkesat për dhënie periodike ato periodike aksesore parashkruhen 3 vjet nga rrjedhja e secilës dhënie (neni 372).

- Kërkesat reciproke të personave shoqërorë – juridik nga kontrata në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve si dhe kërkesat për kompensim të shpenzime parashkruhen për 3 vjet (neni 374), ndërsa kërkesat për shpërblim nga dëmi i shkaktuar parashkruhen për 3 vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që ka shkaktuar dëmin (neni 376).

- Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose vendim të organit tjetër kompetent ose pajtimit gjyqësor ose organit tjetër kompetent parashkruhen për 10 vjet (neni 379).

#### 9.3.4.2 Afati i parashtrimit të kërkesës

Afati për parashtrimin e kërkesave është përcaktuar në nenin 7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë ora 16:00, një ditë pune, dyzet e pesë ditë (45) pas datës së publikimit të njoftimit të bërë nga Autoriteti i Likuidimit në pajtim me dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që ti parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe Interesit<sup>84</sup>.

AL në diskresionin e vet mund të pranoj dëshminë e kërkesës apo interesin në kërkesat e parashtruara pas afatit, nëse kreditori i pretenduar apo mbajtësi i interesit ofron dëshmi të arsyeshme/mjaftueshme për parashtrimin e kërkesës me vonesë, nëse dëshmia e kërkesës apo interesi është parashtruar jo më vonë se 30 ditë pas afatit<sup>85</sup>.

#### 9.3.4.3 Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta

Duke ju referuar Shtojcës të Ligjit të AKP-së apo me Urdhër të Gjykatës, Autoriteti i Likuidimit mund të refuzoj tërësisht apo pjesërisht vlefshmërinë e kërkesave të parashtruara nga pretenduesit:

- i) kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme.
- ii) Dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar nga kreditori apo interesi mbetet i mangët pas kërkesës nga AL-ja për dokumentet shtesë; ose
- iii) Dokumentacioni i paraqitur është mashtrues ose ekziston ndonjë arsye për të dyshuar një qëllim për të mashtruar, ose
- iv) Ekziston arsyeja për të besuar që transaksioni:
  - a. Nuk ishte aprovuar përmes procedurave të brendshme të duhura të NSH-së<sup>86</sup>;
  - b. Ishte ekzekutuar në emër të NSH-së nga dikush jo kompetent;

<sup>84</sup> Ligji ti AKP –së, Shtojca , Neni 7..2..6.2

<sup>85</sup> Ligji i AKP –së, Shtojca, Neni 35..3

<sup>86</sup> Ligji ti AKP –së, Shtojca, Neni 36..2.4.1

- c. Nuk do të aprovohej nëse do të ishte dorëzuar për aprovimin e duhur të brendshëm, duke përfshirë por jo i limituar për kontratat, të cilat duhej të ishin aprovuar nga Menaxhmenti ose nga një Zyrtar i NSH-së në kohën e duhur por nuk ishin aprovuar ashtu;
- d. Ka hyrë në fuqi në kohën e duhur në prishjen e detyrës së lënë në mirëbesim ndaj NSH-së nga Menaxhmenti ose një Zyrtar nën Ligjin e Aplikueshëm;
- e. Ka qenë në shkelje të ndonjë rregulloreje të KB-së ose të ndonjë rregullore apo akti të lëshuar nga një organ i autorizuar i Bashkimit Evropian; dhe, në secilin rast siç është specifikuar në piken "iv-a" menjëherë pasi që kreditori në fjalë apo kërkuesi i interesit ka qenë i njohur me apo, gjatë ushtrimit të profesionit në mënyrë të arsyeshme dhe me përgjegjësi/diligjencë është dashur të këtë ditur për shkeljen në fjalë, apo mungesën dhe shkeljen e kompetencës
- v) Në kohën kur transaksioni kishte hyrë në fuqi, kreditori e ka ditur ose në mënyrë të arsyeshme duhet të ketë ditur që NSH-ja ishte e **insolvente** dhe se transaksioni ka rezultuar që kreditori është vendosur në një pozitë më të favorshme se kreditorët e tjerë; ose
- vi) transaksioni është bërë në një vlerë e cila ishte më pak se vlera e tregut ose vlera e tregut të hapur;
- vii) Paguesa në lidhje me transaksionin ishte në shkelje të një ose më shumë vendimeve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara duke imponuar sanksionin ndërkombëtarë; ose
- viii) Kërkesa ka të bëjë me transaksionet të cilat kanë ndodhur jashtë Kosovës dhe
- (i) Ka të bëjë me një **subjekt apo një njësi biznesi të spupozuar** që në kohën kur vendimi për likuidim ka hyrë në fuqi, është menaxhuar **ndaras nga veprimtaria** NSH-ja në Kosovë.
- (ii) AL-ja ka përcaktuar që nuk është i mundur zbatimi i marrjes nën kontroll në emër të NSH-së i pronën ose asetet të **atij subjekti. Të gjitha** transaksionet e tilla të mbyllura në emrin e NSH-së përfshijn transaksione qëllimi i afarist është kufizuar me subjektin e pavarur ose njësinë e biznesit.

Kur kërkesat janë të paligjshme ose të falisifikuara, Agjencisë ka kompetencë të shqiptojë sanksione administrative. Agjencia gjithashtu mund t'i imponoj sanksione administrative AL-së apo çdo personi të tretë i angazhuar nga AL-ja për shpërdorim të kërkesave dhe fshehje të aseteve.

#### 9.3.4.4 Kërkesat Kreditorë të Papranueshme

**Papranueshmëria e kërkesës kreditorë mund të klasifikohet si papranueshmëri e plotë dhe papranueshmëri e pjesërishtme.**

9.3.4.4.1. Kërkesat kreditorë plotësisht të papranueshme janë ato kërkesa për të cilat konsiderohet se edhe pas dërgimit dhe paraqitjes së kërkesës kreditorit për informata shtese nuk mund të trajtohet fare në procedurë të likuidimit siç janë:

- i) kërkesat e paraqitura kundër një ndërmarrjeje shoqërore e cila nuk është në likuidim.
- ii) kërkesat e paraqitura kundër një ndërmarrjeje shoqërore në likuidim kur afati i përgjithshëm objektiv prej 75 ditëve prej ka skaduar (shih nenin 7.2.2.6.2 dhe nenin 35.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së prej datës së publikimit të Njoftimit për Likuidim.

- iii) Kërkesat paraqitura përmes postës elektronike.
- iv) Kërkesat e paraqitura në të cilat mungojnë të dhënat mbi kontakt adresën e paraqitësit të kërkesës si dhe mungojnë dokumentet mbështetëse prej të cilave mund të kuptohet kontakt adresa e paraqitësit të kërkesës.
- v) Kërkesat e paraqitura në të cilat mungon emri i ndërmarrjes shoqërore ndaj të cilës është paraqitur kërkesa si dhe mungon kontakt adresa si dhe mungojnë dokumentet mbështetëse prej të cilave mund të kuptohet identiteti i ndërmarrjes shoqërore.
- vi) Kërkesat e paraqitura të cilat nuk ndërlidhen fare me procesin e likuidimit (p.sh listat e punëtorëve; ankesat lidhur me procesin e shitjes, ankesat kundër vendimeve të Bordit lidhur me procesin e shitjes).

Lidhur me kërkesat e kategorizuara si plotësisht të papranueshme trajtohen nga ana e Departamentit për Koordinim të Likuidimit duke përfshirë të gjitha punët dhe veprimet administrative (regjistrimi dhe arkivimi) të evidentohen ndaras prej kërkesave tjera në procedurë të likuidimit).

**9.3.4.4.2. Kërkesat kreditore pjesërisht të papranueshme paraqesin ato kërkesa për të cilat konsiderohet se posedojnë disa elemente për trajtim në procedurë të likuidimit por nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara me nenin 23 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Në këto raste procedura do të zhvillohet si në vijim:**

- i) Pas pranimit të kërkesës kreditore dhe ndërmarrjes së veprimeve administrative, Departamenti për Koordinim të Likuidimit ia dorëzon kërkesën Autoritetit përkatës të Likuidimit
- ii) Autoriteti i Likuidimit në bazë të nenit 23.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së kërkon nga personi që ka parashtruar kërkesë kreditore informata apo dokumente shtesë të cilat Autoriteti i Likuidimit i konsideron si të domosdoshme apo të përshtatshme për shqyrtimin e kërkesës. Lidhur me kërkesën e Autoritetit të Likuidimit për informata dhe dokumente shtesë zbatohen nenin 7.7.7 i Politikave Operacionale të AKP-së.
- iii) Në rast se personi i kontaktuar nuk i përgjigjet kërkesave të Autoritetit të Likuidimit për informata apo dokumente shtesë apo nëse informatat dhe dokumentet shtesë nuk janë relevante për pranueshmërinë e kërkesës kreditore, Autoriteti i Likuidimit në procedurë të rregullt i dërgon personit Njoftimin me të cilin e njofton se kërkesa e personit refuzohet si e papranueshme.
- iv) Në rast se paraqitësi i kërkesës i përgjigjet pozitivisht kërkesës së Autoritetit të Likuidimit për informata dhe dokumente shtesë dhe nëse informatat dhe dokumentet shtesë konsiderohen se janë relevante, Autoriteti i Likuidimit e merr në shqyrtim kërkesën dhe vendos lidhur me bazën e kërkesës kreditore
- v) Në pajtim me nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej 30 ditëve pas pranimit të Njoftimit të paraqes kërkesë pranë Dhomës së Posaçme që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me pranueshmërinë e kërkesës së tij. Në pajtim me nenin 37.8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Dhoma e Posaçme duhet të merr vendim lidhur me kërkesën e kreditorit në afat prej 45 ditëve pas datës në të cilën kërkesa është dorëzuar në Dhomën e Posaçme dhe pasi që një kopje e saj t'i jetë dorëzuar Autoritetit të Likuidimit.

- vi) Lidhur me veprimet e ndërmarra procedurale sipas pikës (ii) dhe (iii) më lart, janë subjekt i veprimeve procedurale që mbulohen prej tarifës fikse nga kontrata me OSHP.

### 9.3.5 Ankesat kundër kërkesave të refuzuara

Gjatë punës së vet AL-ja mund t'i refuzoj **kërkesat** në tërësi apo pjesërisht, apo zvogëloj shumën e kërkesës së kreditorit për të cilën duhet ta njoftoj kreditorin. **Kreditori i pakënaqur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit mund të apeloj një vendim të tillë në DHPGJS brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit, në qoftë se kreditori dështon ta parashtrij ankesën e tij brenda afatit të duhur atij i pamundësohet kundërshtimi i vendimit të AL-së.**

### 9.4 Lista përfundimtare e kërkesave

*Kur vlerësimi i të gjitha kërkesave duke përfshirë përcaktimin e kundërshtimeve kundër vendimit të AL-së nga kreditori i prekur lidhur me refuzimin apo reduktimin e kërkesave në përputhje me **Shtojcën e Ligjit të AKP, Neni 37, AL –ja** përpilon Listën Përfundimtare të **Kërkesave**, duke përfshirë shumën e tyre dhe statusin në përputhje me kategoritë përfundimtare të vendosura në **Nenin 40, të Shtojca të Ligjit për AKP-në**.*

AL do të përpiloj dhe dorëzoj listën përfundimtare të kërkesave në faqen elektronike të AKP-së brenda 30 ditësh të plotësimit të kërkesave (**Shtojca** i Ligjit të AKP-së Neni 39.1 dhe 39.2). AL-ja do të përdorë formën standarde të aprovuar nga AKP-ja. AL-ja së paku do të siguroj informacionet në vijim:

- (i) Emrin e NSH;
- (ii) Shumën e mjeteve të marra nga shitja e aseteve
- (iii) Kërkesat e parashtruara;
- (iv) Kërkesat e vërtetuara dhe të ndara në kategori;
- (v) Propozimi për shpërndarje e të ardhurave të marra; dhe
- (vi) Bilanci i mbetur për tu shpërndarë nëse ka.

**10 PUNA ME KËRKESAT PRONËSORE****10.1 Përcaktimi i kërkesave pronësore**

Nëse ndërmarrja ka qenë subjekt i Transformimit sipas Nenit 5.4 të ligjit të AKP-së, Transformimi i tillë nuk do të ndikoj në drejtat dhe kompetencat e Agjencisë nën Nenet 6 (**Fushveprimi i kompetencave administrative të Agjencisë**), 8 (**Themelimi i korporatave; shitja e aksioneve**) apo 9 (**Likuidimi i kryer nga Agjencia**) të Ligjit. Megjithatë, me shqyrtimin e plotë, Agjencia mund të pranoj tërësisht apo pjesërisht vlefshmërinë e Transformimit të tillë.

Kur të vendos për kërkesat e transformimit, AL-ja duhet të merr parasysh kriteret e vendosura në Nenin 5.6 të Ligjit të AKP-së dhe të ndonjë vendimi të Dhomës së Posaçme apo të ndonjë Gjykate tjetër kompetente.

Kërkesat mbi pronësinë paraqiten në disa forma

- i) Pronësia e asetit të veçantë në posedim të NSH-së
- ii) Pronësia e ndërmarrjes që pretendohet të ketë pësuar transformim nga NSH në Shoqëri Aksionare.

Kërkesat për pronësi që bien nën ii) më sipër do të trajtohen në përputhje me kriteret e dhëna në Shtojcën IV të këtij Udhëzuesi të Likuidimit.

## 11 ANKESAT

### 11.1 Ankesat kundër vendimeve të AL-së

Të gjitha vendimet e Autoritetit të Likuidimit pala e pakënaqur mund ti apeloj në DHPGJS të Kosovës<sup>87</sup>.

Nëse Autoriteti i Likuidimit refuzon tërësisht apo pjesërisht, ose zvogëlon vlerën e kërkesës së parashtruar, ajo duhet të njoftoj me shkrim kreditorin e prekur, duke i dhënë sqarim për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës<sup>88</sup>.

Kreditori i prekur ka të drejtë që të aplikoj në Dhomën e Posaçme në afatin prej 30 ditësh prej datës së njoftimit me vendimin e Autoritetit të Likuidimit për përcaktimin e kërkesës së tij dhe në rast të dështimit të parashtrimit në kohë, kreditori nuk do të ketë mundësi të kundërshtoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Gjykata do të sjell vendim për kërkesën e parashtruar nga kreditori i prekur jo më vonë se 45 ditë pas datës së parashtrimit të kërkesës në Gjykatë dhe një kopje i sigurohet Autoritetit të Likuidimit, Komisionit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve tjera sipas udhëzimit të Gjykatës.

### 11.2 Paditë kundër AKP-së

DHPGJS-ja do të ketë juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë.

DHPGJS-ja nuk do të pranojë asnjë padi kundër AKP-së përveç nëse paditësi paraqet prova se ka informuar Kryetarin e Bordit për qëllimin e tij për të paraqitur padinë së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para dorëzimit të padisë. DHPGJS-ja, me kërkesë të Agjencisë, mund të pezullojë hapjen e procedurës për një padi kundër AKP-së për një periudhë që nuk i kalon gjashtëdhjetë (60) ditë nga marrja e padisë për të mundësuar një marrëveshje miqësore (Ligji për AKP-në Neni 30.2).

---

<sup>87</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 37.7

<sup>88</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 37.6

## 2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së

### 12 SANKSIONET NË DISPOZICION TË AGJENCISË

#### 12.1 Obligimi për të bashkëpunuar me AL-në

NSH-ja, menaxhmenti, dhe punëtorët e NSH-së, përfshirë këtu edhe ish punëtorët, dhe të gjithë personat tjerë relevant, si dhe të gjitha autoritetet publike, do të bashkëpunojnë me AL-në dhe do të ofrojnë qasje në të gjitha dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me veprimtaritë dhe operacionet e NSH-së dhe Aseteve të saja, përfshirë, por pa u kufizuar me, të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me ankesat, shpagimet, transferimet apo tjetërsimet e pronës dhe Aseteve të NSH-së dhe të gjitha pagesat, transferimet apo veprimtaritë që kanë të bëjnë me NSH-në<sup>91</sup>.

#### 12.1.1 Ndhimja nga Qeveria e Kosovës

AKP-ja mund të kërkojë asistencë nga policia dhe agjencitë tjera për zbatimin e ligjit të Qeverisë së Kosovës për të ushtruar autoritetin e vet sipas ligjit të AKP-së<sup>92</sup>.

#### 12.1.2 Autoriteti për të shqiptuar gjoba

Për të zbatuar autoritetin e vet sipas Ligjit të AKP-së, AKP-ja mund t'u shqiptojë gjoba NSH-ve, punëtorëve dhe personave tjerë me funksione menaxheriale apo kontrolli në lidhje me NSH-të si në vijim:

- i) Mos përgjigjja brenda pesë ditësh pune nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga një përfaqësues i autorizuar i Agjencisë për informata ose dokumentacionin që është në posedim të të adresuarit - deri në një njëmijë Euro (1000 €) në ditë për çdo ditë të mos përgjigjes deri në një maksimum prej njëqind mijë Eurosh (100,000 €);
- ii) Dhënia me qëllim të informatave të rrejshme një përfaqësuesi të autorizuar të Agjencisë – deri në njëqind mijë Euro (100,000€);
- iii) Shkatërrim, falsifikim, fabrikim ose fshehjen e të dhënave mbi ndërmarrjen – deri në njëqind mijë Euro (100,000 €);
- iv) Fshehjen e qëllimshme ose transferimin e paligjshëm të asetëve të ndërmarrjes – deri në pesëdhjetë mijë Euro (€ 50,000) ose një shumë sa tri herë vlera e asetit në fjalë, cila do që është më e lartë; dhe
- v) **Mosdorëzimin në Agjenci të çfarëdo asemi të ndërmarrjes pas marrjes së një urdhri me shkrim nga Bordi - deri në pesëdhjetë mijë (50.000) Euro ose shumën e barabartë me tri herë vlerën e asetëve të pa dorëzuara, cilado që është më e lartë.**

Çfarëdo urdhri për të shqiptuar gjoba do të nënshkruhet nga Drejtori Menaxhues ose Zëvendës Drejtori Menaxhues dhe do t'i dorëzohet ndërmarrjes apo personit në fjalë. Urdhri duhet të hyjë në fuqi menjëherë me rastin e lëshimit të tij. Ndërmarrja apo personi në fjalë do t'i ketë tridhjetë (30) ditë pas marrjes së një urdhri të tillë që ta kundërshtoj këtë urdhër pranë Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme do ta trajtojë një kundërshtim të tillë me urgjencë dhe mund – deri sa të zgjidhet çështja – ta pezullojë urdhrin dhe të shqiptojë ndonjë masë të përkohshme lehtësuese që Dhoma e Posaçme e konsideron të nevojshme apo të duhur gjatë periudhës së çështjes gjyqësore.

Çdo drejtor i NSH-së dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës që ka lidhje me ndërmarrjen është përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar NSH-së si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë. AKP-ja në emër të ndërmarrjes në fjalë ka autorizim të kërkojë pagimin e dëmit të tillë në Gjykatën kompetente.

<sup>91</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 22

<sup>92</sup> Ligji i AKP-së, Neni 26



## *2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së*

---

### **12.1.3 Kundërvajtjet e kreditorëve, të menaxhmentit dhe të zyrtarëve të NSH-së**

Çdo Person që me qëllim jep deklarata materialisht të rrejshme apo mashtruese, me gojë apo me shkrim, përkitazi me procedurat e likuidimit, apo që me qëllim dorëzon materialisht një dokument të rrejshëm apo mashtrues, apo që me qëllim ndihmon apo nxit një person tjetër të kryej akt të tillë ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë Euro (100,000€) për secilin rast.

Çdo Person që me qëllim parashtron kërkesë të rrejshme apo dokumente të rrejshme gjatë procedurës së Likuidimit ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë Euro (100,000€) për secilin rast.

Çdo Person që me qëllim transferon, fsheh apo nuk e kthen dokumentin, pronën apo Asetin e NSH-së tek AL-ja, një person i cili vepron në kapacitet të apo si përfaqësues i një AL-je, apo tek Gjykata për t'iu shmangur proceseve apo procedurave të Ligjit të AKP-së ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë Euro (100,000€) për secilin rast.

Në të gjitha rastet si më sipër në rast të personit fizik personi i tillë mundë t'i nënshtrohet edhe procedurave penale në pajtim me Kodin Penal.

### **12.1.4 Kundërvajtjet nga anëtarët e AL-së apo tjerëve cilët punojnë në likuidim**

Çdo person që vepron në cilësi të një anëtari të AL-së, apo që angazhohet për të punuar në mbikëqyrje të AL-së, Agjencisë apo Ndërmarrjes, apo që Ndërmarrja me qëllim bën përvetësim të paligjshëm, shkatërron, dëmton, vjedh, në mënyrë direkte apo indirekte, dokumente, prona apo pasuri të Ndërmarrjes, do të mbahet përgjegjës për shumën e mjetit në fjalë si dhe ndëshkohet me gjobë administrative jo më të lartë se njëqindmijë Euro (100,000€) për secilin rast. Në rast të personit fizik, ai person mund t'i nënshtrohet edhe procedurave penale në pajtim me Kodin Penal<sup>93</sup>.

---

<sup>93</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 52.1

**13 SHPËRNDARJET**

Para se të merret parasysh rekomandimi për shpërndarjen e të ardhurave nga realizimi i aseteve, së pari duhet konsideruar një numër të madh çështjesh, si për shembull Fondet e Rezervuara.

**13.1 Fondet rezervë**

Me aprovim të Bordit, fondet likuide, paratë apo pasuritë tjera mund të ndahen nga Autoriteti i Likuidimit në llogari të ndarë për ruajtje (escrow) të mbajtur nga agjenti i llogarisë së tillë i emëruar nga Bordi për përmbushje. Për më tepër kjo çështje është e rregulluar me Nenin 42.1. - 42.5. të Shtojcës të ligjit të AKP-së.

**13.2 Kalkulimi i fondit të mbetur dhe shpërndarja**

Agjencia është e obliguar që të kalkulojë “Fondin e Mbetur” (nëse ka) për secilin likuidim të nisur nga Agjencia apo paraardhësi i saj sipas paragrafit 2.2 të Nenit 6 (dispozitat e privatizimit) dhe Nenit 9 (dispozitat e likuidimit) të Ligjit të AKP-së, apo sipas dispozitave analoge të legjislacionit paraprak deri në ligjin aktual<sup>94</sup>.

Fondi i Mbetur kalkulohet duke i llogaritur të ardhurat e privatizimit dhe likuidimit përfshirë çfarëdo të ardhurash tjera anësore si qiraja ose ndonjë gjenerim tjetër pastaj duke e zbritur:

- i) 20% për punëtorët e kualifikuar;
- ii) Pagesa 5% për Agjencinë;
- iii) Vlerën maksimale të **kërkesave** dhe interesave të pronësisë së kërkuar dhe;
- iv) Shpenzimet e paraparë e likuidimit.

Pasi të jenë kryer përlllogaritjet e paraqitura më lartë, 25% zbriten nga Fondi i Mbetur si mbrojtje ndaj ndonjë gabimi. Kalkulimi është ilustruar si në vijim:

---

<sup>94</sup> Ligji i AKP-së Neni 19.3

<b>Kalkulimi i mbetjeve të fondit të likuidimit</b>		
	€	€
<b>Realizimi i Aseteve</b>		
Të ardhurat në privatizim		85
Shitja e asetëve përmes likuidimit		10
Fatura të ndryshme		<u>5</u>
<b>Alokimi i mjeteve për punëtorët dhe AKP-në</b>		
20% për punëtorët	(20)	
5% për pagesë për AKP-në	(5)	
		<u>(25)</u>
<b>Fondi në dispozicion për likuidim</b>		75
<b><u>Kërkesat</u></b>		
Kreditorët e pasiguruar	(25)	
<u>Kërkesat për pronësi</u>	(5)	
		<u>(30)</u>
<b>Fondi rezervë</b>		12
<b>Mbajtja e fondit rezervë (25%)</b>		(3)
		<u>9</u>
<b>Rezervat për shpërndarje në Buxhet</b>		<b>9</b>

Nëse fondi i mbetur është i dukshëm nga përlogaritjet e mësipërme, Agjencia përcakton dhe deklaron si “fonde të mbetura” deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%)<sup>95</sup> dhe menjëherë i transferon ato fonde të mbetura në Qeverinë e Kosovës, të cilat pastaj bëhen “para publike” dhe trajtohen në pajtim me LMFPP<sup>96</sup>.

Në praktikë, kalkulimet e sipërsëhuara mund të kryhen vetëm pas datës për parashtrimin e ankesave. Për më tepër kalkulimet në rastet e kështilla trajtohen dhe janë të përcaktuara me Ligjin e AKP-së Neni 19.

<sup>95</sup> Formulimi ‘deri në 75%’ duhet të shpjegohet. Gjatë procesit të përpilimit të Ligjit të AKP-së, përpiluesi ligjor pa qëllim ka hequr koston e paraparë të likuidimit nga Kalkulimet e Fondit të Mbetur. Për të mundësuar këtë janë futur fjalët ‘deri në 75%’ ashtu që Agjencia të mundë të sigurojë kostot e likuidimit duke reduktuar shumën e Fondeve të Mbetura deri nën maksimumin prej 75% të paraparë me nenin 19.3. Me qëllim të kalkulimit të Fondit të Mbetur, Agjencia apo AL-ja do të bëjë kalkulimin siç është përshkruar në këtë Udhëzues për Likuidim dhe kështu të përcaktojë përqindjen që do të transferohet tek Qeveria e Kosovës.

<sup>96</sup> Ligji i AKP-së, Neni 19.3.3

### 13.3 Kthimi i fondit

Në rast se shumta e mbetur në një fond të mirëbesimit nga i cili fondet e mbetura janë transferuar në Qeveri sipas Ligjit të AKP-së nenit 19 nënparagrafit 3.3 është **i pamjaftueshëm** për përmbushjen e të gjitha kërkesave të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme, AKP-ja e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria menjëherë do ti kthejë fondet përkatëse në fondin e mirëbesimit nga i cili janë transferuar<sup>97</sup>.

### 13.4 Shpërndarjet e parakohshme

Secila **kërkesë** e parashtruar kundër një NSH-je të veçantë paguhet vetëm nga fondet e gjeneruara nga likuidimi i asetëve të NSH-së. Paguesa fillon me rastin e miratimit nga Bordi<sup>98</sup>.

Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund **të kërkoj nga Bordi shpërndarje të parakohshme**<sup>99</sup>.

Si rregull, nuk duhet të bëhet asnjë shpërndarje deri sa Raporti i Rezultatit të Parashikuar të tregoj se është e sigurt të veprohet në një mënyrë të tillë. Shpërndarjet e parakohshme sipas Raportit të azhurnuar të Rezultatit të Parashikuar, nëse burimet e rasteve të likuidimit janë të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht të gjitha kategoritë e kërkesave.

### 13.5 Trajtimi i kërkesave dhe interesi

Para se të vazhdohet që t'i rekomandohet Bordit shpërndarja për trajtimin e kërkesave dhe interesave, AL-ja përgatit një Raport të Rezultatit të Parashikuar së bashku me shënimet sqaruese se si janë kalkuluar shpërndarjet dhe ku shpjegohen të gjitha rezervat dhe provizionet.

Kërkesat dhe interesat trajtohen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë dhe radhës të përcaktuar me Ligjin e AKP-së **Shtojca**, neni 40<sup>100</sup>.

Trajtimi e kërkesave dhe interesave që i përkasin një kategorie pasuese të prioritetit më të ulët mund të iniciohen vetëm pas përmbushjes së plotë dhe të tërësishme të kërkesave të kategorisë së mëhershme të prioritetit më të lartë.

Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të trajtuar tërësisht të gjitha kërkesat apo interesat e një kategorie apo renditje të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Kërkesat e asaj kategorie apo renditje trajtohen në proporcion me shumën e çdo kërkesë, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime<sup>101</sup>.

### 13.6 Shpërndarja përfundimtare

Me rastin e vendimit përfundimtar nga ana e DHPGjS-së në lidhje **me ankesat** e Kreditorëve të paraqitura në procedurën e Likuidimit, AL-ja përgatit Raportin e Rezultatit të Parashikuar në lidhje me fondet e mbetura dhe shpërndarjen e parakohshme si dhe shpenzimet e papaguara të AL-së deri në atë moment.

Të gjitha pagesat për trajtimin e kërkesave do t'u nënshtrohen procedurave të vendosura nga Agjencia në pajtueshmëri me Politikën Financiare të AKP-së të lëshuara sipas Nenit 19 të Ligjit për AKP-në.

<sup>97</sup> Ligji i AKP-së Neni 19.3.4

<sup>98</sup> **Ligji i AKP-se Neni 41.**

<sup>99</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 41.3

<sup>100</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 41.1

<sup>101</sup> Ligji i AKP-së, Shtojca, Neni 41.4

*2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së*

---

Në rast se mbesin të ardhura nga likuidimi i një NSh-je pasi të jenë zgjidhur të gjitha kërkesat/ankesat e kreditorëve, këto të ardhura transferohen në Qeverinë e Kosovës si surplus<sup>102</sup>

---

<sup>102</sup> Ligji i AKP-se neni 2.2.5

## 14 MBYLLJA E RASTIT

**Politikat Operacionale të AKP-së neni 7.14 parasheh:** Autoriteti i Likuidimit, brenda 30 ditësh nga dita e shpërndarjes Përfundimtare apo pasi të jenë shpërndarë të gjitha fondet e realizuara, kërkon nga Bordi që të miratojë Raportin Përfundimtar.

Autoriteti i Likuidimit, brenda 30 ditësh nga dita e shpërndarjes. Përfundimtare apo pasi të jenë shpërndarë të gjitha fondet e realizuara, kërkon nga Bordi që të miratojë Raportin Përfundimtar që do të parashtrohet në Gjykatë sipas **Shtojcës së Ligjit të AKP-së, neni 43.**

### 14.1 Raporti përfundimtar

Brenda 30 ditëve pas shpërndarjes përfundimtare ose menjëherë kur të gjitha fondet janë realizuar dhe shpërndarë, AL përgatit raport për Bord me të cilin kërkon aprovimin e raporti final i cili do të dorëzohet në DHPGJS në pajtim me nenin 43 **Shtojca** e Ligjit për AKP-në.

**Raporti përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit duhet të përmbaj të gjitha të dhënat konform nenit 43.2 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë dhe nenit 7.14.2 të Politikave Operacionale të AKP-së<sup>101</sup>** (shiko Politikat Operacionale të AKP-së, Paragrafi 7.14 për përmbajtjen e plotë të listës):

- i) Një listë e të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera;
- ii) Një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;
- iii) Një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara, duke shënuar në mënyrë të qartë shumat e shpërndara apo pronën e transferuar për përmbushjen e tërësishme apo pjeshme të secilës;
- iv) Një listë të bilancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit.

### 14.2 Kërkesat në DHPGJS

Me qëllim të miratimit nga ana e Bordit të AKP-së, AL përgatit një raport përfundimtar i cili paraqet hollësisht të gjitha çështjet relevante që kanë ndodhur që nga marrja e vendimit nga Agjencia për të filluar procedurën e likuidimit për NSH-në<sup>102</sup>.

DHPGJS pas pranimit të raportit përfundimtar dhe parashtrimit të kërkesës për përmblyllje, brenda **pesëmbëdhjetë** (15) ditësh<sup>103</sup> nxjerr një urdhër të shkruar për mbylljen e procesit të likuidimit nëse është përmbushur ashtu që e gjithë prona dhe asetet e NSH-së janë likuiduar në atë masë që është arsyeshëm e praktikueshme dhe të gjitha fondet e realizuara të jenë paguar apo janë paguar në mënyrë substanciale. Nëse DHPGJS e kundërshton Raportin Final atëherë AL përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë brenda 30 ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga DHPGJS-ja<sup>104</sup>.

DHPGJS-ja shënon në çdo urdhër dispozitën për përmblylljen e procedurës së Likuidimit për lirim e AL ndaj ndonjë obligimi të mëtutjeshëm në lidhje me NSH-në dhe me procedurat e likuidimit.

Duhet të theksohet se Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit mund të kundërshtojë Raportin Përfundimtar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të dorëzimit. Nëse dërgohet njoftimi për kundërshtim, Autoriteti i Likuidimit përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë

<sup>101</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.2 dhe Politikat Operacionale të AKP-së, Neni 7.14.2

<sup>102</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.2

<sup>103</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.4

<sup>104</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.3

## 2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së

në Gjykatë brenda tridhjetë (30) ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga Gjykata<sup>105</sup>.

### 14.3 Mbyllja e rastit të ekspedituar

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e Kërkesave prioritare të përcaktuara në Ligjin e AKP-së **Shtojca**, neni 40, paragrafi (1), nënparagrafi 1), Gjykata nxjerr vendim për lejimin për mbylljen e rastit të likuidimit<sup>106</sup>.

**Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, nëse asnjë kreditor nuk ka parashtruar kërkesë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, Gjykata nxjerr vendim për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit**<sup>107</sup>.

Nëse NSH-ja në likuidim nuk ka asete të realizueshme, AL kërkon miratimin e Bordit për të parashtruar kërkesën në Gjykatë për aprovimin e mbylljes së rastit<sup>108</sup>.

### 14.4 Njoftimi për mbylljen e rasteve

Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës te kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit. Njoftimi përmban ose vetë Raportin Përfundimtar, ose një përmbledhje të raportit me kusht që raporti i plotë të jetë në dispozicion për inspektim për palët e interesuara dhe se kopja e raportit të jetë dërguar te kreditorët që e kanë kërkuar atë. Raporti përfundimtar postohet në faqen e internetit të AKP-së<sup>109</sup>.

Agjencia lidhur me aprovimin e Raportit Përfundimtar nga Gjykata i njofton me shkrim komunitat dhe institucionet dhe autoritetet publike (Regjistrin e Bizneseve Kosovare, Regjistri i Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrare të Kosovës, bankën(at) e Ndërmarrjes dhe Administratën Tatimore) të Kosovës<sup>110</sup>.

Njoftimet në shtyp (shpalljet publike) publikohen në faqen e internetit të AKP-së në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, sipas dispozitave për shpallje që parashihen me Ligjin e AKP-së **Shtojca**, neni 49 me shënimin që të bëhet një raport i plotë për inspektim nga palët e interesuara. Ky njoftim duhet të paraqesë më së paku:

- (a) Emrin e NSH-së;
- (b) Datën e fillimi të Likuidimit; dhe
- (c) Datën e urdhrin të DHPGJS-së për mbylljen e Likuidimit për NSH-në.

### 14.5 Pasojat e mbylljes së rastit

Mbyllja e likuidimit të NSH-së ndodh në datë kur Gjykata<sup>111</sup> aprovon raportin përfundimtar të AL dhe si pasojë:

- i) Nuk mundë të zbatohen kërkesa kreditore apo të pronësisë kundër AKP-së apo asetëve që kanë qenë të NSH-së<sup>112</sup>.

<sup>105</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.4

<sup>106</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 44.2

<sup>107</sup> Ligji i AKP-së Shtojca Neni 44.3

<sup>108</sup> Politikat Operacionale të AKP-së Neni 7.14.3. c)

<sup>109</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 43.3

<sup>110</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 45

<sup>111</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 44.1

<sup>112</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 47

*2011 Udhëzuesi i Likuidimit i AKP-së*

---

- ii) Anëtarët e Autoritetit të Likuidimit lirohen nga detyrat apo përgjegjësitë tjera në lidhje me ndërmarrjen dhe procedurat e likuidimit<sup>113</sup>;
- iii) Gjykata miraton pagesat përfundimtare të ndonjë shpenzimi të papaguar të Autoritetit të Likuidimit<sup>114</sup>;
- iv) Pas shpërndarjes përfundimtare borxhet e mbetura dhe të papaguara të NSH-së shuhen me ligj dhe çdo veprim për të inkasuar borxhe të tilla të shuara ndalohen, përveç nëse Gjykata e urdhëron atë para mbylljes apo në urdhrin për mbylljen e rastit të likuidimit<sup>115</sup>.

Pas mbylljes së rastit të likuidimit, NSH-ja ndërpret së ekzistuari.

Aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në Prishtinë më 29 Shtator 2011

Dino Asanaj

---

Kryesues

Bordit të Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit

---

<sup>113</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 46.1.1

<sup>114</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 46.1.2

<sup>115</sup> Ligji i AKP-së Shtojca, Neni 47



**Shtojca - Përmbajtja e Arkivit standard të likuidimit**

**Korrespondencat e përgjithshme**

- Hyrëse
- Dalëse

**Procesverbali i takimeve të AL-së me palët e interesuara**

**Historiku i NSH-së dhe transaksioni/et e privatizimit KPS**

- AP/IM/CLOR
- Shitja/ Marrëveshja e blerjes
- Dokumente tjera rreth historikut

**Fillimi i likuidimit**

- Dokumentet informuese për Bordin dhe vendimet e Bordit
- Emërimet e AL-së
- Letra për tepricë
- Master kopja e Ditarit të Likuidimit

**Lajmërimet dhe Shpalljet**

- Njoftim për Gjykata
- Njoftim për kreditorët
- Njoftim për regjistrin e biznesit, Njoftim për bankat
- Shpalljet në gazeta

**Xhirollogaritë bankare**

- Kërkesë për të hapur xhirollogari bankare
- Korrespondenca e bankës/urdhrrat për transfer. Pasqyrat bankare
- Fletushka këshilluese

**Financat e AL**

- Raportet financiare
- Faturat e shitjes
- Faturat e blerjes
- Dokumentet e prokurimit

**Marrëveshjet e AL**

- Marrëveshjet për ofruesit e shërbimeve
- Marrëveshjet e qirasë
- Marrëveshjet tjera

**Regjistrimi i aseteve dhe lista e detyrimeve**

**Indeksi arkivues i NSH. (Lista e arkivës në NSH)**

- Gjendja e bilancit në datën e fillimit të Likuidimit
- Listat e Aseteve të mbetura
- Detyrimet
- Tabela përfundimtare e aseteve dhe detyrimeve
- Shitja e aseteve

**Shitja 1**

- Dokumentacioni i shitjes
- Shpalljet
- Regjistrimi i ofertueseve

- Kontrata e shitjes/vendimi i bordit

**Shitja 2**

- Dokumentacioni i shitjes
- Shpalljet
- Regjistrimi i ofertueseve
- Etj.

**Vendimet për kërkesat dhe ankesat**

- Kërkesa për informata shtesë (letra)
- Kërkesat e vlefshme (letra)
- Kërkesat e refuzuara (letra)
- Ankesat për vendimet mbi kërkesat
- Vendimet e panelit për ankesa
- Vendimi përfundimtar për kërkesat
- Ankesat në DHPGJS
- Vendimet e DHPGJS për ankesat

**Shpërndarjet**

- Shpërndarjet e parakohshme
- Lista përfundimtare e shpërndarjes
- Korrespondenca me Financat e AKP-së
- Dokumentet për Informim të Bordit dhe vendimet e Bordit

**Ligjore**

- Kërkesa për veprim
- Opinioni ligjor
- Rastet e gjykatës
- Të tjera

**Shtojca I- Lista e Formave të Likuidimit**

**Shtojca II - Udhëzues për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës në Likuidim**

**Shtojca III - Procedimi i Kërkesave Kolektive në Procedurën e Likuidimit**

**Shtojca IV- Udhëzues për shqyrtimin e Pretendimeve Pronësore nga Transformimet**

**ADRESAT KONTAKTUESE TË AKP-SË**

AKP-ja punëson rreth 240 persona staf profesional në pesë zyra, puna e të cilëve është të përshpejtojnë Privatizimin dhe Likuidimin & Përmbylljen në Kosovë, dhe pastaj të bëjë shpërndarjen e të ardhurave tek kreditorët, pronarët dhe punëtorët.

Stafi i AKP-së mund të kontaktohet në adresat e mëposhtme:

**Zyra qendrore e AKP-së**

Ilir Konushevcu Nr 8  
Prishtinë  
Kosovë

**Zyra regjionale e Prishtinës**

Rr. Rexhep Mala Nr. 2,  
Prishtinë  
Kosovë

**Zyra regjionale e Pejës**

Rr. Vëllezërit Gërvalla,  
Ndërtesa e Onix-it, kati 1,  
Pejë  
Kosovë

**Zyra regjionale e Mitrovicës**

Rr: Mbretëresha Teutë,  
Mitrovicë  
Kosovë

**Zyra regjionale e Gjilanit**

Rr. Bujanovcit  
Gjilan  
Kosovë

**Zyra regjionale e Prizrenit**

Rr: Pushkatarëve Nr: 9  
Prizren  
Kosovë

**Ueb Faqja:**

**[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)**



Prishtinë, më 28 Shtator 2011

## Shtojca 2

### UDHËZUES

#### Për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës në Likuidim

##### **1. Të përgjithshme**

Ligji i AKP-së parasheh që me fillimin e likuidimit, të gjitha kompetencat e menaxhmentit dhe organeve mbikëqyrëse të NSH-ve do t'i barten komisionit të likuidimit. Prandaj, të gjitha kërkesat e punëtorëve lidhur me apo nga marrëdhënia e punës pas fillimit të likuidimit do t'i drejtohen komisionit të likuidimit.

Punëtorët e ndonjë NSH-je mund të kenë kërkesa nga marrëdhënia e punës në momentin kur AKP vendos për fillimin e procesit të likuidimit. Ligjet në Kosovë ofrojnë bazën ligjore për përfshirjen e punëtorëve në procedurën e likuidimit të NSH-së të udhëhequr nga AKP.

Prioriteti i likuidimit për kërkesat për pagat e papaguara të punëtorëve dhe kompensimin për ndërprerje të parakohshme të punës, është një pikë e rëndësishme referimi. Në skenarin e likuidimit, kjo do të thotë që secili punëtorë me kërkesë në këtë kategori do të jetë më afër për shpërndarjen e shumës me prioritet. Kërkesat që nuk kanë prioritet do të shpërndahen proporcionalisht në mes kreditorëve të pasiguruar duke përfshirë punëtorët.

Ky parim gjithashtu mbështetet nga legjisllacioni i Kosovës. Ligji i AKP-së parashikon përfshirjen e punëtorëve për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës [Neni 5.7.b.(i)] që jep prioritetin bazuar në Nenin 44. 1(f) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48. E njëjta vlen edhe për pagat e papaguara. Kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës dhe pagat e papaguara paraqesin kërkesa me prioritet.

Ky dokument është lidhur me kërkesat që kanë të bëjnë me kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pagat e papaguara për punëtorët e NSH-ve. Çështjet tjera nga apo lidhur me marrëdhëniet e punës nuk janë trajtuar në këtë dokument.

Ky dokument do të shërbejë si udhëzues për trajtimin e kërkesave për pagat e papaguara dhe kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës. Ky dokument nuk ka për qëllim adresimin e të gjitha problemeve të mundshme lidhur me ato kërkesa. Pasi që rastet do të dallojnë njëri prej tjetrit, për secilën kërkesë do të vendoset sipas diskrecionit të plotë të komisionit të likuidimit pas shqyrtimit të të gjitha fakteve të secilit rast dhe vlerësimit ligjor të të gjitha fakteve.

##### **2. Kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës**



Pas fillimit të privatizimit apo likuidimit, marrëdhënia e punës me punëtorët zakonisht ndërpritet për të gjithë punëtorët. Kjo trajtohet si ndërprerje kolektive në shumë vende. Qëllimi është t'i sigurohet punëtorëve një pagesë prej disa rrogave për shkak të humbjes së punës sipas bazës e cila nuk varej nga punëtori dhe për të siguruar pagesën e disa rrogave për një kohë derisa ata të mos gjejnë punë tjetër apo të marrin ndonjë ndihmë tjetër.

Baza ligjore për ndërprerje kolektive është e paraparë me ligjin e punës. Ligji i punës i siguron punëdhënësit të drejtën për ndërprerje kolektive të kontratave të punës për shkak ndryshimeve ekonomike, teknologjike apo strukturale në ndërmarrje. Në raste të tilla, Punëdhënësi mund të ndërpret kontratën e punës punëtorëve me njoftim paraprak për ndërprerje prej 3 muajve (në përputhje me Rregulloren Nr. 2001/27) dhe 1 – 2 muaj kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit. Kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës përllëgaritet në bazë të kohëzgjatjes së marrëdhënies të punës. Pasi që ligji i AKP-së parasheh kufizimet në aplikimin e ligjit të punës për privatizim dhe likuidimin e NSH-ve, paradhënia e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës nuk është kusht për ndërprerjen e kontratës. Neni 6.3 i Ligjit të AKP-së parasheh që kriteret për llogaritjen e shumës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës sipas ligjit të punës, do të jetë e zbatueshme për përcaktimin e shumës për t'iu paguar punëtorit të NSH-së që është shpallur tepricë për shkak të privatizimit apo likuidimit.

Nuk ka ndonjë definicion për “tepricë”, mirëpo interpretimi i përgjithshëm ndërkombëtarë është largimi nga puna pasi që nuk është më i/e nevojitur. Në privatizim, transferi dhe shitja e aseteve të Ndër së Re në mënyrën e drejtpërdrejtë të privatizimit me spin-off është ndryshimi në organizimin e NSH-së që rezulton në më pak punëtorë të nevojshëm. E njëjta zbatohet edhe për procedurën e likuidimit të aseteve të një kompanie.

Veprimet më të zakonshme të AKP-së për të cilat kjo ndërlidhet, janë tepricat që vijnë pas privatizimit me spin-off apo fillimit të likuidimit. Ligji i AKP-së lejon kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës për të gjithë punëtorët që i nënshtrohen tepricës si pasojë e, apo në lidhje me, likuidimin apo privatizimin pavarësisht nga madhësia e tepricës.<sup>1</sup>

## **2.1. Kush ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës**

Sipas ligjit të AKP-së, kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës paraqet kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës për tepricë për shkak të privatizimit dhe likuidimit të NSH-së.

Kriteri për përcaktimin e drejtës për përfshirje për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës përbëhet prej katër komponentëve. Në ditën e fillimit të privatizimit apo likuidimit:

- i) Duhet të ekzistojë marrëdhënia e punës me punëtorin;
- ii) Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime për NSH-në;
- iii) Punëtori ka pasur marrëdhënie të varur me NSH-në;
- iv) Punëtori do të ketë marrëdhënie të përhershme të punës.

### **i) Duhet të ekzistojë marrëdhënia e punës me punëtorin**

---

<sup>1</sup> Neni 44.1 (f) i Rregullorja 2005/48 është plotësuar këtu për të përfshirë ankesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës.

Në ditën e fillimit të likuidimit, punëtori do të ketë marrëdhënie pune me NSH-në. Ekzistimi i marrëdhënies të punës mund të dëshmohet me kontratë të punës, vendim për punësimin, librezën e punës, listën e pagave dhe dokumente tjera të cilat sipas vendimit të komisionit të likuidimit dëshmojnë ekzistencën e marrëdhënies të punës.

#### ii) Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime për NSH-në

Ekzistenca e marrëdhënies të punës nuk do të jetë gjithmonë e mjaftueshme për përfshirje në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Ligji i punës parasheh definicionin për punëtorin. Punëtori do të jetë person fizik i punësuar për të kryer punë apo shërbime me pagesë për punëdhënësin. Prandaj, përpos kërkesës për ekzistencë të marrëdhënies së punës, punëtori duhet të ketë punuar në ndërmarrje dhe të jetë paguar për punën e tij/saj në momentin e fillimit të likuidimit apo privatizimit. Punëtori i cili në momentin e fillimit të likuidimit, për ndonjë arsye ligjore kishte formalisht marrëdhënie pune me kompaninë, mirëpo ai/ajo nuk ishte produktiv në kompani, nuk ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Këta persona nuk janë shpallur tepricë (shih definicionin më lart tek neni 2). Shumica e punëtorëve janë shpallur të tillë.

#### iii) Punëtori ka pasur marrëdhënie të varur me NSH-në

Është e rëndësishme të theksohet që vetëm personat e punësuar kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Ofruesit e shërbimeve, punëtorët sezonal të anëtarëve me honorar në bord (nëse nuk janë me orar të plotë në NSH) nuk kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës. Për përcaktimin e pozitës së punëtorit, është i rëndësishëm fakti që punëtori të ishte punëtorë i rregullt në NSH dhe ai/ajo ishte i/e ngarkuar me udhëzimet e punëtorit (ai/ajo nuk ishte punëtorë i/e pavarur apo profesionist i/e pavarur).

#### iv) Punëtori do të ketë marrëdhënie të përhershme të punës

Shprehja marrëdhënie e përhershme e punës do të thotë që punëtori nuk do të ketë kontratë të me afat të kufizuar (më pak se dy vite) dhe do të jetë punëtorë i përhershëm (jo i rastit apo sezonal). Ky kriter është gjithashtu i përfshirë me ligj. Ligji i punës (neni 76.7) parasheh që vetëm punëtorët me kontrata të pakufizuara kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës. Ligji më tutje parasheh që vetëm punëtorët që kanë punuar së paku 2 vite në kompani kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës. Prandaj, punëtorët të cilët kanë pasur kontrata me afat të kufizuar në më pak se dy vite apo ishin të punëtorë të përhershëm jo të rastit, nuk kanë të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës.

### **2.2. Si mund me lehtësi të identifikojë punëtorët me të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës**

Mjetet për identifikimin e personave me të drejtë në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës mund të jenë:

- i) Lista e pagave të NSH-së, dhe
- ii) Lista e menaxhmentit të punëtorëve;
- iii) Dokumenti nga Autoriteti Tatimor i Fondit Pensional që dëshmon që kontributet janë paguar nga Punëdhënësi për punëtorin;
- iv) Ndonjë dokument tjetër që sipas vendimit të komisionit të likuidimit paraqet dëshmi për ekzistencën e marrëdhënies të punës apo shërbimeve të ofruara nga punëtori për NSH-në.

Lista e menaxhmentit me punëtorë gjithashtu me dëshmi *prima facie* për ekzistencën e marrëdhënies së punës në ditën e fillimit të privatizimit apo likuidimit. Lista e pagave paraqet dëshmi *prima facie* për punëtorët të cilët kanë punuar dhe kanë pranuar pagesë para ditës së fillimit të privatizimit apo likuidimit. Zakonisht, NSH-të nuk i kanë paguar punëtorët për tre muajt e fundit në pritje të privatizimit të NSH-së. Prandaj, ky fakt duhet marr parasysh gjatë përcaktimit të kualifikueshmërisë.

### **2.3. Si t'i trajtojë kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës**

Janë katër çështje kryesore për t'u vlerësuar dhe zgjidhur gjatë vendimit për Pagesë për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës të Punës:

- i) Nëse kërkesa është e Pranueshme
- ii) Nëse kërkesa ka Bazë Ligjore
- iii) Përcaktimin e “rrogës mujore”
- iv) Përcaktimin e “viteve të shërbimit në NSH”

### **2.4. Vendimi për kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës**

Kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës do të aprovohet nëse kërkesa është e pranueshme dhe ka bazë ligjore.

#### **2.4.1. Pranueshmëria**

Para hyrjes në shqyrtimin e materialit të kërkesës, rekomandohet të kontrollohet nëse kërkesa i përmbush kërkesat minimale formale.

##### i) Afatet për dorëzimin e kërkesës dhe formulari

Kërkesa duhet të dorëzohet brenda afatit ligjor pas publikimit që NSH ka hyrë në likuidim. Çështja më problematike gjatë shqyrtimit të afateve për kërkesa të tilla është përcaktimi nëse kërkesa është parashtruar pas afatit. Në shumicën e rasteve, kërkesat janë dorëzuar në AKP dhe ankuesi nuk e ka ripërtëri kërkesën para komisionit të likuidimit. Një problem tjetër është që para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së në qershor 2008, Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës ka zbuluar që punëtorët nuk kanë të drejtë në kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës<sup>2</sup>. Prandaj, shumica e punëtorëve duke u bazuar në këtë vendim nuk kanë parashtruar kërkesë për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës të Punës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të AKP-së, kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës është bërë kërkesë me prioritet.

##### ii) Kërkesat për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para muajit qershor 2008

Nëse një punëtorë ka parashtruar kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para 15 qershor 2010 ose në AKP apo në komisionet e mëparshme të likuidimit të AKM-së, kjo kërkesë nuk do të refuzohet nga komisioni i likuidimit në AKP në baza që punëtorët nuk kishin të drejtë për kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës para hyrjes në fuqi të ligjit të ri, pasi që NSH-ja nuk ishte likuiduar akoma. Në shumicën e rasteve,

<sup>2</sup> SCL-06-0007, *Zekije Osaj kundër NAK 1 Maj*, data 05/06/2008

komisioni i likuidimit nuk ka përfunduar likuidimin e NSH-së. E drejta për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës është e drejtë e përcaktuar me Ligjin e AKP-së në vitin 2008. Prandaj, kërkesat ekzistuese për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës do të shqyrtohen nga komisioni i likuidimit. Punëtorët nuk do të jenë të obliguar të parashtrorjnë kërkesa të reja për Kompensim për Ndërprerje të Parakohshme të Kontratës të Punës.

### iii) Parashkrimi

#### *Parashkrimi relativ*

Në përputhje me nenin 43.3(d)(ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 "...të gjithë kreditorët dhe kërkuesit e mundshëm se në rast të mosparaqitjes së dëshmisë së kërkesës brenda dy (2) muajve pas datës së publikimit të dytë të njoftimit, kreditorët dhe kërkuesit e tillë nuk do të jenë në gjendje të përfitojnë nga shpërndarja e të ardhurave nga procedura e likuidimit. Neni 6.1 i Rregullores për Dhomën e Posaçme nuk zbatohet."

#### *Parashkrimi absolut*

Parashkrimi absolut i punësimit lidhur me kërkesat është 3 vite. Parashkrimi absolut mund të jetë relevant vetëm nëse njoftimi i likuidimit, sipas paragrafit paraprak, nuk është plotësuar apo nuk është plotësuar në mënyrë të duhur.

Neni 608 i Ligjit për Punën Sociale, Gazeta Zyrtare e RSFJ Nr. 53/1976, parasheh që:  
"Parashkrimi ndërpret kërkesën për zbatimin e obligimeve materiale lidhur me kontratat dhe në veçanti: 1) pagesën e të hyrave personale dhe kërkesat tjera të punëtorëve; 2) pagesën për dëme lidhur me punën ... të gjitha këto kërkesa kanë parashkrim prej 3 vitesh"; dhe  
Në përputhje me nenin 87 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03/L –212/1.12.2010) "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës". Ky ligj hyn në fuqi pas 15 dhjetor 2010.

### iv) Likuidimet që kanë filluar para muajit qershor 2008. Si të trajtohen rastet kur nuk është parashtruar kërkesa për kompensim për ndërprerjen e parakohshme të kontratës të punës

Para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së, kërkesat për kompensim për shërbim nuk janë shqyrtuar si kërkesa sipas Rregullores së UNMIK-ut 2005/48<sup>3</sup>. Prandaj, shumë kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës nuk janë parashtruar pranë komisionit të likuidimit. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së, kompensimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës është konsideruar si e drejtë me prioritet në përputhje me renditjen sipas nenit 44 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48. Prandaj parashtrohet pyetja a kanë të drejtë punëtorët e NSH-së që ka hyrë në likuidim para hyrjes në fuqi të Ligjit të AKP-së në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës në përputhje me ligjin e ri? Përgjigja në këtë pyetje do të jetë po, përderisa nuk ka përfunduar likuidimi i NSH-së.

Në procedurën e likuidimit do të shqyrtohen të gjitha kërkesat e kreditorëve të parashtruara pranë komisionit të likuidimit. Kërkesat e parashtruara pas afatit do të refuzohen. Në procedurën e likuidimit, ankuesi do të parashtrorjë kërkesën brenda dy muajve nga data e publikimit të dytë të njoftimit për likuidim. Në rastet e referuara më lart, NSH-ja ka hyrë në likuidim para Qershorit 2008, prandaj mund të mendohet që kërkesa është tashmë e parashtruar pas afatit. Megjithatë, afati për kufizimet statusore fillon me kualifikimin për të drejtë të tillë (neni 360.2 i Ligjit për Detyrimet). Prandaj, do të konsiderohet që afati kohor për parashtrimin e kërkesave për kompensim

<sup>3</sup> SCL-06-0007, *Zekije Osaj kundër NAK 1 Maj*, data 05/06/2008

për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës nga likuidimet që kanë filluar para qershorit ka filluar më 15 qershor 2008 me hyrjen në fuqi të Ligjit të AKP-së.

Një pyetje tjetër është, nëse afati kohor prej dy muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji apo afatet kohore të zbatueshme me 43.3(d)(ii) apo parashkrimet e përgjithshme të zbatueshme për kërkesa për punë? Neni 43.3(d)(ii) i referohet të drejtës së ankuesit për të parashtruar kërkesat e tyre ekzistuese për kualifikueshmëri dy muaj pas publikimit të dytë të njoftimit për likuidim. Ky afat nuk është përfillur nga ankuesit pasi që asnjë publikim tjetër nuk është bërë. Publikimi i ligjit nuk mund të konsiderohet si publikim i njoftimit të likuidimit për kualifikueshmëri. Si shtesë, njoftimi për likuidim publikohet dy herë në gazetata e përditshme për të arritur në mënyrë efektive tek ankuesit potencial. Prandaj, të rastet e lartpërmendura të kërkesave për punë, i zbatueshëm do të jetë parashkrimi prej 3 viteve. Si konkludim, në rastet kur likuidimi i NSH-së ka filluar para 15 qershor 2008 dhe komisioni i likuidimit, pas asaj date ka publikuar edhe një njoftim për likuidim, parashkrimi për parashtrimin e kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës do të jetë 3 vite nga hyrja në fuqi të Ligjit të AKP-së (15 qershor 2011).

#### 2.4.2. Kërkesa ka Bazë Ligjore

Nëse punëtori i plotëson kërkesat ligjore për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të punës.

##### **Kriteret e kualifikueshmërisë:**

- Duhet të ekzistojë marrëdhënia e punës me punëtorin
- Punëtori duhet të ketë punuar apo ofruar shërbime në NSH
- Punëtori kishte marrëdhënie të varur pune me NSH-në
- Punëtori të ketë kontratë të përhershme (jo me afat të kufizuar)
- Punëtori nuk ka pranuar bonus social.

#### **2.5. Llogaritja e shumës për pagesën e ndërprerjen e parakohshme të kontratës**

i) Numri i pagave

Sipas ligjit të punës (neni 76.7), pagesa për ndërprerjen e parakohshme të kontratës duhet t'u paguhet punëtorëve sipas skemës në vijim:

- Prej dy (2) deri në katër (4) vite shërbim, paga një (1) mujore;
- Prej pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, pagë dy (2) mujore;
- Prej dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite shërbimi, paga tre (3) mujore;
- Prej njëzetë (20) deri në njëzet e nëntë (29) vite shërbimi, paga gjashtë (6) mujore; dhe
- Prej tridhjetë (30) vite ose shumë shërbimi, paga shtatë (7) mujore.

##### **Zbatimi i ligjit të ri të punës**

Ligji i ri punës Nr.03/L –212, në nenin 76.7 ofron më shumë të drejta të favorshme për punëtorët me më shumë vite përvojë se sa nenin 12.f i Rregullores së UNMIK 2001/27 që është zbatuar deri më 15 Dhjetor 2010.

Ligji i AKP-së (neni 6.3) thotë që dispozitat e Ligjit Themelor që përcakton shumën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës për përcaktimin e shumës së kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës për punëtorët e NSH-së që ka hyrë në privatizim ose likuidim. Në përcaktimin e ligjit të AKP-së termi “ligji themelor i punës” është definuar si Rregullore e UNMIK-ut 2001/27 me ndryshme të për kohë pas kohe. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 është shfuqizuar me Ligjin e Punës Nr.03/L –212 që ka hyrë në fuqi më 15 Dhjetor 2011 (neni 80 i këtij ligji). Prandaj, kriteri për përcaktimin e shumës për tu paguar për kompensimet e ndërprerjeve të parakohshme të kontratës duhet të përcaktohet me kriteret të përcaktuara në nenin 76.7 të Ligjit të Punës Nr.03/L –212.

## ii) Shuma e pagës

Nenin 76.6 i ligjit të punës thotë që pagesa e shumës së pagave mujore të paguhet si kompensim i ndërprerjes së parakohshme të kontratës. Në shumë raste, paga e punëtorëve nuk ishte përcaktuar me kontratë, vendim ose dokumente me shkrim. Veç kësaj, në shumë raste punëtorët nuk i kanë marrë pagat të siguruara me vendim ose kontratë, pasi që NSH-ja nuk kishte të hyra të mjaftueshme për të paguar pagën e plotë. Prandaj përcaktimi i pagës mund të jetë problematik.

Mjeti më i duhur për përcaktimin e pagës është lista e pagave ose dëshmia e pagesës së tatimit të të hyrave. Ligji i Punës ofron termin për paga “kompensim ose paga e çfarëdo niveli të llogaritur në formë të parave për punëtor”. Në shumë raste, lista e pagave nuk korrespondon me pagën e kontraktuar sepse në disa raste NSH-ja nuk kishte të hyra të mjaftueshme për të paguar pagat e punëtorëve. Sidoqoftë, pagat e kontraktuara në shumë raste janë të larta sa që NSH-ja kurrë nuk ka qenë në gjendje të paguaj paga të tilla. Prandaj, lista e pagave duhet të shërbej si bazë e përcaktimit të pagave mujore sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

Pagesa e fundit që punëtori e ka marrë në emër të shërbimeve të tij/saj të ofruara për NSH-në para privatizimit ose likuidimit, dmth kjo është norma e pagesës që ai/ajo ka humbur si pasojë e veprimeve të AKM/AKP në parim duhet të shërbej si pagë mujore për tu paguar sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

Në rastet kur ne i marrim pagat si punëtor me orar të plotë marrim më pak se paga minimale në Kosovë e ofruar me ligj, baza për pagën mujore sipas kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës të jetë minimumi i pagës në Kosovë. Ky parim duhet të jetë efektiv, pasi që sipas ligjit të punës, asnjë punëtor me orar të plotë nuk duhet të marrë më pak se sa paga minimale të ofruara nga autoritetet e shtetit.

## iii) Bonusi social

Në disa raste, punëtorët kanë pranuar kompensimin nga të hyrat e NSH-së, megjithëse nuk ofronin punë produktive ose shërbime për kompaninë (shembull: të hyrat e qirasë për asetin janë shpërndarë në grup të gjithë punëtorëve, ndërsa praktikisht vetëm menaxhmenti punonte me të hyrat e qirasë së NSH-së). Këta punëtorë nuk kanë të drejtë në kompensim të ndërprerjes së parakohshme të kontratës.

## **2.6. Përcaktimi i “viteve të shërbimit” në NSH**

“Vitet e shërbimit” është periudhë e kohës gjatë së cilës punëtorët punuan për atë punëdhënë, p.sh. vitet që punëtori shërbej në ndërmarrje ku kontrata e tij është përfunduar. Çdo pushim i paguar, duke e përfshirë e mos kufizuar në, pushimin e lehonisë, pushimin vjetor, festat zyrtare nuk e ndërprejnë marrëdhënien e punës dhe duhet të përfshihen në vitet e shërbimit.

Vitet e përgjithshme të shërbimit të nuk duhen marrë parasysh kur përcaktohen vitet e shërbimit, mirëpo vitet e shërbimit në NSH. NSH-ja e caktuar ka hyrë në likuidim, prandaj vetëm vitet e shërbimit në ndërmarrjen në likuidim duhet të merren parasysh. NSH-ja e likuiduar nuk duhet të mbaj borxh pagesën e kompensimit të ndërprerjes së parakohshme të kontratës për vitet e shërbimit të punëtorit në ndërmarrje ose institucione tjera.

**Punëtori nuk është i kualifikueshëm nëse:**

- Punëtori ka përfunduar kontratën e punës në mënyrë vullnetare/të njëanshme, kur NSH-ja edhe më tej paguante dhe ishte e gatshme të paguaj atij/asaj pagën e kontraktuar;
- Punëtori nuk kryente detyrat e tij/saj;
- Punëtori ishte shkarkuar nga puna sipas masave disiplinore;
- Punëtori ishte akuzuar për krim dhe dënuar për veprimet e bëra kundër NSH-së ose pronës së saj;
- Punëtori nuk punonte për NSH-në dhe nuk merrte pagën për punën e tij, tre muaj para fillimit të privatizimit ose likuidimit (duke mos përfshirë rastet e pushimit të lehonisë).
- Rastet tjera në diskrecion të KL-së

### **3. Pagat e papaguara**

Punëtorët kanë të drejtë, nëse ka fonde të mbetura pas pagesës së tarifës dhe shpenzimeve të likuidatorit, kreditorëve të siguar dhe kërkesave për pronësi të paguajnë të kompensimet e papaguara me prioritet siç përcaktohet me nenin 44 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.

Kompensimet prioritare të punëtorëve janë të grupuara në klasë dhe të paguara sipas rendit në vijim, pas kërkesave të siguruara dhe kërkesave të pronësisë:

- Pagat e papaguara të cilat kanë mbetur të papaguara deri në datën e fillimit të likuidimit të NSH-së, të kufizuar në tri (3) muaj (Neni 44.1(f) i Rregullores).
- Kërkesat tjera përfshirë kërkesat për paga të punëtorëve që nuk i nënshtrohen prioritetit më të lartë.

#### **3.1. Tri pagat e fundit të papaguara**

Menjëherë pas kërkesave të siguruara dhe kërkesave të pronës, kërkesat për tri pagat e fundit të papaguara duhet të renditen si kërkesa me prioritet. Të kualifikueshëm për pagesa të tilla duhet të jenë punëtorët të cilët kanë kryer punën e tyre për tri paga të tilla. Tri pagat e fundit të papaguara duhet të konsiderohen si kritere, sepse në praktikën e procesit të privatizimit në Kosovë, NSH-ja nuk kishte paguar punëtorëve tri pagat e fundit, sepse është kuptuar që tri pagat do të paguheshin nga të ardhurat e likuidimit. Veç kësaj, kjo metodologji është e praktikueshme, sepse është lehtë për tu identifikuar nga KL-të, shuma e pagave, nëse paga është paguar për të konkluduar që kërkesa nuk është me afat të skaduar. Përfundimisht, punëtorët në kërkesë nuk e specifikojnë se për cilën pagë të papaguar ata ankohen dhe nuk përfshijnë dëshmitë për mos pagesën e pagave.

### **3.2. Kërkesat tjera për pagat e papaguara**

Kërkesat me prioritet gjithashtu janë kërkesat tjera të punëtorëve dhe janë vendosur pas kërkesës për tri pagat e fundit të papaguara siç përshkruhet në paragrafin 1 më lart (shih nenin 44.1(g) të Rregullores UNMIK-ut 2005/48).

Kërkesat e punëtorëve sipas nenin 44.1(g) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 duhet të përfshijnë:

1. Pagat e papaguara (neto) të punëtorëve të papaguara nga Punëdhënësi (NSH), më pak se tri paga e fundit;
2. Kontributi pensional i papaguar dhe tatimit në të hyra personale nga NSH në Autoritete Tatimore në emër të punëtorëve;
3. Pushimi i papaguar nga punëdhënësi vetëm në rastet kur punëtori ka punuar;<sup>4</sup>
4. Kompensimet tjera për të bërë nga Punëdhënësi sipas marrëveshjes për punë (e vlerësuar me çmim të tregut);
5. Përfitimet jo-monetare, sikur transporti në punë dhe nga puna, ushqimet dhe të papritura, rroba për mbrojtje në punë vetëm në rastet kur punëtori punon;

### **3.3. Kush është i kualifikueshëm për pagat e papaguara**

Kriteri për përcaktimin e kualifikueshmërisë për personat e kualifikueshëm për pagat e papaguara duhet të përbëhet prej këtyre komponentëve:

- Marrëdhënia e punës me punëtorët duhet të ekzistoj
- Punëtori të ketë punuar ose ofruar shërbime për NSH
- Punëtori nuk ka pranuar pagesën për punën e tij/saj
- Punëtori ka marrëdhënie të varur të punës me NSH-në
- Punëtori nuk ka pranuar bonuset sociale.

#### i) Marrëdhënia e Punës

Punëtori duhet të dëshmojë ekzistencën e marrëdhënies së punës për tu bërë i kualifikueshëm për kërkesën për pagën e papaguar. Marrëdhënia e punësimit nga kontrata e punës ose libri i punëtorëve. Dëshmitë tjera potenciale për dëshmimin e ekzistimit të marrëdhënies së punësimit duhet të jetë Lista e Punëtorëve e Menaxhmentit, Lista e Pagave etj.

#### ii) Performanca e punëtorëve

Për tu bërë i kualifikueshëm për kërkesën e pagave të papaguara, punëtori të ketë punuar ose ofruar shërbime për NSH-në gjatë periudhës së ankuar të pagës së papaguar. Kërkesat kur punëtorët ankohen për pagat e papaguara, mirëpo është e qartë që punëtorët nuk kanë kryer ndonjë shërbim për NSH-në për periudhën e ankuar, duhet konsideruar si punëtorë aktiv (punëtorët rreth pushimit të papaguar ose punëtorët në listë të pritjes). Kërkesa të tilla duhet të anulohen nga komisionet e likuidimit. Në disa raste më të sofistikuara punëtorët kanë pranuar “bonuset sociale” në bazë materiale, p.sh. menaxhmenti ka shpërndarë të hyrat e qirasë në mes të punëtorëve dhe ka llogaritur

---

<sup>4</sup> Ligji i Punës 03/L-212, neni 36



si një pagesë në avans, megjithëse punëtorët nuk kryejnë ndonjë punë në NSH. PAGESA TË TILLA DUHET TË KONSIDEROHET SI “BONUS SOCIAL” E JO SI PAGESË NË AVANS NË EMËR TË PAGAVE TË PAPAGUARA.

Marrëdhënia e punës është marrëdhënie kontraktuese në përbërje të obligimeve të përbashkëta të palëve (shërbime dhe shpërblime) dhe i nënshtrohet parimeve të Ligjit mbi Obligimet (Neni 122). Asnjë shpërblim nuk jepet nëse shërbimi është kryer. Kërkesat e punëtorëve të cilët nuk kanë kryer ndonjë punë ose shërbim të punëdhënësit nuk duhet të konsiderohet si kërkesë për pagat e papaguara.

Rastet e veçanta: pamundësia për të performuar

Ankuesit, të cilëve marrëdhënia e punës kurrë nuk ishte përfunduar ose konfirmuar nga gjykata që përfundimi ishte jo valid, mirëpo nuk ka mundur të kryer ndonjë punë kundrejt dëshirës së tyre për shkak të (i) implementimit të masave të përkohshme në vitin 1989-1999, ose (ii) kushtet e pafavorshme të sigurisë që parandalojnë atë që përkohësisht të paraqitet në punë. Këto grupe të ankuesve pretendojnë kompensimin për pagat e papaguara për periudhën e kohës kur nuk janë në gjendje të punojnë për punëdhënësin. Këta ankues duhet të jenë të kualifikueshëm për pagat e papaguara, nëse kërkesat e tyre janë të parashkruara. Përfshirja e këtij grupi është justifikuar ligjërisht; sepse nuk ishin në gjendje të kryejnë punën e tyre për arsye të:

a) Refuzimi i punëdhënësit për të pranuar punën e tyre të kontraktuar ose shërbimet në baza diskriminuase

b) Kushtet e pafavorshme të sigurisë që parandalojnë atë që paraqitet në punë.

Në rastet kur punëdhënësi refuzon shërbimet ose punën e punëtorit (sipas paragrafit a) më lart) bazuar në motivimin i cili nuk mbështet me ligj, punëtori nuk është i obliguar për të performuar, mirëpo mban të drejtën ndaj palës tjetër (neni 138.1 i ligjit mbi obligimet).

Termi “përkohësisht” në paragrafin b) më lart nënkupton gjendjen ku punëtori për shkak të gjendjes së sigurisë në Kosovë nuk ishte në gjendje të kryer detyrat e tij/saj për periudhë të caktuar megjithëse punëtori ka ofruar performancën për NSH-në kohë pas kohe. Pengesë e tillë nuk duhet të jetë natyrë e përhershme, e përkohshme vetëm deri sa është përmirësuar gjendja e sigurisë dhe është pritur nga punëtori të kryej detyrat e tij/saj të punës.

**Shënim i rëndësishëm:** Këto kërkesa zakonisht janë të parashkruara, prandaj së pari ju lutem kontrolloni parashkrimin.

Rasti i pamundësisë për të performuar, Ankuesi duhet ti qaset gjykatës relevante dhe të parashtrij padë ndaj NSH-së. Parashkrimi për parashtrimin e padisë për shkak të shkeljes së të drejtave të punës është 3 vite (Neni 608 i Ligjit mbi Punën Sociale, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 53/1976, thotë që: "Parashkrimi përfundon kërkesën për ekzekutim të obligimeve materiale e cila ndërlihet me kontratat dhe në veçanti: 1) pagesa e të hyrave personale dhe kërkesave tjera të punëtorëve; 2) pagesa për punën lidhur me dëmet .... Të gjitha kërkesat tjera janë të parashkruara për 3 vite".)

Nëse ankuesi nuk ka iniciuar parashtrim në gjykatë atëherë kërkesa e tillë është parashkruar, përndryshe KL-të shqyrtojnë dhe vlerësojnë vendimet përkatëse të gjykatës.

Praktika e gjykatës: **Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës SCC- 07 – 0191 të 1 Nëntor 2007.**

Ankuesi kërkon kompensim për pagat e papaguara për periudhën e ashtuquajtur “masat e përkohshme” prej 1989-1999. Ekzistojnë katër shkallë të kompensimit të kërkesave të cilat janë parë në programin e likuidimit.

i) Kërkesa pa aktgjykim të gjykatës e bërë për here të pare gjatë procedurës së likuidimit kërkon kompensim të pagave për periudhën e lartë përmendur. Këto kërkesa duhet të anulohen sit të parashkruara.

ii) Kërkesa e parashtruar me aktgjykimin e gjykatës të lëshuar nga një gjykatë para vitit 1999 në favor të punëtorit bazuar në procedurat e filluara pas largimit gjatë vitit 1999. Kërkesat në këtë kategori të rastit duhet të jenë të pranuar në parim

### iii) Mungesa e pagesës

Punëtori duhet të pranoj çfarëdo pagese ose kompensim për punën ose shërbimin e bërë. Në të kundërtën, punëtori nuk duhet të jetë i kualifikueshëm për pagat e papaguara.

### iv) Marrëdhënia e punës e varur

Ofruesit e shërbimeve, punëtorët sezonal të anëtarëve të nderuar të bordit (nëse nuk ishin tërësisht të punësuar në NSH) nuk janë emetuar për pagat e papaguara. Për përcaktimin e gjendjes së punëtorit i rëndësishëm është fakti që punëtori ishte punëtor afat gjatë në NSH dhe ai/ajo ishte i kufizuar me udhëzimet e punëtorëve (ai nuk ishte i pavarur ose profesional i pavarur). Ofruesit e shërbimeve, konsulentët, të pavarurit etj. Duhet të konsiderohen si kontraktor dhe jo si punëtorë.

## **3.4. Vendimi mbi kërkesat për pagat e papaguara**

Kërkesat për pagat e papaguara duhet të miratohet nëse kërkesa është e pranueshme dhe me bazë ligjore.

### i). Kërkesa është e pranueshme nëse nuk është parashkruar

*Parashkrimi relativ*

Sipas nenit 43.3(d)(ii) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48 "...të gjithë kreditorët potencial dhe ankuesit që kanë dështuar të parashtrajnë dëshmi të kërkesës brenda dy (2) muajve të datës, njoftimi i dytë është publikuar do të rezultojë me kreditor dhe ankues të tillë duke mos qenë në gjendje të përfitoj nga shpërndarja e të ardhurave të procedurave të likuidimit."

*Parashkrimi absolut*

Parashkrimi absolut për kërkesat që kanë të bëjnë me punësimin është 3 vite.

Nëse pranoi kërkesë për pagë të papaguar, ju lutem kontrolloni fillimisht nëse kërkesa është e parashkruar. Neni 608 i Ligjit për Punë Sociale, Gazeta Zyrtare RSFJ Nr. 53/1976 dhe neni 87 i Ligjit të Punës (Nr.03/L –212/1.12.2010 parasheh parashkrimin prej 3 viteve për të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me punësimin. Nëse kërkesa që është më e vjetër se tri vite dhe nuk është ndërprerë në pajtim me nenet 382-393 të Ligjit për Marrëdhënie të Detyrimeve, kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

ii). Kërkesa është e bazuar në rast se punonjësi i plotëson kërkesat ligjore dhe është i kualifikueshëm për të marr pagën e papaguar.

#### **Kriteret e kualifikueshmërisë:**

- Marrëdhënia e punës me punonjësin duhet të jetë ekzistuese
- Punonjësi duhet të ketë punuar ose kryer shërbime në NSH
- Punonjësi nuk ka marr pagë për punën e tij/saj
- Punonjësi pati marrëdhënie të varur të punës me NSH.

## **3.5. Shqyrtimi i kërkesave për pagat**

i) Vlerësimi i situatës faktike

Komisionet e likuidimit mund të përdorin qasjen e përmbledhur më poshtë si udhëzues për vlerësimin e situatës faktike të kërkesave për pagat.

**Lista e plotë e vlerësimit të ankesave për pagat**

1. Identifikoni ankuesin - Kopjen e identifikimit (ID) Letërnyoftimin
2. Analizoni kopjen e Librezës së punës ( nëse nuk ka librezë të punës, sqaroni pse dhe çfarë është burimi i përdorur i informacionit për identifikimin e marrëdhënies së punës për periudhën e caktuar)
3. Përcaktoni qartë datat se kur ankuesi ka filluar punën në këtë NSH.
4. Gjeni të dhëna në NSH për vendimin e punësimit dhe/ose kontratës
5. Cila është data e fundit që ankuesi ka dal në punë në këtë NSH
6. A ka pranuar ankuesi ndonjë njoftim me shkrim në lidhje me tepricat teknologjike apo ndonjë njoftim për të mos dal në punë?
  - Nëse po, bashkëngjitni një kopje të njoftimit me shkrim në lidhje me tepricat teknologjike apo ndonjë njoftim për të mos dal në punë
  - Nëse jo, bashkëngjitni një deklaratë me shkrim pse ju nuk jeni kthyer në punë në këtë NSH.
7. A ka aplikuar ankuesi në Gjykatë apo ndonjë institucion të njohur për mbajtjen e statusit të punës, siç kërkohet në Ligjin për punën e bashkuar?
  - Nëse po, bashkëngjitjani kopjen e aplikimit dhe cilindo vendim nga gjykata.
  - Nëse jo, ju lutemi sqaroni pse ankuesi nuk ka aplikuar
8. Sa ishte paga mujore BRUTO e ankuesit? (specifikoni në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro)
9. Cila ishte data kur ankuesi kishte marr pagën e tij/saj të fundit?
10. Me çfare periudhe kohore kjo pagë e fundit ka të bëjë?
11. Sa ishte vlera e pagës së fundit të pranuar - BRUTO ? ( specifikoni në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro)
12. Zbuloni, kërkoni dhe bashkëngjitni çdo njoftim për pagën ose ndonjë faturë bankare për të konfirmuar këtë pagesë
13. Në kohën e shkuarjes së paditësit, ai/ajo a kanë pasur ndonjë kredi të papaguar apo ndonjë pagë të marr si akontacion apo paga tjera të marra nga ankuesi prej NSH-së (Nëse po, cila ishte shuma në valuten origjinale dhe të konvertuar në euro dhe siguroni përshkrimin për pagesë)
14. Kërkoni nga paditësi që të siguroj deklaratën me shkrim ku i specifikon të gjitha punët që ai/ajo ka pasur që nga data kur ka punuar për herë të fundit në këtë NSH.
15. Kërkoni nga Ankuesi të ofrojë dokumente tjera apo dëshmi mbështetëse që ju mendoni se janë relevante për kërkesën e Ankuesit.

ii) Përmbledhja e informacioneve (tabela)

<b>Emri i NSH-së:</b>		<b>Rajoni:</b>			
<b>Emri i ankuesit:</b>					
<b><u>Detajet mbi pagat dhe kërkesa për kompensim nga shkëputja e kontratës së punës</u></b>					
<b>Pagat – që ka të bëj me punën që paditësi e ka kryer në këtë NSH, dhe që ende nuk e ka marr pagën</b>					
<b>Përshkrimi</b>	<b>Data e fillimit</b> <i>d/m/v</i>	<b>Data e mbarimit</b> <i>d/m/v</i>	<b>Shuma bruto</b>	<b>Valuta origjinale</b>	<b>E konvertuar ne euro</b>
			<i>Gjithsejt paga (në euro)</i>		
<b><u>Kompensimi nga shkëputja e kontratës së punës</u> - sipas Ligjit Nr. 03/L-067 (Ligji i AKP-së), Neni 5.7 b (ii)</b>					
<b>Vendosni më poshtë figurat për eksperiencën e punës së paditësve në këtë NSH</b>					
	<b>Data e fillimit</b> <i>d/m/v</i>	<b>Data e mbarimit</b> <i>d/m/v</i>	<b>Gjithsej vite punësimi</b>		
			<i>Vite</i>	<i>Muaj</i>	
<b>Komentet – Vendosni ndonjë koment apo sqarim në lidhje me padinë e paditësit</b>					

Paga mujore bruto do të vlerësohet në bazë të kontratës së punës, listës së pagave apo ndonjë burimi tjetër në dispozicion. Shuma bruto e padisë së punëtorëve i nënshtrohet zbritjes prej 5 % për kontribut pensional dhe pastaj zbritja tjetër prej 10% (nga 95%) për tatimin në të hyra.

Me qëllim të marrjes së të dhënave nga kërkesa në likuidim, shuma prej 5% duhet t'i shtohet kërkesës së punëtorit të përcaktuar që të merr llogarinë nga kontributi i punëdhënësit në fondin pensional.

Sipas Rregullores 2005/48, 44(f) deri në tre paga mujore bruto do të pranohen si kërkesa të favorizuara. Paga mujore bruto llogaritet duke u bazuar në kontratën e punësimi, listën e pagave apo ndonjë burimi tjetër në dispozicion, duke përfshirë marrëveshjet e veçanta ndërmjet punonjësve dhe NSH ku për një nivel më të ulët të pagave janë pajtuar palët.

Nëse ankuesit i takojnë më shumë se tre paga mujore bruto, pjesa e mbetur do të pranohet si kërkesë e pasiguruar sipas Rregullores 2005/48, 44(g).

Kur paga është paguar, zbritjet e bëra për tatimin në të hyra dhe kontributet pensionale (si dhe kontributi i punëdhënësit) duhet t'i paguhen ATK-së deri me datën 15 të muajit të ardhshëm.

### **3.6. Kërkesë për informata shtesë**

Çdo informacion i cili mungon apo nuk është i qartë për komisionin e likuidimit, kur merret parasysh situata faktike kërkohet që të parashtrohet nga ankuesit duke i ofruar atij/asaj mjaftë kohë. (p.sh. 30 ditë nga data kur paditësi ka paraqitur njoftimin).

**Nëse ankuesi dështon që të siguroj dëshmi shtesë apo dokumente në mbështetje të kërkesës së tij me kërkesën e komisionit të likuidimit për informata shtesë, atëherë kërkesa e tij/saj do të refuzohet si jo e vlefshme sipas paragrafit 32.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/48 (Komisioni i Likuidimit mund të refuzoj çdo kërkesë në bazë të mos-pranueshmërisë, nëse ankuesi nuk parashtron kërkesë të kompletuar, apo t'i përgatis dokumentet e kërkuara brenda afatit të përshkruar në kërkesë).**

### **3.7. Vlerësimi i kërkesave të vlefshme**

Komisioni i Likuidimit duhet të jetë në gjendje që t'i bëj këto përlllogaritje në lidhje me kërkesat për paga:

- Cili është kompensimi i përgjithshëm për pagat neto?
- Cili është kompensimi i përgjithshëm për kontributin pensional (si për punonjësën po ashtu edhe për punëdhënësin)?
- Sa është kompensimi i përgjithshëm për tatimin në të hyra personale?

Me krijimin e shumave të përgjithshme më sipër, komisionet e likuidimit do t'i ndajnë pagat sipas prioriteteve dhe radhitjeve nga pagesat e përgjithshme të pasiguruaras siç është definuar në paragrafin 44.1 (f) dhe (g) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48.

Shumat e ndara sipas radhitjes së pagave përbëhet nga pagat neto, kontributi pensional dhe taksa në të hyra. Pra në distribuim ankuesi pranon vetëm pagën neto, kurse kontributi pensional dhe taksa në të hyra mbahen në dobi të ATK-së. Komisionet e likuidimit duhet të analizojnë me kujdes nëse ankuesi ka pretenduar pagë "Bruto" apo "Neto". Respektivisht, kërkesat e ATK-së mbi pagat e paguara në dobi të kontributeve pensionale dhe taksa në të hyra personale refuzohet ndërsa këto i paguhen ATK-së proporcionalisht për pagesën Neto për ankuesin. Kjo duhet të shmang llogarinë e dyfishtë të kërkesës.

### **4. Vlerësimi i komponentës së tatimit**

i) Kategoritë që i nënshtrohen tatimit

Ligji mbi pagën personale në paragrafin 9.1 dhe 9.3 të (Ligjit Nr. 03/L-161/29.12.2009) definojnë këto kategori që e formojnë pagën dhe i nënshtrohen tatimit:

- Pagat e paguara nga punëdhënësi për punëmarrësin për punën që e ka bërë nën drejtimin e menaxherit apo punëdhënësit,
- Bonuset, përqindjet, dhe format tjera të kompensimit që punëdhënësi apo dikush tjetër në emër të punëdhënësit i paguan punëtorët mbi pagën e sipërpërmendur;
- Të hyrat nga puna e përkohshme e kryer nga punëtori;
- Të hyrat nga punësimi i mundshëm, të tilla si firmosja e bonusit të pagës; Premisat e sigurimit shëndetësor që punëdhënësi i paguan për punonjësën;
- Falja e borxhit të punonjësit apo obligimi për punëdhënësin.
- Pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga ana e punëdhënësit; dhe Përveç nëse është ofruar ndryshe në Ligjin aktual, përfiton në gjërat e dhëna nga punëdhënësi tek punëmarrësi që e tejkalojnë shumën minimale të përcaktuar në aktin nën-ligjor të parashtruar nga Ministri.
- Kontributet e bëra nga punëdhënësi për punëmarrësin në sistemin e kursimeve pensionale individuale, fondi pensional shtesë i punëdhënësit dhe skema e fondit pensional shtesë të punëdhënësit nën legjislacionin e Trustit të Kursimeve pensionale të Kosovës; dhe

- Kontributet e bëra nga punëmarrësi për Sistemin e kursimeve pensionale individuale, fondi pensional shtesë i punëdhënësit dhe skema e fondit pensional shtesë të punëdhënësit nën legjislacionin e Trustit të Kursimeve pensionale të Kosovës;

## ii) Të hyrat e përjashtuara nga tatimi

Të hyrat në vijim nga pagat janë përjashtuar nga tatimi siç është paraparë me nenin 9.2 të (Ligjit Nr. 03/L-161/29.12.2009):

- Rimbursimi i shpenzimeve për udhëtime zyrtare deri në shumat e specifikuara në aktet nënligjore të lëshuara nga MEF;
- Dëmshpërblim për aksidentet në punë; dhe
- Përfitimet në mall të dhënë nga punëdhënësit punëtorëve të huaj për të lehtësuar jetën e tyre në Kosovë, siç është banimi dhe pagesa për shkollim.
- Përfitimet në natyrë në formë të ushqimit të siguruar nga punëdhënësi për punëtorin, duke përjashtuar kompensimin në të holla.
- Rimbursimi, i kufizuar në më pak se shpenzimet e transportit publik apo 0.16 Euro/KM, për largësinë më të gjatë se njëzet (20) kilometra.
- Përfitimet në natyrë që i dhurohen punëtorëve në formë të biletave të transportit publik për në vendin e punës.
- Përfitimet në natyrë për largësi më të mëdha se një (1) kilometër.
- Rimbursimet e tilla apo dhurimi i beneficioneve në natyrë nuk do të zbritet si shpenzim i çfarëdo lloji.

Gjatë vlerësimit të kërkesave për paga, komisionet e likuidimit do të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet elementeve të tatueshme dhe të pa-tatueshme të kërkesës për paga. Në shumë instance, bonusi social dhe të hyrat tjera të pa-tatueshme janë llogaritur nga NSH-ja si paradhënie e rrogës ndaj punëtorëve. Komisionet e likuidimit do të përshtatin kërkesat gjatë vlerësimit të tyre.

## iii) Legjislacioni në fuqi

Ligji në fuqi të cilin KL do të konsideroj gjatë vendosjes për kërkesat për punë është si në vijim:

- Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59
- **Ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989**

*Në rastet e jashtëzakonshme me mungesë të ligjit për rregullimin e çështjeve apo situatave, shfrytëzo ligjin pas 22 mars 1989 i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/59*

- Ligji për Punën Sociale, Gazeta Zyrtare RSFJ Nr. 53/1976
- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, deri në shtrirje të zbatueshme.
- **Ligji i Punës LIGJI Nr. 03/L –212, do të shfuqizoj Ligjin për Punën Sociale 1976/77 dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 dhe do të zbatohet nga 15 dhjetor 2010**
- Ligji për Tatimin në të Hyra Personale Nr. 03/L-161/29.12.2009
- Rregullorja mbi Pensionet në Kosovë - Rregullorja e UNMIK-ut 2001/35 mbi pensionet dhe me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/20

## **Aneks i Udhëzuesit të Likuidimit**

### **Procedimi i Kërkesave Kolektive ne procedurën e likuidimit**

#### **1. Historiku dhe çështja**

Që nga iniciimi procedurave të para të likuidimit ndaj Ndërmarrjeve Shoqërore (N.SH.) në kohën e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), kreditorët parashtronin kërkesat e tyre në të shumtën e rasteve si kërkesa individuale. Ka situata kur kreditorët kanë paraqitur kërkesa kolektive, pra është paraqitur një formular për paraqitjen e kërkesave në likuidim kundër një ndërmarrjeje shoqërore, e nënshkruar zakonisht nga një përfaqësues, në emër dhe për interes të dy apo me shumë kreditorëve. Pranimi dhe regjistrimi i këtyre kërkesave në bazën e të dhënave të likuidimit në AKP por edhe ish – AKM është bërë me një numër unik protokollar.

Në fakt, jashtë procedurës ligjore midis kreditorëve të paraqitur përmes kërkesës kolektive nuk ekziston ndonjë lloj i bashkësisë apo lidhjes dhe sipas rregullit ata do të mund të paraqiteshin edhe si palë individuale në procedurë.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të ngritura ndaj ndërmarrjeve shoqërore (N.SH.), për të cilat OSHP është emëruar nga AKP si autoritet likuidimi, dhe ka identifikuar një numër të kërkesave të cilat përfshijnë disa kërkesa individuale e të cilat janë paraqitur në mënyrë kolektive. “Kërkesë kolektive” i referohet situatave kur pretenduesit kanë paraqitur vetëm një formë për parashtrimin e kërkesës, të nënshkruar nga një person i autorizuar në emër të pretenduesve të shumtë.

Për arsye ligjore dhe praktike, nuk është e mundur që të përgatitet dhe të dërgohet një “vendim kolektiv” si përgjigje ndaj një “kërkesë kolektive”. Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji AKP), neni 31.1, shprehimisht përcakton se Ligji për Procedurën Administrative nuk zbatohet në lidhje me trajtimin dhe marrjen e vendimit nga AKP ose një autoritet likuidimi lidhur me një kërkesë ose interes të parashtruar nga një person në cilësinë e një kreditori ose pronari të supozuar.

Ligji AKP nuk përmban asnjë dispozitë në të cilën përmendet kërkesa kolektive dhe të gjitha referencat në kërkesa dhe kreditorë janë të individualizuara. Përkufizimi i termit “dëshmi e kërkesës” shprehimisht i referohet “një kreditori të supozuar”, gjë që nënkupton se secili kreditor individual duhet të paraqesë dëshminë e kërkesës së tij në mënyrë individuale. Ky argument mbështetet nga neni 23 i Shtojcës së Ligjit AKP i cili e krijon lidhjen midis një dëshmie të kërkesës me një kreditor individual. Kreditorët e regjistruar janë kreditorë individual dhe jo një kolektiv i kreditorëve. Pretenduesit individualë mund të kenë zgjedhur opsionin për të autorizuar një përfaqësues me qëllim të grumbullimit të kërkesave individuale që ato të parashtrohen në mënyrë “kolektive” në AKP për të lehtësuar procesin e paraqitjes dhe të shqyrtimit të kërkesave. Ky ka qenë kryesisht atëherë rasti kur punëtorët e një ndërmarrje

shoqërore i kanë grumbulluar kërkesat e tyre dhe i kanë parashtruar bashkërisht në AKP përmes një përfaqësuesi të përbashkët. Megjithatë, pavarësisht prej grumbullimit të kërkesave, secili pretendues e ka një kërkesë e cila dallon nga kërkesat tjera në kuptimin e shumës së kërkuar dhe bazës ligjore. Çdo shumë që kërkohet nga një pretendues dhe që është e përfshirë në një “kërkesë kolektive” duhet të shqyrtohet dhe të llogaritet në mënyrë individuale në lidhje me vlefshmërinë dhe saktësinë e saj. Secili punëtor ka kontratën e tij të punës me ndërmarrjen shoqërore përkatëse dhe burimi i detyrimit ligjor të ndërmarrjes shoqërore ndaj punëtorit është kontrata individuale e punës. Çështja do të ishte ndryshe nëse pretenduesit do të paraqitnin një kërkesë ndaj ndërmarrjes shoqërore mbi bazë të një kontrate të cilin ata e kanë lidhur bashkërisht me ndërmarrjen shoqërore. Por deri sa pretenduesit vetëm i grumbullojnë kërkesat e tyre individuale, dhe secila kërkesë rrjedh nga një kontratë të cilën pretenduesit e kanë lidhur veç e veç dhe në mënyrë individuale me ndërmarrjen shoqërore, atëherë secili pretendues duhet të marrë përgjigjen individuale ndaj kërkesës së tij individuale.

Në rast se autoriteti i likuidimit nxjerr vetëm një vendim dhe një nga pretenduesit e shumtë i përfshirë nga vendimi në fjalë është i pakënaqur me vendimin, një ankesë ndaj këtij vendimi do të kishte pasoja për vendimin në tërësi dhe do të prekte edhe pretenduesit të cilët janë të kënaqur me vendimin. Gjykata mund ta shpall vendimin të pavlefshëm dhe kështu të ndikojë negativisht te të gjithë pretenduesit të përfshirë nga vendimi në fjalë, pa marrë parasysh se a janë të kënaqur apo të pakënaqur me të.

Përveç çështjeve ligjore, nxjerrja e një vendimi si përgjigje ndaj një “kërkese kolektive” rezulton në probleme serioze të natyrës praktike. AL është ballafaquar me situata kur personi i caktuar si përfaqësues i autorizuar kishte vdekur ose për arsye të tjera nuk ishte më i autorizuar. U dëshmuar si punë e vështirë që të mblidhen të gjithë nënshkrimet e pretenduesve të përfshirë në “kërkesën kolektive” për të caktuar një përfaqësues të ri të autorizuar, sidomos pasi që një numër i pretenduesve kishte vdekur në ndërkohë. Përfundimisht, AL u detyrua, që të nxjerr vendime individuale për të siguruar mbrojtjen adekuate të interesave të kreditorëve (shih rastin e NSH IMK Fabrika e Gypave).

Duke marrë parasysh shqetësimet ligjore dhe praktike si më sipër, dhe me qëllim të dhënies së efektit maksimal për mbrojtjen e interesave të kreditorëve, ashtu siç kërkohet me ligj, janë përgatitur draft udhëzime të cilat sqarojnë kushtet kur mund të nxirret një “vendim kolektiv” në vend të vendimeve individuale si përgjigje ndaj një “kërkese kolektive”, gjithnjë duke marrë parasysh që prioritet i çdo veprimi në këtë drejtim është që të sigurohet zbatimi i ligjit dhe përmbushja e përgjegjësisë së autoritetit të likuidimit për të mbrojtur interesat legjitime të kreditorëve. po ashtu janë paraqitur zgjidhje se si të trajtohen “kërkesat kolektive” nga këndvështrimi procedural, duke marrë parasysh se një pjesë e madhe e “kërkesave kolektive” nuk kanë autorizim të vlefshëm. Draft udhëzimet janë të përshkruara mëposhtë.



## **2. Shqyrtimi i kërkesave kolektive në procedurën administrative**

2.1. Procedimi administrativ i kërkesave kolektive gjenë zbatim kur dy apo më tepër palë në të njëjtën lëndë paraqiten bashkërisht në të njëjtën procedurë administrative, nëse kërkesat e parashtruesve bazohen në fakte esencialisht të njëjta si dhe bazë ligjore të njëjtë.

Ekzistojnë situata kur paditësit kanë dorëzuar “kërkesë kolektive”, pra ekziston vetëm një formular i dorëzimit të kërkesës i nënshkruar nga një person i autorizuar në emër të pretendueseve të shumtë. Në disa raste kjo mund të vërtetohet se nuk kishte autorizim të ligjshëm kur është dorëzuar kërkesa kolektive ose kur personi i autorizuar kishte ndërruar jetë në ndërkohë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për kërkesat kolektive të cilat janë dërguar shumë më herët.

2.2 Një kërkesë kolektive mund të jetë e pranueshme dhe një “vendim kolektiv” mund të lëshohet si përgjigje për atë kërkesë kolektive nëse kërkesat në vijim janë të kënaqshme në mënyrë kumulative:

- Kërkesa është e përkrahur nga një autorizim i vlefshëm, i cili duhet të vërtetohet nga gjykata ose të noterizohet;
- Autorizimi duhet në mënyrë të qartë të specifikoj zgjatjen e autorizimit, p.sh. nëse është vetëm për qëllime të dorëzimit ose nëse ka ndonjë fushëveprim shtesë të autorizimit, p.sh. mbledhja e të ardhurave të likuidimit;
- Kërkesa kolektive përfshin vetëm kërkesat që kanë të njëjtën kategori të pretendimeve dhe që i përkasin të njëjtës NSh;
- Kërkesa mund të pranohet ose të refuzohet për të gjithë pretenduesit për arsye të njëjta ligjore dhe jo vlerësim i ndryshëm ose i veçantë të kërkesave individuale nuk është i nevojshëm në kërkesat kolektive.

## **3. Pranueshmëria e Kërkesës Kolektive**

3.1. Kërkesat kolektive të paraqitura në procedurën e likuidimit dhe vendimet kolektive duhet të lëshohen nga AL nëse plotësohen kushtet e caktuara në mënyrë kumulative. Kushtet të cilat duhet të plotësohen mbi pranueshmërinë e një kërkesë kolektive janë të listuara në seksionin 2.2.

## **4. Autorizimi, komunikimi dhe njoftimi**

4.1 Procedura e likuidimit ndaj 177 ndërmarrjeve shoqërore ka filluar gjatë periudhës 2005-2011 nga ish AKM-ja dhe AKP-ja. Gjithashtu, edhe kërkesat kreditore duke përfshirë edhe ato kolektive janë pranuar disa vite më parë, por fatkeqësisht procedimi i këtyre kërkesave duke përfshirë edhe kushtet formale të pranueshmërisë së tyre nuk është bërë me kohë.

4.2 Në rast se adresa e të gjithë pretendueseve të përfshirë në vendimin original kolektiv nuk është e njohur, autoriteti i likuidimit duhet të publikoj një njoftim në më së paku dy gazetate ditore që qarkullojnë në Kosovë në të dyja gjuhët shqip dhe serbisht dhe në faqen zyrtare të AKP-së duke informuar paditësit për nevojën për të dorëzuar një autorizim të vlefshëm brenda afatit të përcaktuar. Njoftimi duhet të bëjë të qartë që kërkesat e atyre pretendueseve të cilët nuk kanë siguruar një autorizim të vlefshëm do të refuzohen me skadimin e afatit. Vendimet për të refuzuar padinë nga dështimi për të siguruar prova për përfaqësim do të përgatiten individualisht për të gjithë paditësit në fjalë dhe do të dorëzohen në AKP ku mund të mblidhen vendimet nga pretenduesit.

Në rast se kërkesa kolektive e cila nuk është e përkrahur nga një autorizim i ligjshëm por përndryshe i përmbush kërkesat e përcaktuara në (2.2) më lartë, do të kërkohej nga autoriteti i likuidimit të refuzoj kërkesën (shiko Politikate Operacionale të AKP-së, Neni 7.6.4). Sidoqoftë, në mënyrë për të shmangur vështirësitë disproporcionale nga vështirimi i faktit që kërkesat kolektive janë dorëzuar vite më parë dhe AKP-ja nuk e ka paralajmëruar faktin që autorizimi ishte ligjërish të pavlefshëm, autoriteti i likuidimit duhet të mundohet të gjej një zgjidhje që i mbrohet interesat e kreditorëve pa e komprometuar natyrën e saktë dhe formale të procesit të likuidimit. Në lidhje me këtë, autoriteti i likuidimit duhet të kërkojë nga secili pretendues individual të dorëzojë një autorizim të vlefshëm. Kjo qasje duhet të ndiqet nëse adresa e secilit paditës është e ditur për autoritetin e likuidimit. Autoriteti i likuidimit vendos një afat për dorëzimin e autorizimit të tillë - 15 ditë kalendrike. Dështimi për të dorëzuar një autorizim nga të gjithë pretenduesit të përfshirë në kërkesë origjinale kolektive do të rezultonte në kërkesat e tyre duke mos siguruar autorizimin të refuzohet për shkak të mungesës së provës për përfaqësim. Vendimet për të refuzuar padinë për dështim për të siguruar prova të përfaqësimit do të ju dërgohen individualisht të gjithë pretendueseve në fjalë.

4.3 Paditësit të cilit ishin të informuar për nevojën për të dorëzuar një autorizim të vlefshëm, qoftë nga një korrespondencë e drejtë për drejtë ose nga një njoftim publik (4.2) mund gjithashtu të anoj për dorëzimin e kërkesës në baza individuale pa kërkuar ndihmë nga kinse personi i autorizuar, sigurimi i kërkesave të tyre është në esencë, me fushëveprim dhe kategori të njëjtë si ajo e përfshirë në kërkesën kolektive. Në rast të tillë, autoriteti i likuidimit duhet të lëshoj një vendim individual secilit pretendues i cili zgjedh të mos përfaqësohet nga një person i tretë.

4.4 Në rast se kërkesa kolektive e cila nuk i kënaq në mënyrë kolektive të gjitha kërkesat të përcaktuara në (2.2) më lartë, dhe i cili nuk është i mbuluar nga shkarkimet të përcaktuara në (4.2) , vendimet të cilat pranojnë në mënyrë të plotë ose të pjesshme ose që refuzojnë padinë duhet të përgatiten dhe të dërgohen në baza individuale. Çdo paditës duhet të pranojë një vendim individualisht në lidhje me padinë e saj/tij.

4.5 Në rast se ka probleme për të identifikuar adresën e secilit person përgjegjës, autoriteti i likuidimit duhet të krijoj adresën duke u bazuar në informatën në dispozicion të përfshirë në arkiv të NSH-së përkatëse. Në rast se arkiva nuk siguron informata të mjaftueshme në lidhje me adresat e të gjithë pretendueseve, autoriteti i likuidimit duhet të publikoj një lajmërim në më së paku dy gazeta ditore që qarkullojnë në Kosovë në gjuhën shqipe dhe serbe dhe në faqen zyrtare të AKP-së duke

informuar paditësit që vendimet në lidhje me kërkesat e tyre ti marrin në AKP dhe pas skadimit të paraqitur në afat të përfshirë në njoftim do të konsiderohet që kërkesa iu është dorëzuar me kohë pretendueseve.

## **5. Shqyrtimi i kërkesave kolektive në procedurën gjyqësore**

5.1. Në procedurat gjyqësore është e lejueshme që një apo me shumë paditës të paraqiten si një palë procedurale/paditëse kundër një pale, në rastin tonë kundër një ndërmarrje shoqërore si e paditur. Përmes këtij instituti procedural mundësohet që në një lëndë gjyqësore si paditës apo të paditur të paraqiten disa persona fizik apo juridik. Ligji për Procedurën Kontestimore e parasheh institutin procedural të bashkë-ndërgjyqësisë në nenin 264 ku decidivisht përcakton se *“palia mund të ngritët bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shumë të paditurve”*.

Neni i lartpërmendur i përcakton kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për tu konsideruar se rasti konkret është bashkë-ndërgjyqësi:

- i) që kërkesat, përkatësisht detyrimet të jenë të një kategorie;
- ii) që kërkesat e bashkë-ndërgjyqësve të jenë të bazuara në fakte dhe bazë juridike esencialisht të njëjtë (*simite factum simite ius*), dhe
- iii) që për çdo kërkesë të jetë kompetente për vendimmarrje organi i njëjte.

5.2. Gjithsesi se në paraqitjen e kërkesave kolektive në likuidim kanë ndikuar edhe procedurat gjyqësore të iniciuara pranë gjykatave ku si bashkë-ndërgjyqës – pra në anën e paditësve paraqiten dy apo më shumë punëtorë të ndërmarrje përkatëse. Duhet përmendur se me rastin e futjes së NSH-së konkrete në likuidim, gjykatat duke u bazuar në kërkesën e AKP-së sipas nenit 9 të Ligjit të AKP-së dhe ish Rregullores 2005/48, i kanë ndërprerë procedurat gjyqësore. Me këtë rast është ardhur deri te paraqitja e kërkesës nga ana e paditësve në mënyrë kolektive pasi që si një pale procedurale janë njohur edhe në procedurën gjyqësore.

5.3. Nga praktika e deritanishme duhet përmendur aktgjykimi (C. Nr. 340/2001) i Gjykatës Komonale të Ferizajt për anulimin e vendimit për largimin nga puna të 912 punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje gjatë viteve të 90-ta. Gjykata Komonale në Ferizaj ka aprovuar padinë e tyre dhe ka nxjerr një aktgjykim të vetëm. Me futjen e kësaj ndërmarrjeje në likuidim i njëjti rast si kërkesë kolektive është paraqitur në procedurën e likuidimit. Megjithatë seksioni 2.2 është i aplikueshëm edhe këtu, pasi që shqyrtimi dhe vendimi për secilin kreditor sjellet në baza individuale.



Prishtinë, më 28 Shtator 2011

## Shtojca 4

### UDHËZUES

#### **Për shqyrtimin e Pretendimeve Pronësore nga Transformimet**

Qëllimi i këtij dokumenti është që të shtjelloj ankesat e Fondit Zhvillimor të Serbisë në procedurat e likuidimit dhe të japë rekomandimet se si të trajtohen ato nga Autoritetet e Likuidimit.

Ankesat e Fondit Zhvillimor të Serbisë (FZHS) bazohen në pretendimet që NSH-të në fjalë kanë kaluar nëpër një transformim gjatë viteve të nëntëdhjeta që rezultoi me ndërrimin e pronësisë të NSH-ve (pjesërisht apo plotësisht) në dobi të FZHS. Sa i përket një transformimi të pretenduar, Ligji i AKP-së (neni 5 paragrafi 4) thotë:

*Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të autoritetin e Agjencisë sipas neneve 5.1 ose 5.2 apo në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas neneve 6, 8 ose 9, përveç nëse:*

*4.1 Transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në fuqi për transformimet;*

*4.2 të gjitha obligimit e ndërlidhura me transformim, qofshin ato që dalin njëkohësisht apo pas Transformimit, apo qofshin të vendosura me Ligj apo sipas kontratës, përfshirë por duke mos u kufizuar në detyrimet që kërkojnë marrjen në konsideratë të plotë, si dhe lëshimin e aksioneve në fjalë- janë përmbushur plotësisht; dhe*

*4.3 transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.*

Siç duket, një transformim i pretenduar duhet të plotësojë në përgjithësi, kushtet e parapara sipas paragrafit 4.1, 4.2 dhe 4.3 të nenit 5 të ligjit mbi AKP-në, në mënyrë që të ndikoj në Pronësinë Shoqërore të ndërmarrjeve në fjalë. Kushti i parë paraprak për vlefshmërinë e transformimit të pretenduar, i cili më pas do të ndikoj në vlerësimin e ankesave të FZHS, është përputhshmëria me ligjin e aplikueshëm për transformimet.

#### **Ligji i aplikueshëm për transformimet**

Fondi Zhvillimor së pari ishte futur në Legjislacion nga Ligji i RFSJ mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90). Ligji mbi Kapitalin Shoqëror i autorizon ndërmarrjet

me pronësi shoqërore” që të përvetësojnë kapitalin shtesë me anë të lëshimit të një sasive të aksioneve, më saktësisht nëpërmjet shitjes të aksioneve që u japin të drejtën apo titullin e pronësisë”<sup>1</sup> Përkufizimi i Kapitalit Shoqëror, siç parashihet në nenin 1 të Ligjit, janë asetet kapitale të një ndërmarrjeje të zhvleftësuar për pjesën proporcionale të humbjeve të pambuluara tregtare, fondet rezervë dhe fondet jashtë biznesit. Kapitali shoqëror mund të shitet, plotësisht apo pjesërisht investitorëve vendor apo të jashtëm nëse të hyrat e fituara nga kjo shitje i takojnë fondit për zhvillim<sup>2</sup>. Neni 3 i këtij ligji thotë se të hyrat e fituara përmes shitjes të kapitalit shoqëror që kanalizohen tek fondi për zhvillim do të paraqesin një depozitë të vazhdueshme të Republikës apo Krahinës Autonome në Fondin për Zhvillim. Të ardhurat e fituara nga shitja e ndërmarrjeve (plotësisht apo pjesërisht) do të përdoren nga Fondi për Zhvillim për investime kapitale në ndërmarrje. Ndërsa Fondi për Zhvillim funksionon si një ndërmarrje publike, Republika apo Krahina Autonome e Jugosllavisë mund të themelojë një apo më shumë fonde për zhvillim. Lëshimi i aksioneve për shitje, si dhe shitja e ndërmarrjes e plotë apo e pjesërishtme, është e drejtë ekskluzive e organit Menaxhues të Ndërmarrjes. Me vendimin e brendshëm për shitjen e aksioneve (përgatitja e tyre për shitje për punëtorët aktual apo ish-punëtorët, personat tjerë fizik vendor apo fondet për sigurime pensionale dhe të invaliditetit) organi menaxhues duhet të marrë vendim për organizimin e ndërmarrjes në një formë qoftë si Shoqëri Aksionare apo Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar<sup>3</sup>. Në rast se organi menaxhues i ndërmarrjes marrë vendimin për shitjen e një pjese të ndërmarrjes, ai njëherësh marrë edhe vendimin tjetër për organizimin e ndërmarrjes si ndërmarrje me pronësi të përzier.<sup>4</sup> Ligji thotë caktimi i vlerës të një ndërmarrjeje bëhet nga një organizatë e përzgjedhur nga ana e një Agjencie për Ristrukturim dhe Revitalizim, e cila është e themeluar në bazë të këtij ligji me qëllim të ofrimit të këshillave lidhur me shitjen e ndërmarrjes.<sup>5</sup> Ligji kërkon të merret një opinion nga ana e kësaj Agjencie para përmbylljes të kontratës që ka të bëjë me çfarëdo shitje të aksioneve, pjesë të ndërmarrjes apo vetë ndërmarrjen.<sup>6</sup> Ligji përcakton një afta prej 10 vitesh për përmbylljen e shitjes si dhe pagesën e aksioneve të brendshme të lëshuara nga ndërmarrja.<sup>7</sup> Parapagimi apo pagesa e aksioneve duhet të dëshmojnë nga Banka në fjalë përmes certifikatave të veçanta.<sup>8</sup> Ligji mbi Kapitalin Shoqërorë u ndryshua në vitin 1996 (Gazeta Zyrtare e RSFJ 29/96, 29/97) për sa u përket ofrimit për herë të parë të mundësisë të transformimit përmes bartjes të aksioneve tek Fondi për Zhvillim<sup>9</sup> apo në fondet tjera. Transferimi i aksioneve, sa i përket nenit 13 të Ligjit në fjalë, është bërë për të vetmin qëllim që këto aksione të ofrohen për shitje për tregun kapital. Transferimi i aksioneve tek Fondi për Zhvillim, nëse është bërë ndonjëherë sipas nenit 13 të Ligjit, e bën Fondin një lloj “karrierë” aksioneve për blerësin, i cili pas blerjes të pagesës bëhet pronar i padiskutueshëm. Një ndryshim i rëndësishëm, i bërë me këtë ligj, ishte e drejta e kompanisë për të hyrë në marrëveshje kontraktuale me kreditorë për shndërrimin e shumave në pronësi në investim dhe më pas kapitalizimit e një investimi të tillë në aksione.<sup>10</sup>

- Obligimi i regjistrimit në Gjykatë

<sup>1</sup> Neni 1 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>2</sup> Neni 2 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>3</sup> Neni 1 a) i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>4</sup> Shih nenin 2 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>5</sup> Shih nenin 2 a) të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>6</sup> Shih nenin 2 b) të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>7</sup> Shih nenin 14 të Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90)

<sup>8</sup> Shih nenin 97 dhe 100 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

<sup>9</sup> Shih nenin 6, paragrafin 2 të Ligjit mbi bazat e transformimit të kapitalit shoqëror (Gazeta Zyrtare 29/96, 29/97)

<sup>10</sup> Shih nenin 14 të Ligjit mbi bazat e transformimit të kapitalit shoqëror (Gazeta Zyrtare 29/96, 29/97)

Çfarëdo ndryshimi i statutit të ndërmarrjes, por edhe ndryshime tjera, përfshirë ndryshimet në kapital, duhet të regjistrohen në regjistrin e Gjykatës.<sup>11</sup> Regjistrimi në Gjykatë është e vetmja mënyrë për ti dhënë efekt ligjor transformimit të ndërmarrjes.<sup>12</sup> Të dhënat e futura në Regjistrin e Gjykatës publikohen në Gazetën Zyrtare të RSFJ.<sup>13</sup>

Përveç ligjit Federal, Republika e Serbisë ka nxjerrë ligjin e vet lidhur me themelimin e Fondit për Zhvillim dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore. Ligji mbi Fondin Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë ishte nxjerrë nga Republika e Serbisë në vitin 1990. Aktiviteti i Fondit do të ishte investimi i kapitalit shoqëror dhe mjeteve tjera financiare në aksione apo pjesë të ndërmarrjes shoqërore, duke synuar konsolidimin e ndërmarrjeve të tilla, shitjet pasuese të aksioneve dhe pjesëve dhe rregullimin e korditeve<sup>14</sup>.

Fondi Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë ka pushuar së funksionuari në vitin 1992, me ç'rast Kuvendi i Republikës të Serbisë miratoi Ligjin mbi Fondin Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92). Njëri nga objektivat e Fondit për Zhvillim të miratuar rishtazi, ashtu siç parashihej nga ky ligj ishte “parandalimi i emigrimit të mëtejshëm dhe të kthimi Serbëve dhe Malazezëve në Kosovë”<sup>15</sup>. Ndërsa aktiviteti kryesor i Fondit ishte për të marrë pronën në posedim, prodhimi dhe rekonstruktimi financiar, nga të cilat do të vinin mjetet financiare, ndër tjera, shitja e kapitalit shtetëror si dhe shitja e ndërmarrjeve shoqërore apo pjesëve të tyre në pajtim me ligjin<sup>16</sup>. Fondi ishte i organizuar si Shoqëri Aksionare që do të lëshonte aksione në shumën e transferuar bazuar në transformimin e pronës shoqërore në pajtim me ligjin si dhe shumën e aseteve të ofruara nga buxheti i Republikës të Serbisë<sup>17</sup>. Procedura për transformimin e pronës shoqërore parashihte me “Ligjin mbi Kushtet dhe Procedurat për Transformimin e Pronës Shoqërore” (tanietutje Ligji mbi transformimet)<sup>18</sup>. Ligji mbi Transformimet përbëhet prej principeve të vendosura nga Ligji i RSFJ mbi Kapitalin Shoqëror. Ligji parasheh transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare. Ligji e mvesh organin menaxhues të ndërmarrjes me autoritet ekskluziv për të vendosur mbi transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare si dhe për lëshimin e aksioneve<sup>19</sup>. Ndërmarrja është e obliguar me Ligj që të publikoj në Gazetën Zyrtare të RS si dhe në shtypin ditor që të dyja Vendimin e Organit Menaxhues lidhur me transformimin dhe lëshimin e aksioneve<sup>20</sup>. Pronarët e kapitalit do të pranojnë një vërtetim për shumën e paguar të aksioneve<sup>21</sup>. Ligji parasheh që transformimi të zgjatë tre vite: 1) lëshimi dhe shitja e aksioneve me qëllim të shitjes të kapitalit në pronësi shoqërore, 2) lëshimi i aksioneve me qëllim të rritjes të kapitalit, 3) blerja e ndërmarrjes apo një pjese të saj<sup>22</sup>.

---

<sup>11</sup> Shih nenin 183 dhe 184 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

<sup>12</sup> Shih nenin 185 dhe 186 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

<sup>13</sup> ibid.

<sup>14</sup> Shih nenin 4 të Ligjit mbi Fondin Republikan për Zhvillim dhe Rikonstruktiv të Ekonomisë (RS Gazeta Zyrtare RS 32/90)

<sup>15</sup> Shih nenin 3 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92).

<sup>16</sup> Shih nenin 4 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92).

<sup>17</sup> Shih nenin 8 të Ligjit Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare RS 20/92)

<sup>18</sup> Shih Gazetën Zyrtare të RS 48/91.

<sup>19</sup> Shih nenin 7 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

<sup>20</sup> I oferta.

<sup>21</sup> Shih nenin 3 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

<sup>22</sup> Shih nenin 9 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

1) Sipas metodës të parë të transformimit – shitja e kapitalit shoqëror përmes aksioneve – punëtorëve, ish-punëtorëve apo trashëgimtarëve të ish-punëtorëve të ndërmarrjes të kualifikuar për zbritjen e vlerës nominale të aksioneve<sup>23</sup>, ndërsa 50% e kapitalit të fituar nga shitja e aksioneve me zbritje shkon në Fondin Pensional. Fondi për Zhvillim duket se ka pranuar vetëm 60% të kapitalit të fituar nëpërmjet shitjes të aksioneve pa zbritje, që janë para të mbledhura nga shitjet ndaj palëve të treta (që nuk janë punëtorë), ndërsa 30% e kapitalit shkon në Fondin Pensional dhe 10% në Fondin për Punësim. Kapitali i transferuar në Fondin për Zhvillim di të përdoret për prodhim, ristrukturim të pronës dhe zhvillim<sup>24</sup>. Secila ndërmarrje e përfshirë mban të dhënat e të gjitha aksioneve të shitura me parapagim dhe zbritjet e bëra<sup>25</sup>.

2) Vendimi mbi lëshimin e aksioneve me qëllim të rikapitalizimit i përket prapë Organit Menaxhues të ndërmarrjes. Ligji parasheh një vlerësim që duhet bërë nga ana e Agjencisë, përderisa kapitali i fituar pas shitjes të aksioneve të tilla mbetet në pronësi të ndërmarrjes<sup>26</sup>.

3) shitja e Ndërmarrjes, apo e një pjese të saj, si një formë tjetër e transformimit, bëhet përmes një ankandi publik me kushtet e vendosura nga Fondi për Zhvillim. Ndërmarrja bëhet pjesë e kontratës të shitjes vetëm nëse një pjesë e saj është shitur<sup>27</sup>. Nëse vetëm një pjesë e ndërmarrjes është shitur, ndryshe nga blerja e ndërmarrjes si e tërë ku çmimi i shitjes paguhet në llogarinë bankare të Fondit për Zhvillim, paratë e paguara mbesin në ndërmarrje<sup>28</sup>. Shitja e ndërmarrjes, megjithëse mund të përshij vetëm një pjesë të saj, çon në likuidim.

Transformimi, pa marr parasysh formën duhet të përfitonte nga shërbimet e një Agjencie të specializuar<sup>29</sup>, e cila do të luante një rol të rëndësishëm sa i përket kapitalizimit të ndërmarrjeve që do të transformoheshin në Shoqëri Aksionare. Kjo Agjenci do të lëshonte një vërtetim brenda 60 ditëve pas pranimit të vlerësimit të brendshëm të kapitalit shoqëror të NSH-së dhe zbritjen e aplikueshme përkatëse të vlerës të aksioneve<sup>30</sup>. Procesi i lëshimit dhe i shitjes të aksioneve duhet ti përmbahej Ligjit mbi rregullimin e aksioneve i cili është Ligj i RSFJ për letra me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89, 29/90).

Ligji mbi Letrat me Vlerë themelon një Komision për shqyrtimin e aplikacioneve të detyrueshme të cilat një organ (ndërmarrja) i cili merret me lëshimin e aksioneve duhej ti dorëzonte para çfarëdo lëshimi të aksioneve<sup>31</sup>. Aplikacioni duhej të shoqërohej me një Opinion të Shërbimit Social për Kontabilitet dhe Auditim të situatës financiare në ndërmarrje<sup>32</sup>. Vendimi i Komisionit publikohet në Gazetën Zyrtare të RSFJ<sup>33</sup>. Ligji i kërkon

<sup>23</sup> Shih nenin 16 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare RS 48/91)

<sup>24</sup> Shih nenin 17 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>25</sup> Shih nenin 18 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>26</sup> Shih nenin 26 dhe 27 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>27</sup> Shih nenin 28 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>28</sup> Shih nenin 29 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>29</sup> Shih nenin 3 paragrafi 4 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91). Nuk është e qartë nëse një Agjenci e tillë ishte themeluar ndonjëherë përmes ligjit, neni 39 parasheh tre muaj afat për themelimin e saj.

<sup>30</sup> Shih nenin 8 të Ligjit mbi kushtet dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore në forma tjera të pronës (Gazeta Zyrtare 48/91)

<sup>31</sup> Shih nenin 4 dhe 45 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>32</sup> Shih nenin 5 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

Agjencisë Federale të Administratës, e cila është kompetente për çështjet financiare, që të mbaj të shënime për çfarëdo lëshimi të aksioneve apo letrave me vlerë e veçanërisht: ato të llojit afatgjate (nuk është e qartë se në çfarë konteksti është përdorur në ligj ky term); emrin (titullin) dhe selinë e organit lëshues të aksioneve dhe bondeve; shumën e përgjithshme dhe numrin e aksioneve dhe letrave me vlerë; si dhe numrin serik dhe të kontrollit të organit lëshues të aksioneve dhe bondeve;<sup>34</sup>. Definicioni i aksioneve dhe bondeve; siç parashihet në nenin 1 dhe 8 të Ligjit, është aksionet, fletë garancionet (promissory notes), dëftesa e thesarit, dëftesat dhe certifikatat komerciale të cilat janë dokumente në formë të shkruar të regjistruara apo të krijuara për bartësin. Çfarëdo e drejte apo detyrimi të parapara në aksione apo obligacione hyn në fuqi posa Lëshuesi i dorëzon ato te blerësi<sup>35</sup>. Ligji kujdeset posaçërisht për aksionet e lëshuara nga ndërmarrja apo subjektet tjera përfituese në nenet 13-25. Sipas nenit 15, ligji parasheh që aksionet duhet të paguhen me para, apo mallra ose të drejtat e shprehura në shuma financiare, nëse vendimi për lëshimin e aksioneve ka paraparë ashtu. Këshilli i punëtorëve merr vendim për lëshimin e aksioneve<sup>36</sup>. Vendimi mbi lëshimin e aksioneve duhet të përmbaj një sërë elementesh të specifikuara në nenin 20 të ligjit në fjalë: një të dhënë që tregon se aksionet janë lëshuar tek bartësi apo se ato janë regjistruar; shumën e përgjithshme dhe numrin e aksioneve; vlerën nominale të aksioneve; numrin e votave për aksion në organin menaxhues; metodën e pagesës të ndarë; kohën e regjistrimit të aksioneve; metodën e regjistrimit; kohën dhe metodën e pagesës të aksioneve; afatin për rimbursim në rast të ndonjë dështimi; llojin e aksioneve që do të lëshohen; renditja e realizimit të drejtave me prioritet në rastet kur kemi më shumë se një lëshim; metodën e njoftimit; procedurat e shpërndarjes; mënyrën e shpërndarjes; specifikacionet lidhur me kushtet e pagesës të dividendit të akumuluar; bartja e rrezikut; mënyra e shitjes të aksioneve; mundësia për shndërrim; të drejtat e bartësit për aksionet me prioritet; drejtat e me prioritet për bartësin në rast të lëshimit të ri; etj.

Aksionet e lëshuara nga ndërmarrja përbëhen nga dy komponentë; a) dokumenti (ky është një term i përdorur nga autori i kësaj shkrese për lehtësim në referenca pasi që ligji nuk përmban një term specifik) për lëshimin e aksioneve dhe b) kuponi për mbledhjen e dividendëve<sup>37</sup>. a) Elementet e dokumentit të aksioneve), siç është definuar në nenin 21 të Ligjit: 1) një shenjë që tregon se bëhet fjalë për një aksion; 2) një tregues që shpjegon llojin e aksionit; 3) identifikimin e blerësit të aksioneve – tek i cili është lëshuar aksioni; 4) shumën në para të vlerës të aksionit; 5) numrin e aksioneve të lëshuara tek bartësi; 6) kushtet e pagesës të dividendës; 7) vendi dhe data e lëshimit; 8) vendi dhe data e lëshimit; 9) numrin serik i cili mban një numër kontrolli 10) nënshkrimin e personit të autorizuar; 11) identifikimin e lëshuesit të aksioneve; 12) një listë me të drejtat e bartësit;

b) Kuponi duhet të përmbaj elementet në vijim: 1) numrin rendor për mbledhjen e dividendës; 2) the numrin e aksioneve që përmban kuponi; dhe 3) nënshkrimin e lëshuesit të aksioneve. Aksionarët kanë pasur certifikatën e aksioneve të lëshuara nga ndërmarrja me qëllim të pjesëmarrjes në asamblenë e aksionarëve<sup>38</sup>.

---

<sup>33</sup> Shih nenin 45d të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>34</sup> Shih nenin 7 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>35</sup> Shih nenin 9 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>36</sup> Shih nenin 20 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>37</sup> Shih nenin 19 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>38</sup> Shih paragrafin 3 të nenit 20 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)



Në përgjithësi, në mënyrë që të përmbushet kushti i parë i paraparë në paragrafin 4.1 të nenit 5 të Ligjit mbi AKP-në, d.m.th transformimi i ndërmarrjes në pajtim me ligjin e asaj kohe, duhet të ofrohen dëshmitë në vijim:

1. *Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi Transformimin - neni 2 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi Transformimin.*
2. *Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi lëshimin e aksioneve që përmban të gjitha elementet e parapara në nenin 20 të Ligjit mbi letrat me vlerë - Neni 2 i ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi transformimin.*
3. *Dëshmi për publikimin e Vendimit në Gazetën Zyrtare të RS sipas pikës 1. & 2. - neni 7 i Ligjit mbi transformimin.*
4. *Dëshmi për vlerësimin e brendshëm (Shërbimi Social për Kontabilitet dhe Auditim) të Kapitalit Shoqëror (Kapitalizmi) – neni 8 i Ligjit mbi transformimin.*
5. *Dëftesën nga Agjencia Republikane (sipas nenit 8 të Ligjit mbi transformimin) apo Vendimi i lëshuar nga Komisioni për Vlerësim sipas nenit 4 të Ligjit mbi letrat me vlerë.*
6. *Dëshmi për publikimin e Vendimit të Komisionit (sipas pikës 5 më lartë) në Gazetën Zyrtare RSFJ – neni 45d i Ligjit mbi letrat me vlerë, me ndryshime.*
7. *Transkripti i regjistrimit të Shoqërisë Aksionare në Gjykatën Ekonomike – neni 183 dhe 184 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime.*
8. *Dëshmi për publikimin e të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Gjykatës Ekonomike në Gazetën Zyrtare RSFJ - neni 185 dhe 186 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime.*
9. *Certifikatën e aksioneve (dokumentin)e lëshuar nga ndërmarrja që përmban të gjitha 12 elementet sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë*
10. *Kuponi (pjesa e veçantë e Certifikatës të aksioneve) me 3 elemente sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë.*
11. *Certifikatën e aksioneve për pjesëmarrje në mbledhjet te Asamblesë të Aksionarëve (në rast se Vendimi për Lëshimin e Aksioneve sipas pikës nr. 2 më lartë e parasheh atë.) – neni 20.3 i Ligjit mbi letrat me vlerë*
12. *Kontrata për shitjen e ndërmarrjes (nëse është e zbatueshme) sipas nenit 28 dhe 29 të Ligjit mbi transformimin.*

### **Përmbushja e detyrimeve që dalin, apo që lidhen me aksionet**

Kërkesa e dytë e paraparë me Ligjin e AKP-së (sipas nën-paragrafit 4.2 të nenit 5), përcakton se për të qenë transformimi i vlefshëm duhet përmbushur të gjitha obligimet përfshirë dhe por duke mos u kufizuar në pagesën apo lëshimin e aksioneve në fjalë. Ndërsa obligimet që lidhen me lëshimin e aksioneve janë trajtuar gjerësisht më sipër, kjo pjesë do të trajtoj çështjen e pagesës të aksioneve siç parakusht për transformimin e NSH-së në Shoqëri Aksionare.

Pagesa e Aksioneve të ketë gjithashtu parakushte për transformimin sipas ligjit të aplikueshëm për transformim të kohës. Aksionet e lëshuara nga një NSH mund të paguheshin përnjëherë apo edhe në këste<sup>39</sup>. Në rast të pagesës me këste, atëherë bartësi ka pranuar vetëm aksione të përkohshme deri në pagesën përfundimtare<sup>40</sup>. Sidoqoftë, ka pasur një afat kohorë për pagesën e aksioneve të përcaktuar në Memorandumin e Shoqatës të Shoqërive Aksionare, dhe se në rast dështimi për të bërë pagesën, praktikisht kjo ka qar në ndërprerjen e financimit të SHA<sup>41</sup>. Ligji parasheh që certifikata të lëshohet nga banka në të cilën është bërë pagesa e aksioneve<sup>42</sup>.

Aksionet mundën gjithashtu të përdoren për përmbushjen e obligimeve të një NSH-je nën çfarëdo kushti që pajtohen bartësi dhe ndërmarrja<sup>43</sup>. Në këtë rast, marrëveshje për kryerjen e obligimeve me aksione duhet shoqëruar me certifikatën e marrëveshjes apo ndonjë dokument tjetër që mund të dëshmojë përmbushjen në fjalë sipas një marrëveshjeje të tillë.

Transferimi i aksioneve tek Fondi për Zhvillim sipas Ligjit të vitit 1997 në Baza të Transformimit të Kapitalit Shoqëror, si një metodë tjetër e transformimit, gjithashtu i nënshtrohet obligimit për pagesë të vlerës monetare të aksioneve. Aksionet transferohen tek Fondi në pajtim me nenin 13 të Ligjit, sipas obligimit për ti ofruar ato për shitje në tregun e kapitalit. Pasi të shiten aksionet, ato i takojnë blerësit dhe pagesa duhet dëshmuar me certifikatën bankare.

### **Transformimi nuk ishte as diskriminues dhe as nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.**

Transformimi është bërë në kohën e një klime me trazira politike, mosbesimi në mes të popullatës dhe njërive financiare të Ish Jugosllavisë që dërguan në ndezjen e luftës dhe shpërbërjen e mëtejshme të Republikës Federative të Jugosllavisë. Objektivi politik i Fondit, siç përcaktohet me Ligjin mbi Fondi për Zhvillim të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92), ishte “parandalim për emigrimin e mëtejshëm dhe kthim të Serbëve dhe Malazezëve në Kosovë”<sup>44</sup>. Ndërsa ky dokument nuk merr përsipër të interpretoj nëse një dispozitë e tillë mund të sugjeronte konotacion diskriminues të këtij ligji të veçantë, ne duhet të theksojmë se ligjislacioni mbi transformimin ishte paraprirë apo i shoqëruar nga një legjislacion diskriminues. Rregullorja e aplikueshme e UNMIK-ut 1999/24 “mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë” me ndryshime, neni 1, përcakton si në vijim:

*“1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin:*

*(a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to dhe*

*(b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.*

*Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.*

*1.2 Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatojë një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin 1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe*

<sup>39</sup> Shih nenin 16 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>40</sup> I Oferta.

<sup>41</sup> Shih nenin 97 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

<sup>42</sup> Shih nenin 100 të Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

<sup>43</sup> Shih nenin 11 të Ligjit për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe 29/90)

<sup>44</sup> Shih nenin 3 të Ligjit mbi Fondit për Zhvillim të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92)

*është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj”.*

Rregullorja e UNMIK–ut 1999/24 parasheh që një dispozitë apo ligj në fuqi nga marsi i vitit 1989 deri në qershor të vitit 1999, mund të zbatohet vetëm nëse nuk është diskriminuese. Legjislacioni diskriminues në Kosovë ishte miratuar në një atmosferë politike pas shuarjes të Kuvendit të Kosovës apo pas heqjes të Autonomisë, si dhe heqjes të institucioneve autonome. “Organet e Dhunshme” ishin instaluar nga ana e autoriteteve shtetërore të Serbisë në të gjitha institucionet qeveritare, ndërmarrjet dhe ndërmarrjet shoqërore. Shembuj evident të legjislacionit që inspironin dhe që kishin për qëllim diskriminimin nacional ishin Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në rrethana të veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 26 e datës korrik 1990) apo edhe Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në ndërmarrje (Gazeta Zyrtare e RS 43/90). Këto Ligje nënkuptonin instalimin e Masave të Dhunshme që mëtonin ndërrimin e autoriteteve menaxhuese në NSH me “organe të dhunshme”. Largimi nga puna e drejtorëve Shqiptarë ishte veprimi i parë, ndërsa në fund zëvendësimi i tyre me qytetar etnik Serbë rezultoi me largimin nga puna të punonjësve Shqiptarë. Natyra diskriminuese e një sërë ligjesh që ndërliidhen me transformimin dhe të drejtat e punëtorëve të NSH-ve ishte vënë re në masë të madhe nga organet përgjegjëse ndërkombëtare, siç janë OSBE dhe Komisioni mbi të drejtat e Njeriut i KB bazuar në raportet e përgatitura nga ta mbi situatën në Kosovë<sup>45</sup>.

Në mënyrë që transformimi i NSH-ve të jetë i vlefshëm, në mënyrë absolute është e domosdoshme që ai të mos jenë vendosur nga organet menaxhuese nëpërmjet zbatimit të Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990), Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90), apo në ndonjë mënyrë tjetër i ndikuar nga ligjet diskriminuese të nxjerra ndërmjet marsit 1989 dhe qershorit 1999.

Pajtueshmëria me parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (Konventa) që buron nga kushtetuta, e cila e bën drejtpërdrejt të zbatueshme Konventën në Kosovës. Konventa nuk ka qënë drejtpërdrejt e zbatueshme në kohën e transformimit pasi që RSFJ nuk ishte anëtare e Këshillit të Evropës dhe prandaj nuk e kishte ratifikuar atë. Megjithëse, parlamenti i ish- Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë iu kishte dhënë statusi mysafirit special në Asamblenë e Këshillit të Evropës në qershor të vitit 1989, menjëherë pas shpërthimit të luftës në qershor të vitit 1991 ky status së pari ishte pezulluar më 25 Nëntor 1991 dhe përfundimisht ishte tërhequr më 30 Qershor 1992.

Parimet e Konventës që mund të cenoheshin me transformim janë atë të parapara me nenin 1, protokollin 1 – e drejta e pronës, neni 6 – procesi i drejtë në përputhje me ligjin, neni 14 – ndalimi i diskriminimit etj. Ndërsa dështimi i paraqitjes të fakteve që dëshmojnë pagesën e aksioneve të lëshuara nga NSH-ja sigurisht se do të përbënte shkelje të parimeve të parapara me nenin 1, protokollin 1 të Konventës, zëvendësimi i organeve menaxhuese të NSH-ve që vendosin për transformimin, para marrjes të një vendimi të tillë, me qëllim të zbatimit të “masave të dhunshme” është një dhunim i qartë i parimeve kundër diskriminimit që gjenden në nenin 14 të Konventës.

## **Konkludimi**

---

<sup>45</sup> Shih paragrafin 156 të Raportit mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish Jugosllavisë nga raportuesi Special drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut të KB (E/CN.4/1993/50), në pajtim me Rezolutën e Komisionit 1992/s-1/1, e diponueshme në <http://ap.ohchr.org/documents/alldocs>. Raporti ofron një listë me ligjet diskriminuese, e cila në mes tjerash përmban Ligjin mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990) apo Ligjin mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90).

Një ankesë e suksesshme pronësore e Fondit për Zhvillim të Serbisë duhet të shoqërohet nga dëshmitë në vijim:

1. *Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi Transformimin - neni 2 i Ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi Transformimin.*
2. *Vendimi i Këshillit të Punëtorëve (Organi Menaxhues i NSH-së) mbi lëshimin e aksioneve që përmban të gjitha elementet e parapara në nenin 20 të Ligjit mbi letrat me vlerë - Neni 2 i ligjit mbi Kapitalin Shoqëror, neni 17 i Ligjit mbi transformimin.*
3. *Dëshmi për publikimin e Vendimit në Gazetën Zyrtare të RS sipas pikës 1. & 2. - neni 7 i Ligjit mbi transformimin.*
4. *Dëshmi për vlerësimin e brendshëm (Shërbimi Social për Kontabilitet dhe Auditim) të Kapitalit Shoqëror (Kapitalizmi) – neni 8 i Ligjit mbi transformimin.*
5. *Dëftesën nga Agjencia Republikane (sipas nenit 8 të Ligjit mbi transformimin) apo Vendimi i lëshuar nga Komisioni për Vlerësim sipas nenit 4 të Ligjit mbi letrat me vlerë.*
6. *Dëshmi për publikimin e Vendimit të Komisionit (sipas pikës 5 më lartë) në Gazetën Zyrtare RSFJ – neni 45d i Ligjit mbi letrat me vlerë, me ndryshime.*
7. *Transkripti i regjistrimit të Shoqërisë Aksionare në Gjykatën Ekonomike që tregon qartë FZHS si një nga aksionarët si dhe shumën e aksioneve që ka në pronësi - neni 183 dhe 184 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime.*
8. *Dëshmi për publikimin e të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Gjykatës Ekonomike në Gazetën Zyrtare RSFJ që tregon qartë numrin e aksioneve në pronësi të FZHS- neni 185 dhe 186 i Ligjit mbi Ndërmarrjet, me ndryshime.*
9. *Certifikatën e aksioneve (dokumentin)e lëshuar nga ndërmarrja që përmban të gjitha 12 elementet, që tregon qartë bartësin e aksioneve- sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë*
10. *Kuponi (pjesa e veçantë e Certifikatës të aksioneve) me 3 elemente sipas nenit 21, paragrafi 1 i Ligjit mbi letrat me vlerë.*
11. *Certifikatën e aksioneve për pjesëmarrje në mbledhjet te Asamblesë të Aksionarëve (në rast se Vendimi për Lëshimin e Aksioneve e parasheh një gjë të tillë sipas pikës nr. 2 më lartë.) lëshuar për FZHS– neni 20.3 i Ligjit mbi letrat me vlerë*
12. *Kontrata për shitjen e ndërmarrjes (nëse është e zbatuar kjo metodë e transformimit) sipas nenit 28 dhe 29 të Ligjit mbi transformimin.*
13. *Certifikata Bankare që dëshmon pagesën e aksioneve apo pagesën e çmimit të shitjes të ndërmarrjes – neni 100 i ligjit mbi ndërmarrjet;*
14. *Marrëveshja për përmbushjen e obligimeve përmes transferimit të aksioneve apo Marrëveshja për shndërrimin e borxhit në aksione e lidhur ndërmjet NSH-së dhe FZHS e shoqëruar me certifikatën e përmbushjes apo çfarëdo dokumenti tjetër që mund të dëshmojë kryerjen e obligimeve në pajtim me marrëveshjen në fjalë, me kusht që aksionet janë lëshuar për shlyerjen e borxhit – neni 11 i Ligjit mbi Letrat me Vlerë;*

15 *Dëshmia që Organet Menaxhuese të NSH-së nuk janë zëvendësuar, para se të merrej vendimi për transformimin, duke zbatuar Ligjin mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta ( Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990), Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90), apo ndonjë nga ligjet tjera diskriminuese.*

Në rast se gjatë vlerësimit dhe përcaktimit të vlefshmërisë të ankesave, Autoritetet e Likuidimit vërejnë mungesën e ndonjërit nga këto dokumente/dëshmi në mbështetje të ankesës, paraqitur më lartë prej 1-15, mund të kërkojnë nga FZHS që të ofroj informacionet që mungojnë e që janë të domosdoshme për përcaktimin e vlefshmërisë të Interesit në fjalë në pajtim me nenin 23, paragrafin 3 të Aneksit 1 të Ligjit mbi AKP-në.

Në rast se FZHS nuk ofron informatat apo dëshmitë që mungojnë, kjo sigurisht që do të çonte në hedhjen poshtë si të pavlefshme të ankesës për interesin e pretenduar në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e AKP-së. Nenin 36, nën-paragrafin 2.22 të Aneksit 1.